

## Vendim Nr.41 datë 23.01.2020

PËR SKUALIFIKIMIN E KANDIDATES JOGJYQTARE ZNJ {...} DHE PËRJASHTIMIN E SAJ NGA KANDIDIMI PËR EMËRIM SI GJYQTARE NË GJYKATËN E LARTË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 23.01.2020, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, të kandidatës znj. {...}”, përgatitur nga relatori, z. Dritan Hallunaj, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatës znj. {...} nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë,

### V Ë R E N

#### I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. **Me Vendimin nr. 108, datë 09.07.2019**, mbështetur në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 48, pikat 3/c dhe 5, si dhe nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si edhe në nenin 31, pika 1, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, **Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur :**

I. *Shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në fushën e të drejtës administrative.*

II. Afati i kandidimit

1. *Afati i kandidimit është dy javë nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

1.1 **Me Vendimin nr. 109, datë 09.07.2019**, mbështetur në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 48, pikat 3/c dhe 5, si dhe nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si edhe në nenin 31, pika 1, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, **Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur :**

I. *Shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në fushën e të drejtës civile.*

II. Afati i kandidimit

2. *Afati i kandidimit është dy javë nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

2. **Brenda afatit** dyjavor nga nga dita e publikimit të dy vendimeve si më lart në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, **për dy pozicionet e lira** të shpalluara përmes vendimeve të mësipërme, **ka aplikuar për të marrë pjesë edhe kandidatja znj. {...}**.

3. **Me Vendimin nr. 142, datë 26.07.2019**, bazuar në nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), **Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur :**

**1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatët, nga radhët e juristëve të spikatur, për në pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë.**

**2. Caktimin e relatorit për secilin kandidat që ka dorëzuar kërkesën për t’u emëruar në Gjykatën e Lartë, konkretisht për znj. {...} - relator z. Dritan Hallunaj; ...”.**

4. **Me Vendimin nr.172, datë 11.09.2019**, mbështetur në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 48, pikat 3/c dhe 5, si dhe nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si edhe në nenin 31, pika 1, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, **Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur :**

**I. Shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në fushën e të drejtës civile.**

**II. Afati i kandidimit**

**3. Afati i kandidimit është dy javë nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**

5. **Brenda afatit** dyjavor nga nga dita e publikimit të vendimit si më lart në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, **për pozicionin e lirë** të shpallur përmes vendimit të mësipërm, **ka aplikuar për të marrë pjesë edhe kandidatja znj. {...}**.

6. **Me Vendimin nr.182, datë 2.10. 2019**, bazuar në nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Vendimin e tij 75/2019, **Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: ‘Për kandidatët znj. {...} ..., të cilët kanë aplikuar edhe për pozicionet e shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 108, nr. 109 dhe nr. 110, datë 09.07.2019, procedurat e verifikimit që janë në proces e sipër për këto kandidime, janë të vlefshme edhe për kandidimin e tyre për pozicionin e lirë të shpallur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimin nr. 172, datë 11.09.2019’.**

7. **Më datë 26.07.2019**, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, **kandidatja, znj. {...}**, në rrugë elektronike, **u njoftua :**

- për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit;
- për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi;
- për të të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

Po ashtu, kandidatja u njoftua edhe për detyrimin për **plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit** ndaj saj, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.

8. Brenda afatit tre ditor, kandidatja znj.{...}, **depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit** ndaj saj.

Nga ana tjetër, në këtë afat, **kandidatja nuk parashtrroi asnjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit** ndaj saj apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

9. **Më datë 26.07.2019**, pas shqyrtimit paraprak të dokumentacionit të paraqitur në rastin e kandidimit, duke vlerësuar se ky dokumentacion nuk ishte i plotë, **kandidatja znj. {...}**, në rrugë elektronike, **u njoftua për plotësimin e dokumentacionit të kandidimit**, bazuar në pikën 9, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019.

10. **Po më datë 29.07.2019**, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidates znj.{...}, në rrugë elektronike, **iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse** (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej saj në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit.

11. Brenda afatit pesë ditor, **kandidatja znj. {...}**, **depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit**, ndërsa brenda datës 06.09.2019 të caktuar me Vendimin nr. 142, datë 26.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ajo dorëzoi rregullisht edhe **formularin “Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë” pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave**(më poshtë referuar si ILDKPKI).

12. Në vijim të procedurës së verifikimit, **në datat 06.08.2019 dhe 07.08.2019**, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, **u kërkuar informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kandidatët e Gjykatës së Lartë, ndër ta edhe për znj. {...}**.

13. **Institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme.**

14. **Më datë 06.08.2019**, në kuadër të verifikimit të kushtit të kandidimit, asaj *“të pasjes gradë shkencore në drejtësi”*, përcaktuar ne nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, por edhe në nenin 49, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (më poshtë referuar si Ligji i Statusit), me Shkresën nr. 4163 prot., **u kërkua informacion dhe konfirmim nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në lidhje me fitimin e gradës shkencore në drejtësi nga kandidatët për gjyqtarë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, ndër ta edhe për znj. {...}**.

15. **Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka dërguar informacionin dhe konfirmimin përkatës, ndër të tjerë edhe për kandidaten znj. {...}, me Shkresën nr. 7834/1 prot., datë 23.08.2019**, protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 4163/1 prot., datë 26.08.2019 (siç do të përshkruhet më poshtë).

16. Po më datë **06.08.2019**, në kuadër të verifikimit të kushtit të kandidimit *“të mos ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit”*, përcaktuar ne nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, por edhe në nenin 49, pika 1, të Ligjit të Statusit, por edhe të kriterit *“të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi”*, përcaktuar në shkronjën “a”, pika 2, neni 49 në lidhje me shkronjën “dh” të nenit 28, të Ligjit të Statusit, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, **u kërkua informacion nga subjektet shtetërore dhe private që kanë mbikqyrur disiplinën në punë të kandidatës znj. {...}, subjekte të cilët kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet e tyre në kohë të ndryshme** (siç do të përshkruhet më poshtë).

17. Po në kuadër të verifikimit të kushtit dhe kriterit të kandidimit si më lart (sipas pikës 13), **më datë 06.08.2019, u kërkua informacion në lidhje me punësimin e kandidatëve, ndër ta edhe për znj. {...}, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore, të cilët kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet e tyre në kohë të ndryshme** (siç do të përshkruhet më poshtë).

18. Në kuadër të verifikimit të kushtit të kandidimit *“të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike, gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit”*, përcaktuar ne nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, por edhe në nenin 49, pika 1, të Ligjit të Statusit, **u kërkua informacion nga gjykata e regjistrit të organizatave jofitimprurëse, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila, sa i përket kandidatës znj.{...} ka përcjellë informacionin e saj më datë 25.10.2019** (siç do të përshkruhet më poshtë).

19. Në vijim të verifikimit, në lidhje me kriterin e pasjes së zotësisë për të vepruar, përcaktuar në nenin 49, pika 2, shkronja “a” në lidhje me nenin 28, shkronja “a”, të Ligjit të Statusit, më datë 24.10.2019, u kërkua informacion nga gjykata e vendbanimit të kandidatës, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe nga Dhoma Kombëtare e Noterëve, të cilat kanë përcjellë informacion më datë 28.10.2019 dhe datë 30.10.2019 (siç do të përshkruhet më poshtë).

## II. REZULTATET E VERIFIKIMIT TË KUSHTEVE TË KANDIDIMIT/EMËRIMIT SI GJYQATAR I GJYKATËS SË LARTË

1. Kushtet e kandidimit/emërimit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, përcaktohen në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 136, pikat 3 dhe 4. Sipas rregullimeve në këto pika të kësaj dispozite, “3. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit. Një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhet mes **juristëve** të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës. Kandidatët që përzgjidhen nga radhët e juristëve duhet të kenë **gradë shkencore në drejtësi**. 4. Kandidati jo gjyqtar nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit. Kriteria të tjera dhe procedura e përzgjedhjes së gjyqtarit parashikohen me ligj”.

2. Po ashtu, kushtet e kandidimit/emërimit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, janë përcaktuar edhe në Ligjin e Statusit, nenin 49 (“Emërimi i kandidatëve jogjyqtarë në Gjykatën e Lartë”), pikat 1 dhe 2, shkronja “b”. Sipas rregullimeve në këto pika të kësaj dispozite, “1. Një e pesta e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë mund të përzgjidhen mes **juristëve** të spikatur, që kanë **gradë shkencore në drejtësi**, me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës. 2. Kandidatët jogjyqtarë për pozicione në Gjykatën e Lartë duhet: ...; b) të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose në pozicione drejtuese në parti politike, gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit”.

3. Konkretisht, për kandidaten {...} u verifikuan këto kushte kandidimi/emërimi:

### a) qënia jurist.

a.1 Për këtë kusht kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar (të njësuar me origjinalin) dokumentacionin:

Diplomë nr. 3081, me nr. regjistri 2177, lëshuar më datë 30.06.1994, nga Universiteti i Tiranës, sipas të cilit kandidatja Sotir{...}, në periudhën 1990 - 1994, ka kryer kursin e plotë të Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës në Degën “Drejtësi” dhe **me vendim të komisionit shtetëror të datës 30.06.1994 i është dhënë titulli “Jurist”**. Bashkëngjitur Diplomës është dhe dokumenti Vërtetim - Notash i datës 15.03.2019, nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë;

***b) përvoja profesionale prej jo më pak se 15 vjet, si avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës.***

b.1 Për këtë kusht kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar dokumentacion, sipas të cilit kandidatja ka përvojë profesionale si vijon:

*nga 01.03.1994 - 15.8.1995 - juriste pranë Bashkisë Tiranë;*

*nga 1.10.1995 - 25.7.1997 - specialist jurist pranë Ministrisë së Industrisë, Transportit dhe Tregtisë;*

*nga 25.7.1997 - 16.11.1999 - juriste pranë Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit;*

*nga 16.11.1999 - 16.11.2000 - juriste pranë Ministrisë së Punëve Publike;*

*nga 16.11.2000 - 19.2.2008 - Pedagoge pranë Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës;*

*nga 19.2.2008 e në vijim - Zëvendësdekane pranë Fakultetit të Drejtësisë Universitetit të Tiranës;*

b.2 Gjatë verifikimit, referuar subjekteve ku kandidatja figuronte të kishte qenë e punësuar sipas dokumentacionit të paraqitur, prej tyre u kërkua informacion për të dhënat e punësimit të kandidates. Konkretisht, :

- me Shkresën nr. 32148/1 prot., datë 3.9.2019, Bashkia Tiranë informon se nuk disponon informacion në lidhje me sa kërkohet dhe konkretisht: *“në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, me mbarimin e afatit të shërbimit operativ Institucioni i Bashkisë së Tiranës dorëzon dokumentet administrativë, për ruajtje dhe administrim në Arkivin Shtetëror Vendor Tiranë, në përputhje me nenin 9 shkronja ‘d’, nenit 42, nenit 43 pika ‘a’ të këtij ligji.*

- me Shkresën nr. 7631/1 prot., datë 13.09.2019, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë informon se kandidatja: *“për periudhën Tetor 1995 - Nëntor 2000, ka qënë punonjëse pranë ish Ministrisë së Industrisë, Transportit dhe Tregtisë dhe më pas ish Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, me detyrë Specialiste në Drejtorinë Juridike, nuk ka patur asnjë shkelje administrative nga ana e saj, apo masë disiplinore ndaj saj”.*

- me Shkresën nr. 990/1 prot., datë 07.10.2019, Fakulteti i Drejtësisë i Universitetit të Tiranës informon se kandidatja: *“është pedagoge me kohë të plotë që nga 16.11.2000 e aktualisht. Ajo është pedagoge pranë Departamentit të së Drejtës Civile. Që ng fillimi i marrëdhënies së punës me Fakultetin e Drejtësisë e aktualisht znj.{...} nuk ka marrë asnjë masë disiplinore dhe, si rrjedhojë nuk ka masë disiplinore në fuqi;*

b.3 Po ashtu, gjatë verifikimit, u kërkua dhe u mor informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Konkretisht:

- me Shkresën nr. 15071/1 prot., datë 13.08.2019, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ndër të tjera, informon se : “... 9. Për shtetasen {...}, nuk rezulton e regjistruar në organin tatimor me aktivitet privat ... për efekt burim të ardhura nga paga, rezulton të ketë punuar ose/dhe punon pranë subjektit: 1. UFO - Pedagoge 2. Fakulteti i Drejtësisë - Zv|Dekan”.

- me Shkresën nr. 5744/1 prot., datë 09.08.2019, Instituti i Sigurimeve Shoqërore informon për të dhëna punësimi të kandidatit për periudhën Janar 2012 e në vijim, referuar të dhënave të nxjerra nga sistemi informatik i saj, që dispononte të dhëna për kontributet që mblihdeshin dhe dërgoheshin nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet EëbService, të dhëna këto që disponoheshin nga viti 2012 dhe në vijim. Sipas të dhënave të dërguara përmes kësaj shkrese, jepen të njëjta të dhëna punësimi të kandidatës sikundër ato të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve si më lart;

- me Shkresën nr. 8468 prot., datë 19.09.2019, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë, informon për të dhënat e punësimit të kandidatës për periudhën 1994[1] - 2012, si vijon: i punësuar pranë Bashkisë Tiranë për periudhën Mars 1994 - Gusht 1995; pranë Ministrisë së Industrisë Transportit dhe Tregtisë për periudhën Tetor 1995 - Korrik 1997; Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit për periudhën Korrik 1997 - Tetor 2000, (për periudhën Korrik 1997 - Shkurt 1998, për kandidaten nuk ka lista); Fakulteti i Drejtësisë i Universitetit të Tiranës Dhjetor 2000 - Dhjetor 2012;

b.4 Sipas të dhënave të grumbulluara, kandidatja {...} del të ketë përvojë profesionale deri në momentin e kandidimit si vijon: juriste në administratën publike rreth 6 vjet e 7 muaj; pedagoge me kohë të plotë 19 vjet. **Në total, vetëm si pedagoge, kandidatja ka përvojë profesionale me kohë të plotë përmbi 15 vjet.**

### ***c) pasja gradë shkencore në drejtësi.***

c.1 Për këtë kusht kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar dokumentat:

- *Diplomë Doktorate nr. 202*, lëshuar me datë 30.7.2009 nga Universiteti i Tiranës, sipas të cilit kandidatja {...}, ka marrë titullin “Doktor”;
- *Diplomë nr. 289*, datë 18.9.2015 nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, sipas të cilit kandidatja {...}, ka marrë titullin akademik “Profesor”;
- *Dëshmi nr. 6*, datë 25.07.2012 nga Universiteti i Tiranës sipas të cilit kandidatja {...}, ka marrë titullin akademik “Profesor i Asociuar”;

c.2 Gjatë verifikimit, u kërkua dhe u mor informacion nga **Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, e cila**, me Shkresën nr. 7834/1 prot., datë 23.08.2019, **informoi dhe konfirmoi, ndër të tjera, se:**

*“...9. Grada shkencore “Doktor” në “E Drejtë Civile” e fituar nga znj. Sotir{...} figuron e regjistruar në regjistrin e KVTA-së për Gradën shkencore ‘Doktor’ me numër rendor: 82, Universiteti i Tiranës, nr. Vendimi: 17, datë 19.5.2009.*

*Të gjitha gradat shkencore të listuara më sipër, përveç gradës shkencore të fituar nga ..., i përkasin fushës së drejtësisë”.*

**ç) mbajtja e funksioneve politike në administratën publike gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit.**

ç.1 Për këtë kusht kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar një deklaratë me shkrim të datës 30.07.2019, nëpërmjet të cilës përkundrejt përgjegjësisë ligjore ka deklaruar se *“nuk kam mbajtur funksione politike në administratën publike, ..., gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit”.*

ç.2 Gjatë verifikimit, për këtë kusht kandidimi/emërimi u morën dhe vlejën të dhënat e informacioneve sipas pikës b), Kreu II, të këtij relacioni. Nga informacionet e marra nuk identifikohet ndonjë e dhënë sipas të cilës të verifikohet që kandidatja të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit.

**d) mbajtja e pozicioneve drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit.**

d.1 Për këtë kusht kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar një deklaratë me shkrim të datës 30.07.2019, nëpërmjet të cilës përkundrejt përgjegjësisë ligjore ka deklaruar se *“nuk kam mbajtur ... pozicione drejtuese në parti politike, gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit”.*

d.2 Gjatë verifikimit, për këtë kusht kandidimi u kërkua dhe u mor informacion nga gjykata e regjistrit të organizatave jofitimprurëse, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila, me Shkresën nr. 84-7/4 prot., datë 28.10.2019, sa i përket kandidates {...}, ka informuar se *“Nga verifikimet e kryera në aktet e depozituara nga subjektet politike, në regjistrin e Partive Politike pranë kësaj gjykate nuk rezulton që shtetasit ... {...}... të kenë qenë pjesë e organeve drejtuese të Partive Politike”.*

**III. REZULTATET E VERIFIKIMIT TË KRITEREVE TË KANDIDIMIT/EMËRIMIT SI GJYQTAR I GJYKATËS SË LARTË**



## **A. Për kriteret sipas nenit 49, pika 2, shkronja “a”, të Ligjit të Statusit**

**1. Disa nga kriteret e kandidimit/emërimit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, përcaktohen në Ligjin e Statusit, neni 49, pika 2, shkronja “a” në lidhje me nenin 28, shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “ë” dhe “f”.**

1.1 Sipas nenit 49, pika 2, shkronja “a”, të Ligjit të Statusit, “2. Kandidatët jogjyqtarë për pozicione në Gjykatën e Lartë duhet: a) të plotësojnë kriteret e përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “ë” dhe “f”, të nenit 28, të këtij ligji; ...”.

1.2 Ndërsa sipas nenit 28, shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “ë” dhe “f”, të Ligjit të Statusit, që parashikon kriteret e pranimit në formimin fillestar dhe bën pjesë në institutin e rekrutimit të kandidatëve magistratë, “Çdo person ka të drejtë të kandidojë në Shkollën e Magjistraturës, për t’u pranuar në formimin fillestar për magistrat, nëse përmbush njëkohësisht kriteret e mëposhtme: a) ka zotësi të plotë për të vepruar; b) është shtetas shqiptar; ...; d) nuk është dënuar me vendim penal të formës së prerë; dh) nuk është larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi; ...; ë) nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990; f) nuk ka qenë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete”.

2. Konkretisht, për kandidaten {...} u verifikuan këto kriteret kandidimi/emërimi:

### **a) zotësia e plotë për të vepruar.**

a.1 Për këtë kriter kandidimi/emërimi u mbajt në konsideratë se “zotësia për të vepruar”, si kategori juridike që i takon individit, gjen rregullim në legjislacionin civil (Kodin Civil), ndërsa i njëjti kuptim për të konsiderohet edhe kur individit është subjekt i të drejtës publike. Zotësia për të vepruar nënkupton aftësinë e personit për të qenë bartës i të drejtave dhe detyrimeve. Zotësia për të vepruar fitohet me arritjen e moshës 18 vjeç dhe, sipas ligjit, pasja e kësaj zotësie prezumohet deri në vërtetimin e heqjes apo kufizimit të saj me vendim gjyqësor të formës së prerë.

a.2 Nisur nga kuptimi i nocionit të “zotësisë për të vepruar”, referuar moshës së kandidates, ajo del ta ketë fituar këtë zotësi, ndërsa prezumohet ta ketë atë përderisa gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen apo kufizimin e saj me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Me Shkresën nr. 8407/2 prot., datë 25.10.2019 gjykata e vendbanimit të kandidatit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, informon se nga verifikimet e bëra nuk rezulton të jetë paraqitur kërkesë për heqjen e zotësisë për të vepruar për kandidaten {...}.

a.2.1 Me Shkresën nr. 2659 prot., datë 30.10.2019 Dhoma Kombëtare e Noterisë, informon se nga verifikimet e bëra nuk rezulton të jetë në listën e personave të cilëve ju është hequr zotësia për të vepruar, kandidatja {...}. Përtej kësaj, nga të dhënat e punësimit të kandidates del që ajo të jetë në marrëdhënie pune, në profesionin e pedagoges, çka indirekt nënkupton pasjen nga ajo të zotësisë së plotë për të vepruar, përderisa kjo e fundit është një nga elementet e aftësisë për të kontraktuar në një marrëdhënie juridike pune, element ky i verifikueshëm në vijimësi në kuadër të ekzistencës së kësaj marrëdhënie.

***b) shtetësia shqiptare.***

b.1 Për këtë kriter kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar dokumentin “Letërnjoftim”, lëshuar nga Ministria e Brendshme më datë 05.04.2019, ku pasqyrohet edhe përbërësi i gjendjes civile “shtetësia”, konkretisht “shqiptare”.

b.2 Gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen e shtetësisë shqiptare për këtë kandidatë. Përkundrazi, nga çertifikata personale lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Njësie Bashkiake nr. 2 Tiranë, më datë 24.10.2019, konstatohet se kandidatja vijon të ketë shtetësinë shqiptare.

***c) gjendja gjyqësore.***

c.1 Për këtë kriter kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar dokumentin “Vërtetim i gjendjes gjyqësore”, me nr. 17 prot., datë 12.03.2019, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, sipas të cilit kandidatja figuron e padënuar penalisht.

c.2 Gjatë verifikimit, u kërkua dhe u mor informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (Sektori i Gjendjes Gjyqësore), e cila, me Shkresën nr. V-2595/1 prot., datë 09.08.2019, ndër të tjera, informon se nga verifikimi i bërë në Regjistrin Themeltar të Gjendjes Gjyqësore, kandidatja rezulton e padënuar nga gjykatat penale shqiptare.

***ç) disiplina në punë.***

ç.1 Për këtë kriter kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar një deklaratë me shkrim datë 30.07.2019, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se “*gjatë karrierës time profesionale nuk jam larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk kam marrë dhe as nuk kam asnjë masë disiplinore*”.

ç.2 Gjatë verifikimit, u kërkua dhe u mor informacion nga subjektet shtetërore dhe privatë, ku kandidatja ka punuar dhe punon aktualisht.

- me Shkresën nr. 32148/1 prot., datë 3.9.2019, Bashkia Tiranë informon se nuk disponon informacion në lidhje me sa kërkohet dhe konkretisht: *“në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, me mbarimin e afatit të shërbimit operativ Institucioni I Bashkisë së Tiranës dorëzon dokumentet administrative, për ruajtje dhe administrim në Arkivin Shtetëror Vendor Tiranë, në përputhje me nenin 9 shkronja ‘d’, nenit 42, nenit 43 pika ‘a’ të këtij ligji.*

- me Shkresën nr. 7631/1 prot., datë 13.09.2019, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë informon se kandidatja: *“për periudhën Tetor 1995 – Nëntor 2000, gjatë së cilës ka qënë punonjëse pranë ish Ministrisë së Industrisë, Transportit dhe Tregtisë dhe më pas ish Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, me detyrë Specialiste në Drejtorinë Juridike, nuk ka patur asnjë shkelje administrative nga ana e saj, apo masë disiplinore ndaj saj”.*

- me Shkresën nr. 990/1 prot., datë 07.10.2019, Fakulteti i Drejtësisë i Universitetit të Tiranës informon se kandidatja: *“është pedagoge me kohë të plotë që nga 16.11.2000 e aktualisht. Ajo është pedagoge pranë Departamentit të së Drejtës Civile. Që nga fillimi i marrëdhënies së punës me Fakultetin e Drejtësisë e aktualisht znj. {...} nuk ka marrë asnjë masë disiplinore dhe, si rrjedhojë nuk ka masë disiplinore në fuqi.*

#### ***d) qënia anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990.***

d.1 Për këtë kriter kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar një deklaratë me shkrim datë 30.07.2019, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se *“nuk kam qënë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990”.*

d.2 Gjatë verifikimit, mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 30.07.2019, kandidatja dorëzoi të plotësuar formularin e aplikimit sipas Ligjit nr. 45/2015 *“Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.*

d.3 Mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit ka kryer verifikimin përkatës, duke përcjellë në Këshill, me Shkresën nr. 1177/4 prot., datë 12.09.2019, Vendimin nr. 565 datë 10.09.2019, me të cilin është vendosur: *“Të informojë institucionin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, për informacionin që kërkohet me shkresën nr. 4228 prot., datë 27.08.2019, “Kërkesë për verifikim”, të pastërtisë së figurës, përpara emërimit të kandidatit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë nga radhët e juristëve të spikatur, se nga verifikimet e kryera deri tani për znj.{...} nuk rezulton : a) të ketë*

*qenë person në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm, të ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit deri në 2 korrik 1991, në zbatim të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” sipas përcaktimeve të nenit 29 të Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.*

***dh) qenia bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete.***

dh.1 Për këtë kriter kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar një deklaratë me shkrim datë 30.07.2019, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se “*nuk kam qenë dhe nuk jam bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete*”.

dh.2 Gjatë verifikimit, në kuadër të verifikimit edhe të kriterit të figurës së kandidates, u kërkua dhe u mor informacion nga shërbimet shtetërore informative, nga të cilat nuk u bë prezent ndonjë e dhënë për qënien e kandidates, bashkëpunëtore, informatore, ose agjente e shërbimeve sekrete.

**B. Për kriterin e pasurisë sipas nenit 49, pika 5, të Ligjit të Statusit**

1. Për kandidaten {...} u verifikua kriteri i pasurisë, përcaktuar në pikën 5, të nenit 49[2] në lidhje me pikat 2 deri në 7, të nenit 32[3], të Ligjit të Statusit.

2. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidaten {...}, u kërkua raportim nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI), i cili ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor Raportin nr. 109/24 prot., datë 28.10.2019.

2.1 Sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, kandidatja {...} ka plotësuar dhe depozituar në afatin e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor formularin e deklaratës së pasurisë, si dhe autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë.

2.2 Po ashtu, sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, nga kjo e fundit janë kryer kontrole të plota për pasuritë, asetet dhe interesat e deklaruara nga kandidatja {...}, duke konkluduar se për kandidaten rezultoi:

*- Është e paqartë se, si dhe pse bashkëshorti i kandidatit, z.{...}, është bërë pronar i apartamentit në qytetin e Tiranës, përfituar me kredi të butë nga EKB, pa hequr dorë nga pronësia e apartamentit në qytetin e Korçës, pasi, sikurse citohet në kontratën e*

*përkohshme për blerjen e apartamentit në Tiranë, dt. 11.6.1996, blerësi, për të përfituar apartament nga EKB me kredi të butë, detyrohej t'i dorëzonte EKB-së banesën e përfituar nga privatizimi i banesave shtetërore.*

*- Deklarimet e bëra nga bashkëshorti i kandidatës, z.{...}, në deklaratën e interesave private të kandidatit për anëtar të Gjykatës së Lartë, si dhe në relacionin shpjegues shtesë, janë dhe mbeten shpjegime me nivel deklarativ dhe të paprovuara ligjërisht, pasi nuk kanë të bashkëlidhur dokumentacion justifikues ligjor për të provuar vërtetësinë e deklarimeve të kryera prej tij, si dhe për të provuar dhe vërtetuar veprimet (financiare ose jo) mes tij dhe shoqërive tregtare “Alb-Building”, “Mix Teknik”, “2T”, dhe “Edicom”, me të cilat ka bashkëpunuar në ndërtimin e objekteve në rrugën “Reshit Petrela”, “Ferit Xhajko”, Tiranë, Rashbull, Durrës dhe Golem, Kavajë.*

*- Mungon dokumentacioni justifikues ligjor si: pasqyrat financiare dhe librat/regjistrat e shoqërive të ndërtimit ku të jenë të pasqyruara në shifra dhe në mënyrë analitike marrëdhëniet (financiare ose jo), të z.{...}t me firmat ndërtuese, vlerat e investimeve, kontributeve në para apo në natyrë, detyrimet e firmave ndërtuese ndaj tij apo edhe anasjelltas, kthimet nga investimet. Gjithashtu mungojnë preventivë dhe situacione për punimet e kryera në objektet e ndërtuara, mandat-pagesa dhe mandate arkëtime mbi pagesat për investimet e kryera apo për shumat e përfituaranga investimet, kontrata porosie apo kontrata sipërmarrje për shitjen e apartamenteve për të cilat {...} deklaror se ka përfituar të ardhura, të cilat më pas i ka riinvestuar në ndërtim, mandate pagesa për pjesën takuese të kësteve të kredisë (450.000 USD) për të cilën deklaror se e kanë përdorur investitorët për ndërtimin e objektit, kallëzimi penal ndaj shoqërisë “EDICOM”, etj.*

*- Mbeten të paqarta dhe të paprovuara me dokumentacion justifikues ligjor vlerat dhe periudhat e investimeve (pjesa takuese) në ndërtimet e objekteve në rrugën “Reshit Petrela”, “Ferit Xhajko” Tiranë, Rrashbull, Durrës, Golem - Kavajë, dhe rrjedhimisht për këtë arsye mbeten të paqarta dhe të pajustificuara me dokumentacion ligjor edhe burimet financiare që kanë shërbyer për ndërtimin e tyre.*

*- Nuk ka të dhëna nëse me pasuritë e paluajtshme në pronësi/bashkëpronësi të bashkëshortit të kandidatës, z.{...}, janë kryer investime dhe nëse këto pasuri shfrytëzohen ose jo për ndonjë formë aktiviteti ose banimi.*

*- Lidhur me bashkëinvestimin e kryer në banesën 4 kate + papafingo+garazhe, tek Shkëmbi i Kavajës, Rrashbull, Durrës, në raportin e kontrollit përcjellë nga DTM, kryer në shoqërinë “2T” shpk, sipas situacioneve progressive, vlera në momentin e kontrollit (objekt i përfunduar) rezulton 44.835.481 lekë pa TVSH, ndërkohë që sipas Akt-Kolaudimit Tekniko-Ekonomik, vlera faktike e punimeve është 33.500.000 lekë, nga sa konstatuar mbetet e paqartë vlera e investuar dhe periudha e investimit dhe burimi financiar i përdorur.*

*- Lidhur me objektin 4 kate në Rrashbull Durrës, sipas relacionit shpjegues, në këtë objekt janë shitur 3 apartamente sa për të mbuluar një pjesë të shpenzimeve të bëra, por nga dokumentacioni i administruar rezulton se shitjet janë kryer mbasi pasuritë e paluajtshme që ishin regjistruar e rrjedhimisht, mbasi ishte përfunduar investimi dhe logjikisht të ardhurat e përftuara nga shitja e apartamenteve nuk mund të jenë përdorur si burim financiar për ndërtimin e këtij objekti.*

*- Rezulton se çmimi i shitjes së apartamentit me sip. 93.22 m2 dhe verandë me sip. 26.84 m2, në Komunën Rrashbull, Durrës, në kontratën e shitjes me kusht nr. 5803 rep, nr.615*

*kol, datë 30.12.2005, dorëzuar në DTM, është 37.288 euro, ndërsa në atë të dorëzuar në ASHK është 122.900 euro.*

*- Rezulton se bashkëshorti i kandidatit, nuk ka deklaruar të ardhura të përfituara nga shitja e 3 apartamenteve në Komunën Rrashbull, Durrës, ku referuar kontratave të shitjes, për pjesën takuese të tij prej 1/6, ai ka përfituruar 20.483 euro dhe 717.000 lekë.*

*- Mbetet e paqartë vlera e investuar dhe burimi financiar që ka shërbyer për ndërtimin e shtesës lokal shërbimi me sip. 267.28 m<sup>2</sup>, në Rrashbull, Durrës.*

*- Përsa i përket deklaramit të bashkëshortit se në datë 22.4.1998, për blerjen e zyrës në rrugën “Abdi Toptani”, Tiranë ka paguar një shumë prej 1.800.000 lekë, rezulton se kandidati në periudhën 1997-1999, deklaroi të ardhura nga Shoqëria “Kristi” sh.p.k.*

*- Lidhur me të ardhurat e deklaruara të përfituara nga z.{...} prej Shoqërisë “Kristi” sh.p.k, për periudhën 1997- 1999, në shumën 4.950.000 lekë, konstatohet se ato janë të paqarta pasi këto të ardhura bashkëshorti i kandidatit i ka deklaruar se i ka përfituruar si profesionist i lirë, projekte dhe asistencë në zbatim, por DRT Tiranë ka informuar se z.Kaskaviqi këto të ardhura i ka përfituruar nga dhënia e ambienteve me qira dhe se Shoqëria “Kristi” sh.p.k, ka deklaruar dhe ka paguar tatim në burim për qiratë.*

*- Lidhur me të ardhurat e përfituara nga Shoqëria “Marko” sh.p.k, mungon dokumentacioni justifikues ligjor, prandaj burimi financiar i shumës 40.000 USD mbetet i pajustificuar. Gjithashtu, këto të ardhura nuk rezulton të jenë deklaruar në deklaratën e interesave private të kandidatit për anëtar në Gjykatën Kushtetuese.*

*- Fondet publike të përfituara nga Shoqëria “UAECC” sh.p.k, duke lidhur kontrata me institucionet publike për shumën totale 35.973.840 lekë, janë përfituruar në kundërshtim me nenin 21 dhe 24 të Ligjit nr.9367, të datës 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.*

*- Në llogarinë e bashkëshortit të kandidatit në EURO pranë ISP Bank me nr.40053538001, konstatohet se janë kryer kreditime vlerash monetare nga Shoqëria “UAECC” sh.p.k, si dhe shtetas të ndryshëm, për të cilat nuk ka të dhëna se cili ka qënë qëllimi dhe burimi financiar i tyre.*

*- Gjatë vitit 2013 dhe 2014, konstatohet se Shoqëria “Invest Real Estate” sh.p.k, ka kryer likuidim faturash në shumën 3.827 euro, por nuk ka të dhëna se përse janë paguar këto fatura.*

*- Në një llogari tjetër në EURO me nr. 40053535103, në periudhën 2006-2007, konstatohet se z.{...}t i janë kredituar të ardhura nga qiraja në shumën 16.200 euro, për të cilat nuk ka informacion.*

*- Në një llogari tjetër në EURO me nr. 40053535103, z.{...} në datë 22.10.2008 ka transferuar në llogarinë e {...}, shumën 10.000 euro, me përshkrimin “pagesë për shërbime publike”, për të cilat nuk ka informacion.*

*- Në llogarinë e bashkëshortit të kandidatit në USD pranë ISP Bank me nr. 40053538002, konstatohet se janë kryer kreditime vlerash monetare nga Shoqëria “UAECC” sh.p.k, për të cilat nuk ka të dhëna se cila ka qënë qëllimi dhe burimi financiar i tyre.*

*- Në llogarinë e bashkëshortit të kandidatit në LEK pranë ISP Bank, me nr. 40053535102, konstatohet se janë kryer kreditime vlerash monetare nga Shoqëria “UAECC” sh.p.k, për të cilat nuk ka të dhëna se cila ka qënë qëllimi dhe burimi financiar i tyre.*

- Lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për blerjen e tokës në Mullet, nisur nga fakti se shuma prej 15.000 euro, e cila është paguar në datën 01.08.2012 dhe shuma 18.500 euro e tërhequr në datë 16.12.2013, kanë pasur si burim kreditimet e kryera në llogarinë e z.{...}t në Intesa SanPaolo Bank, prandaj burimi financiar i shumës 33.500 euro mbetet i paqartë.

- Lidhur me shumën 30.000 euro, që ka shërbyer për blerjen e tokës në Mullet, deklaruar me burim nga arkëtimi i të ardhurave nga investimi në Golem, Kavajë, nisur nga fakti se rezultoi që nga ndërtimi i objektit në Golem, Kavajë, {...}, ka përfutur me kontratë shitje vetëm 3 apartamente dhe 3 garazhe, nga të cilat 2 apartamente dhe 3 garazhe, i ka ende në pronësi dhe vetëm një apartament rezultoi i shitur, por edhe ky rezultoi i shitur në vitin 2015, me çmimin 10.970 euro, rrjedhimisht edhe në këtë rast burimi financiar i shumës 30.000 euro mbetet i paqartë.

- Lidhur me të ardhurat e përfuturara si ortak në Shoqërinë "UA ECC" sh.p.k, bashkëshorti i kandidatit ka paraqitur vendimet e shoqërisë për shpërndarjen e fitimit, por nuk ka të dhëna nëse këto vendime janë të regjistruara në regjistrat e shoqërisë në përputhje me ligjin për shoqëritë tregtare, ku në bazë të nënit 81, pika 1 dhe 3, sanksionohet së Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë (në këtë rast ortaku i vetëm), është i detyruar që vendimet për shpërndarjen e fitimeve të regjistrojë në regjistrin e vendimeve.

- Nisur nga fakti se Shoqëria "UA ECC" sh.p.k, për të dokumentuar fitimin e ortakut Kostaq Koskaviqi, ka prodhuar 3 (tre) dokumente me përmbajtje të ndryshme nga njëri-tjetri, është e paqartë se mbi ç'rregjistra është bazur ajo për prodhimin e këtyre vërtetimeve. Gjithashtu, lidhur me tërheqjen e fitimit të ortakut, mbetet e paqartë periudha kohore në të cilën ortaku ka tërhequr fitimin nga banka ose nga arka e shoqërisë, pasi mungon dokumentacioni justifikues ligjor nga tërheqja e tij.

- Lidhur me deklarin e bashkëshortit të kandidatit për të ardhurat e përfuturara si pronar truall nga objekti shumëkatësh në rrugën "Reshit Petrela", Tiranë, konstatohet se ky deklarin nuk rezultoi të jetë deklaruar më parë në deklaratën e interesave private të kandidatit për anëtar të Gjykatës Kushtetuese.

- Për sa i përket shumës 110.000 USD të kredituar nga Shoqëria "EDICOM" sh.p.k, në llogarinë e bashkëshortit të kandidatit, konstatohet se përveç përshkrimit të transaksionit bankar "kthim detyrimi sipas rakordimit", nuk ka asnjë të dhënë tjetër apo dokumentacion justifikues ligjor që të qartësojë dhe të provojë arsyet e këtij kreditimi.

2.3 Sipas Raportit të ILDKPKI-së, "Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr.9049, datë. 10.04.2003, "Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nënpunësve publikë", i ndryshuar, ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar, si dhe ligjin nr.96/2016 "Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", konstatohet se për kandidatin {...};

- a) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin,
- b) ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasurinë,
- c) ka mosdeklarim të pasurisë,
- d) nuk ka kryer deklarin të rremë,

e) kandidati ka përfitur të ardhura në kundërshtim me ligjin 9367/2005, i ndryshuar.

3. Më datë 30.10.2019, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Vendimin 75/2019, kandidatja, znj. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua: - për përfundimin e raportit të ILDKPKI-së, raport ky që i është bashkëngjitur njoftimit; - për të drejtën që kishte për të paraqitur shpjegime dhe dokumenta të tjera përpara Këshillit, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

4. Me datë 11.11.2019, kandidatja, znj. Kestin {...}, pasi iu miratua kërkesa nga relatori për shtyrje të afatit, **depozitoi pretendimet e saj lidhur me raportin e ILDKPKI-së duke i shoqëruar me dokumentacionin dhe argumentat përkatës si më poshtë :**

*“1. Lidhur me faktin pse bashkëshorti {...} nuk ka hequr dorë nga pronësia e apartamentit në Korçë kur ka përfitur banesën në Tiranë, sqaroj se VKM nr.291, datë 21.06.1994, në pikën 2 të tij parashikon shprehimisht situatën e një kategorie përfituesish banesash nga EKB, të cilët kanë përfitur më parë nga privatizimi i banesave dhe nuk i dorëzojnë ato. Në këtë pikë parashikohet edhe pagesa me kredi 3.5% interes në vit, interes që zbatohet vetëm dhe vetëm për këtë kategori. Me shkresë të Kryeministrit nr.940 prot, datë 04.04.1995, drejtuar EKB dhe Ministrisë së Ndërtimit dhe Turizmit, është miratuar lista nominale e përfituesve të banesave që do të ndërtoheshin nga EKB, ku del qartë se bashkëshorti im nuk duhet të dorëzonte banesë. Në EKB Tiranë gjendet dosja e plotë për përfitimin e kësaj banese nga ne. Bashkëngjitur shkresa dhe VKM-të e sipërcituara.*

*Pretendimi se deklaratimet dhe relacioni shpjegues mbeten deklarative, se nuk shoqërohen me prova, mendoj se nuk qëndron. Së pari, marrëdhëniet e bashkëshortit me firmat e ndërtimit të përmendura dhe shoqërinë “Mix Tecnic” janë marrëdhënie që provohen nëpërmjet kontratave apo marrëveshjeve të ndryshme, të cilat janë dorëzuar në ILDKPKI. Koha kur janë krijuar këto marrëdhënie është shumë e largët, sepse kryesisht këto marrëdhënie janë krijuar në periudhën 2002-2003 (gati 2 dekada më parë), kur kanë filluar investimet e këtij grupi investitorësh, pjesë e të cilit ka qenë edhe bashkëshorti im. Fakti që unë nuk kam qenë subjekt deklarimi në këto vite (as nuk ka pasur një ligj për deklaratimet në këto vite), ka bërë që këto marrëdhënie të ishin tërësisht private dhe të rregulloheshin si i mendonin më mirë palët. Edhe konteksti i zhvillimit të shoqërisë shqiptare ishte fare i ndryshëm nga tani. Kryesisht marrëdhëniet e palëve ishin joformale. Madje, janë shitur pasuri të paluajtshme pa akte noteriale. Edhe pagesat në periudhën që flasim bëheshin pothuaj 100% me para në dorë në të gjithë Shqipërinë. Për me tepër, edhe vetë shteti nuk përdorte bankat për kryerjen e pagesave. Të gjitha pagat e punonjësve shtetërorë të të gjitha niveleve nuk realizoheshin nëpërmjet bankave. Në kontekstin e kohës kur janë kryer investimet, ky grup investitorësh ndoshta ka edhe sasinë më të madhe të dokumentave provues, sepse për pronësi që janë regjistruar që në 2005 në ZRPP nuk ka më interes për të mbajtur dokumentat që kanë çuar në regjistrim. Ndoshta pasja e një sasi më të madhe dokumentash lidhur me objektin në rrugën “Reshit Petrela” (sot “Asim Vokshi”), vjen si rrjedhojë se kjo marrëdhënie nuk është mbyllur ende përfundimisht ndërmjet grupit të investitorëve, gjë që provohet nga pasuritë që kemi ende në bashkëpronësi.*

*Për investimin në rrugën “Reshit Petrela” kam mundur të gjej një sasi mandatpagesash (120 mandatpagesa) të bëra nga blerësit gjatë kohës që ndërtohej objekti. Gjithashtu, po ju vë në dispozicion emrat e pronarëve të njërive lokale dhe të apartamenteve, sepse këto emra dalin si pages të shumave të ndryshme për objektin në rrugën “Reshit Petrela”.*



Si çdo ndërtim në Shqipëri, edhe ndërtimi i investuar në rrugën “Reshit Petrela” është investuar kryesisht nga shumat e përfituara nga pagesat e bëra nga blerësit e ardhshëm gjatë kohës që ndërtohej objekti, sipas kontratave të porosisë që lidheshin me ta. Kontratat e porosisë kanë vlerë juridike deri në lidhjen e kontratave të shitjes, të cilat janë lidhur menjëherë pas regjistrimit të objektit në ZRPP Tiranë në vitin 2005. Nisur nga ky fakt është e pamundur të gjenden kontratat e porosisë 14 vjet pas lidhjes të kontratave të shitjes dhe regjistrimit të tyre në ZRPP, por mandatpagesat provojnë qartësisht pagesat e bëra nga pronarët e ardhshëm të njërive të ndryshme, gjatë ndërtimit të objektit.

2. Pretendohet që unë duhet të paraqes pasqyra financiare apo libra, regjistra të shoqërive të ndërtimit ku të pasqyrohen investimet e bëra nga bashkëshorti {...}. Shoqëritë tregtare detyrohen të ruajnë dokumentat financiare për efekt kontabiliteti 10 vjet dhe kontrolli tatimor ndaj tyre mund të ushtrohet vetëm për 5 vitet e fundit. Për më tepër, pasqyrat financiare janë në diskrecion të shoqërisë. Për të provuar investimit janë dorëzuar kontratat e investimit.

Gjithashtu, asnjëherë nuk është pretenduar se kredia 450.000\$ është marrë nga bashkëshorti im. Kontrata e dorëzuar nga ne e tregon qartë që kredia është marrë nga firma ndërtuese “Alb-Building”, njëkohësisht edhe një nga investitorët e objektit në rrugën “Reshit Petrela”, por kolateral për marrjen e kësaj kredie ka shërbyer pikërisht trualli mbi të cilin po bëhej investimi, një nga pronarët e të cilit është {...}. Mbi këtë truall është dhënë hipotekë nga pronarët e tij për sigurimin e kredisë së marrë nga “Alb-Building”. Si rrjedhojë, pronarët e truallit (përfshirë bashkëshortin) po rrezikonin pjesët takuese si pronar trualli në objektin që po ndërtohej për të siguruar këtë kredi, pikërisht sepse kredia po kërkohet për tu investuar në këtë objekt për llogari të gjithë investitorëve. Ky fakt provohet edhe nga deklaratat e lëshuar nga vetë shoqëria “Alb-Building”. Gjithashtu, nuk kemi deklaruar në asnjë moment se kemi bërë pagesa për kthimin e kredisë, sepse pagesat janë bërë nga kredimarrësi “Alb-Building”, por kostoja e kredisë është përballuar nga të gjithë ne investitorët, dmth i është shtuar kostoja së objektit. Lidhur me kallëzimin e bërë ndaj “Edicom” dhe Ilir Manushit, bashkëngjitur ky kallëzim. Nuk e kam dorëzuar, sepse nuk kam menduar se kishte rëndësi në vlerësimin e deklaratës së pasurisë.

3. Pretendimet se mbeten të paprovuara me dokumente justifikues investimet e bëra nga bashkëshorti im, nuk qëndrojnë, sepse janë paraqitur 3 marrëveshje që bashkëshorti ka lidhur me firmat ndërtuese për njohjen prej tyre si kontribut të projektit dhe punës së tij në konsulencën teknike për zbatimin e projektit. (Marrëveshja me “Alb-Building” e datës 12.02.2002; Marrëveshjet me “2T” të datave 05.09.2003 dhe 15.01.2004). Për pjesën e investimit të deklaruar në para, ajo ka qenë një marrëdhënie e brendshme me bashkinvestitorët që është mbyllur me ndarjen e pjesëve takuese secilit investitor. Koha e investimeve është kryesisht në vitet 2002-2005 dhe siç kam shpjeguar më lart pagesat bëheshin kryesisht me para në dorë. Është e pamundur që të gjenden dokumenta që 15 vjet më parë për këto investime që nuk kanë pasur konflikt mes investitorëve për mënyrën e ndarjes së tyre.

4. Pretendimi se nuk janë sqaruar në janë bërë investime në prona dhe për çfarë përdoren pronat nuk qëndron si pretendim, sepse për verandën që është mbuluar dhe është legalizuar si shtesë e zyrës në Rrugën “Reshit Petrela” Tiranë, ku zhvillon aktivitetin UAEC, është dorëzuar dokumentacion. Gjithashtu, janë deklaruar kontratat e qirave për zyrën në rrugën “Abdi Toptani” dhe dyqanin në rrugën “Reshit Petrela” (sot Asim Vokshi). Edhe zyra në rrugën “Reshit Petrela” është deklaruar se përdoret nga UAEC. Pra, për ato pasuri që kanë pasur ndryshime apo që kanë sjellë fruta civil, janë treguar specifikisht në deklarim.

*Për të tjerat nuk ka një rubrikë të veçantë në deklaram ku të kërkohet se cila është situata e përdorimit të tyre aktual, ndaj edhe nuk është bërë një specifikim i tillë nga ne, por asnjëra nuk përdoret për qëllim fitimi. Pronat në Golem të Kavajës nuk përdoren fare. Është bërë pezullimi i kontrtave për furnizim me energji elektrike.*

*5. Bashkëshorti im nuk është pronar apo administrator i shoqërisë “2T” shpk dhe nuk di fare se si është akti i kontrollit nga tatimet për objektin në Rrashbull, Durrës. Për më tepër, afatet ligjore për ruajtjen e dokumentave për efekt kontabiliteti janë 10 vjet. Shoqëria “2T” shpk, pasi kontrolloi, më konfirmoi se nuk gjen në dokumentat e ruajtur akti kontrolli të tatimeve për situacionin objekt ipërfunduar nëRrashbull (shkëmbi i Kavajës). Akt-kolaudimi shpreh kostot faktike të ndërtimit të godinës, por në godinë mund të bëhen investime të tjera shtesë edhe pas aktit të kolaudimit. Akti i kolaudimit konfirmon se ndërtimi është funksional dhe mund të vihet në përdorim. Ai shërben për regjistrimin fillestar të objektit. Ndërsa në aktin e kontrollit nga tatimet, përfshihen të gjitha shpenzimet e bëra për godinën. Për shkak të kohës së gjatë, shoqëria “2T” shpk nuk është në gjendje të shpjegojë saktësisht këtë situatë. Duhet theksuar se të gjitha detyrimet tatimore janë përmbushur duke iu referuar vlerës së aktit të kontrollit tatimor, që është dhe vlera më e madhe ndërmjet dy akteve. Pra, është paguar TVSH afërsisht 9.000.000 lekë (ndërkohë që sipas vlerës së aktit të kolaudimit do të paguhej 6.700.000 lekë). Si rrjedhim, nuk ka pasur asnjë përfitim si për shoqërinë ashtu edhe për investitorët deklarimi i një vlerë më të vogël në akt kolaudim. Është një disakordancë që mendoj se nuk ka asnjë efekt në deklaramet e pasurisë. (Vërtetim nga shoqëria “2T” shpk)*

*6. Edhe në objektin në Rrashbull Durrës, ashtu siç kam sqaruar më lart për në Tiranë, pagesat janë bërë kryesisht gjatë ndërtimit të objektit, por kontratat e shitjes janë lidhur pas regjistrimit të objektit. Për shkak të kohës së gjatë prej 14 vitesh nga lidhja e kontratave të shitjes, nuk ka dokumentacion të ruajtur, edhe për faktin se nuk ka pasur asnjë mosmarrëveshje ndërmjet bashkinvestitorëve. Kam sqaruar më lart afatet për ruajtjen e dokumentave. (Vërtetim nga shoqëria “2T” shpk)*

*7. Lidhur me kontratën e shitjes së njërit prej apartamenteve me blerës Marie Marshall me sip.93.22m2 dhe verandë me sip.26.84m2, ne nuk kemi dijeni për vlerën 122.900 euro të deklaruar ASHK. Vlera e njohur nga ne është vlera 37.288 euro, vlerë e cila përkon edhe me vlerat e shitjes në atë zonë në kohën kur ne kemi bërë investimin (vitet 2003-2004), madje është një vlerë e mirë për kohën. Është absolutisht absurde që të mund të jetë shitur tek Shkëmbi i Kavajës, ku as rrugë makine nuk kishte, në vitin 2004 një apartament me rreth 1.200-1.300 euro/m2. Me vlera të tilla nuk shiteshin as apartamentet në Tiranë në zonën e bllokut. Është një vlerë e mirë për zonën dhe kohën vlera 350-400 euro/m2. Edhe dy apartamentet e tjera janë shitur me çmime modeste.*

*Kontratat që lidheshin me klientët përgatiteshin gjithnjë nga “Mix Tecnic” (Irir Manushi), që ishte në rolin e menaxhuesit të investimeve. Ky fakt provohet nga të gjitha kontratat e investimit që lidhin grupi i investitorëve, ku “Mix Tecnic” është palë në to dhe caktohet si përfaqësues i investitorëve. Edhe kontratat me pronarët e truallit ku bëhen ndërtimet i ka lidhur “Mix Tecnic”.*

*Situata e konstatuar nga ILDKPKI është e pamundur të sqarohet nga ne, për shkak se kanë kaluar 14 vjet nga lidhja e kësaj kontrate dhe është përmbushur çdo afat i mundshëm parashkrimi, ndaj nuk mund të ndërmerret asnjë iniciativë ligjore.*

*8. Lidhur me pretendimin se nuk janë deklaruar të ardhurat nga investimi në Rrashbull Durrës, nuk i kemi deklaruar këto të ardhura, sepse siç kemi deklaruar në relacionin*

shpjegues, këto vlera janë përdorur për të mbuluar disa nga kostot e ndërtimit të objektit. Është gabimi ynë dhe duhet t'i kishim deklaruar duke sqaruar në relacion se nuk i kemi arkëtuar këto të ardhura, sepse kanë shkuar në investimin e objektit. Mosdeklarimi është thjesht një gabim perceptimi, por shitja e tre apartamente është përmendur në relacionin shpjegues. Për sa i përket shumave të përfituara nga shitja e tre apartamenteve, ato janë 37.288 euro dhe 4.300.000 lekë për të gjithë investitorët së bashku. Nuk ka pasur ndarje ndërmjet nesh, për sa sqarova më lart në këtë pikë.

9. Lokali në katin përdhe në ndërtimin në Rrashbull Durrës është ndërtuar që në fillim në sipërfaqen 267.28 m<sup>2</sup>, por është regjistruar nga ZRPP Durrës me sipërfaqe 164 m<sup>2</sup>. Më pas është bërë kërkesë për legalizimin e pjesës së paregjistruar. Pra, lokali ka qenë që në fillim 267 m<sup>2</sup> dhe vlera e plotë e tij është e përfshirë në vlerën e plotë të objektit. Si rrjedhim, ne nuk kemi bërë investime shtesë për sipërfaqen e legalizuar të këtij lokali. Akt-kolaudimi i objektit e ka qartë të shprehur sipërfaqen 267.28m<sup>2</sup> të lokalit. Bashkëlidhur akti i kolaudimit të objektit Rrashbull Durrës.

10. Lidhur me konstatimin se të ardhurat e arkëtuara nga shoqëria "Kristi" shpk në shumën 4.950.000 lekë në periudhën 1997-1999, për të cilat DRT Tiranë i konfirmon ILDKPKI-së se është paguar tatim në burim për to, por për dhënie ambientesh me qira, theksojmë se {...} nuk mund t'i përfitonte këto vlera për dhënie ambientesh me qira, sepse e vetmja pasuri që {...} kishte në këtë periudhë ishte 1/3 e banesës në Korçë. Për këtë arsye iu drejtua sërish me shkresë DRT Tiranë duke kërkuar saktësim të shkresës Nr.20826/1 prot, datë 10.05.2019 drejtuar ILDKPKI-së. Në përgjigje të kësaj kërkesë është bërë konfirmimi nga DRT Tiranë me shkresën Nr.52588/1 prot, datë 06.11.2019 se "tatim në burim për {...}n është paguar për shumën 5.500.000 lekë për kontratat e shërbimeve nga shoqëria "Kristi" shpk".

Pra, DRT Tiranë me saktësimin e bërë, konfirmon se deklarimi i bërë nga ne është i saktë dhe është paguar tatimi në burim për shumën (bruto) 5.500.000 lekë, duke provuar edhe të ardhurën 4.950.000 të arkëtuar nga kontrata me shoqërinë "Kristi", që ka shërbyer për pagesën e shumës 1.800.000 lekë, bërë në 1998 për blerjen e zyrës në rrugën "Abdi Toptani", Tiranë. (Bashkëlidhur shkresa Nr.52588/1 prot, datë 06.11.2019 e DRT Tiranë)

11. Lidhur me deklarimin e shumës rreth 40.000 USD të përfituara nga shoqëria "Marko" shpk, kam shpjeguar në deklaram se kisha kërkuar informacion, por nuk kisha marrë ende përgjigje. Në muajin prill kam kërkuar informacion edhe për këto të ardhura, por mqs nuk dinim NIPT-in e shoqërisë dhe në sistem dinin disa subjekte me të njëjtin emër, nga DRT Tiranë u informova që ishte e pamundur të pajisesh me informacion për këtë subjekt pa pasur NIPT të tij. Për këtë arsye kjo shumë nuk është përfshirë në deklarimin e muajit prill. Me shumë vështirësi arrita të gjej NIPT të këtij subjekti, që kishte mbyllur aktivitetin, dhe t'i drejtohem sërish DRT Tiranë për informacion, të cilin nuk arrita ta marr deri në datën 6 shtator 2019, që ishte afati i fundit i dorëzimit të deklaratës së pasurisë në ILDKPKI. Në deklaratë shënova që kam bërë kërkesë në DRT Tiranë, por ende nuk kam marrë përgjigje. DRT Tiranë më informoi se "Marko" shpk për kohën kur unë kërkoja informacion ka qenë subjekt që është ndjekur nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, ndaj duhet të interesohesha atje. Në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj më informuan se gjithë dokumentacioni shkresor ishte dorëzuar në DRT Tiranë. Sërish ju drejtova për herë të tretë me kërkesë DRT Tiranë, e cila më në fund, pasi gjeti dosjen, më pajisi me vërtetimin përkatës nr.42965/1 prot, datë.11.09.2019 (po e dorëzoj bashkëlidhur). Nga vërtetimi i lëshuar nga DRT Tiranë konstatova se shoqëria "Marko" shpk ka paguar tatim në burim për {...}n vetëm 360.000 lekë, dmth për vlerën 3.600.000 lekë. Kjo shumë përkon me vlerën

e vetëm njëerës nga kontratat e lidhura me këtë shoqëri. Si rrjedhim, {...} ka përfituar në vlerë neto nga kjo kontratë për të cilën është paguar tatimi në burim, shumën 3.240.000 lekë apo rreth 24.000 USD. Mungesa e dokumentacionit justifikues për këtë pikë nuk ka ardhur për fajin tonë, por për shkak të vështirësive për sigurimin e këtij informacioni. Gjithashtu, edhe nëse nuk do të kishte fare pagesë të tatimit në burim, shuma rreth 40.000 USD që është deklaruar si të ardhura nga kontratat me “Marko” shpk, nuk i bën të paligjshme këto të ardhura, sepse **“koncepti i pasurisë së ligjshme lidhet me burimin e krijimit të këtyre pasurive apo të ardhurave dhe jo me pagimin e detyrimeve tatimore të tyre. Një e ardhur nuk klasifikohet në sistemin financiar si e paligjshme nëse për të nuk janë paguar tatimet dhe taksat[4]”**. (Bashkëlidhur 2 kontratat me shoqërinë “Marko” shpk)

12. Lidhur me pretendimin e ILDKPKI-së se fondet publike të përfituara nga shoqëria “UA ECC” shpk në shumën totale 35.973.840 lekë, janë përfituar në kundërshtim me nenin 21 dhe 24 të ligjit 9367, datë 07.04.2005 (i ndryshuar), unë sqaroj sa më poshtë:

Neni 21, pika 1 përcakton: “Asnjë individ, kur ky njësohet me një zyrtar në njërin nga funksionet e përcaktuara në kreun III, seksioni 2 të këtij ligji, gjyqtarët e prokurorët në nivelin e gjykatës së shkallës së parë e në atë të apelit, dhe asnjë shoqëri tregtare, ortakëri a shoqëri e thjeshtë, ku ky zyrtar zotëron, në mënyrë aktive apo pasive, aksione a pjesë në kapital, në çfarëdo sasive, nuk mund të lidhë kontratë ose nënkontratë me asnjë institucion publik....”. Kur shkoj tek nenet e seksionit 2 ku referon neni 21, nuk e gjej veten (si anëtare e bordit të Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare) në asnjë nga kategoritë që rregullon ky seksion, sepse nuk kam qenë ministre apo zëvendësministre, deputete, drejtuese e pushtetit lokal, zyrtare e nivelit të lartë apo të mesëm i administratës publike (drejtor i përgjithshëm apo drejtor drejtorie) etj. I vetmi nen ku gabimisht mund të mendohet se përfshihem është neni 30, i cili parashikon ndalime për anëtarët e organit të një autoriteti rregullator, por edhe këtu nuk përfshihem, sepse AMF (Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare), siç e përcakton edhe vetë emërtimi, është autoritet mbikqyrës dhe jo rregullator. AMF mbikqyr shoqëritë e sigurimeve, tregjet e titujve dhe institucionet financiare jobanka, të cilat janë të gjitha subjekte private. Për këtë arsye mendoj se nuk është i përfshirë si subjekt në kategoritë që rregullon neni 30. Neni 30 ka përmbajtje shteruese dhe përcakton si kategori: autoritetet rregullatore, autoritetin e konkurrencës, Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin e Bankës së Shqipërisë, si dhe bordin e Bankës së Shqipërisë. Pra, në perceptimin tim, unë nuk përfshihem në asnjë kategori nga ato sa më lart. Madje, kjo provohet edhe ngavetë relacioni i ILDKPKI-së, në të cilin nuk është referuar neni 30 si bazë ligjore e përfitimit të padrejtë të fondeve publike nga shoqëria “UA ECC” shpk. Gjithësesi, edhe sikur të përfshihesha në këtë kategori, ky nen përcakton shprehimisht se “...një zyrtar i tillë nuk mund të zotërojë asnjë të drejtë, të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, sipas kuptimit të nenit 25 pika 2 të këtij ligji, në raport me çdo subjekt, që ushtron veprimtari në sferën e juridiksionit ose të ndikimit të këtij autoriteti, përfshirë ndalimin e plotë të zotërimit, në mënyrë aktive apo pasive, të aksioneve në këto shoqëri.”. Pra, ndalimet do të shtriheshin vetëm për marrëdhënie me subjekte që ushtrojnë veprimtari në sferën e juridiksionit të AMF, sferë ku nuk bëjnë pjesë: Qendra Spitalore “Nënë Tereza”, Komuna Petrelë, Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës apo ZABGJ, sepse asnjëra prej tyre nuk është shoqëri sigurimi apo treg i titujve ose institucion financiar jobankë. Të gjitha këto kontrata janë kontrata shërbimi projektimi. Për më tepër, unë si anëtare e bordit të AMF-së, si mund të ndikoja në lidhjen e këtyre kontratave që rrjedhin të gjitha nga procedura të hapura prokurimesh publike? Gjatë viteve 2011-2014 të vetmet kontrata që bashkëshorti im ka lidhur dhe që kanë lidhje me sferën e juridiksionit të AMF-së, janë kontratat për sigurimin e makinës personale dhe makinës në pronësi të UA ECC, kontrata

këto ligjërisht të detyrueshme për tu lidhur dhe që nuk përfshihen në sferën e konfliktit të interesave. Me parashikimet e pikave të tjera të nenit 21 unë nuk kam asnjë lidhje, sepse trajtojnë raste ku unë si subjekt nuk përfshihem. Ndërsa neni 24, që përcakton kufizime për interesat e personave të lidhur me zyrtarin, nuk shtrin efektet mbi bashkëshortin tim, sepse siç sqarova më lart, kontratat e lidhura nga "UAECC" shpk, ku ai është ortak i vetëm, në periudhën shtator 2011-dhjetor 2014 (kur unë kam qenë anëtare e bordit drejtues të AMF-së) ka lidhur kontrata me subjekte që nuk përfshihen në sferën e juridiksionit të AMF-së. Së fundmi, edhe sikur "UAECC" shpk të kishte lidhur kontrata në kundërshtim me nenin 21 dhe 24 të ligjit 9367 gjatë kohës që unë dhe bashkëshorti plotësonim deklaratën e interesave pasurore në ILDKPKI, ishte detyrë e ILDKPKI-së të konstatonte këtë fakt dhe të ma bënte atë prezent, si dhe të më detyronte ta zgjidhja atë. Pas 5 vitesh që më ka përfunduar mandati në AMF, nuk mund të pretendohet për përfitime fondesh publike në kundërshtim me ligjin 9367, sepse unë si subjekt nuk kam asnjë mundësi për ta ndryshuar të kaluarën.

13. Lidhur me pretendimin se mbeten të paqarta kreditimet nga UAECC në favor të {...}t në llogarinë e tij në EURO në ISP Bank, ky pretendim nuk qëndron. Në vendimet e asamblesë së ortakëve të UAECC shpk për miratim bilanci dhe shpërndarje dividenti, të depozituara në ILDKPKI, një nga pikat e vendimit përmban edhe mënyrën e tërheqjes së dividendit nga ortaku i vetëm {...}. Ortaku mund t'i tërhiqte shumat përkatëse në momentin që dëshironte, tërësisht apo pjesërisht, nga banka apo arka. Vetë aktiviteti që zhvillon UAECC shpk si studio projektimi në arkitekturë dhe urbanistikë, nuk i krijon mundësi kësaj shoqërie të ketë të adhura konstante apo thuaj konstante për çdo muaj. Ajo ndodh të ketë të ardhura edhe vetëm 2 apo 3 herë në vit, por edhe këto janë të pasigurta se kur do të jenë. Si rrjedhim, sa kohë ka qenë me statusin Biznes i Vogël shoqëria "UAECC" shpk, kur ortaku nuk duhet të paguante tatim fitimi për dividendin, janë bërë vendimet e asamblesë për shpërndarjen e fitimit dhe ky fitim është arkëtuar pjesë-pjesë nga ortaku, nga banka apo nga arka, kur ka pasur të hyra (kreditime) të reja në shoqëri. Në këtë rast nuk ka asnjë shkelje ligjore, sepse nuk ka një normë urdhëruese në asnjë ligj që ta detyronte të vepronte ndryshe. Për më tepër, nëse dividenti do të arkëtohej njëherësh dhe tërësisht nga ortaku, shoqëria UAECC mund të mos kishte mjete monetare të mjaftueshme për të përballuar pagat, sigurimet, shpenzimet dhe taksat apo tatimet deri në momentin që do të realizohej një pagesë e re nga një klient i saj. Për të mos krijuar situata të tilla në shoqëri dhe për sa kohë ligji nuk e pengon një gjë të tillë, dividenti është marrë kur dhe si e ka parë më të arsyeshme për mirëfunksionimin e shoqërisë ortaku i vetëm i saj dhe njëkohësisht administrator i shoqërisë, {...}. Me këto veprime nuk ka shkelur asnjë ligj. Kalimin e të gjitha vlerave deri në shumën totale të dividendit të përfituar, në çdo monedhë qofshin, nga UAECC te {...}, e bën të vlefshëm e drejta e tij si ortak i vetëm për të përfituar nga të ardhurat e shoqërisë, për sa kohë ka shlyer të gjitha detyrimet tatimore që parashikon ligji.

14. Lidhur me pagesat e bëra nga shoqëria "Invest Real Estate" shpk në favor të {...} në shumën 3.827 euro, në periudhën dhjetor 2013-prill 2014, janë pagesa të bëra për një kontratë qiraje për zyrën në rrugën "Abdi Toptani". Mosdeklarimi i këtyre të ardhurave është harresë nga ne. (Bashkënlidhur kopje të kontratës së qirasë dhe faturave tatimore për pagesën e tatim fitimit për këtë kontratë)

15. Pretendimi se shuma 16.200 euro nuk është deklaruar nga ne, është i drejtë. Për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar është harruar kjo marrëdhënie qiraje, ndaj edhe nuk është deklaruar kjo shumë. Shuma 16.200 euro është e ardhur nga kontratat qirasë Nr. Rep 1530, Nr. Kol 226, datë 06.05.2005 dhe Nr. Rep 2335, Nr. Kol 1690, datë 15.05.2007 me shoqërinë "THE POINT" shpk. Në nenin 20 të këtyre kontratave është parashikuar se taksat janë në

*ngarkim të qiramarrësit. Kontrata e dytë është zgjidhur para përfundimit të afatit për shkak të mospagesës në kohë nga qiramarrësi. Bashkëlidhur këto kontrata.*

*16. Lidhur me transfertën e shumës 10.000 euro nga llogaria personale e {...}t në llogarinë personale të {...}s, më duket një konstatim i tepërt. Sipas Kodit të Familjes çdo pasuri e fituar gjatë martesës është në bashkëpronësi të të dy bashkëshortëve. Si rrjedhim, nuk është e nevojshme që të justifikohen lëvizjet e shumave të parave ndërmjet nesh. 10.000 euro, ishin në llogarinë time personale apo në atë të bashkëshortit, nuk bën dallim, sepse janë pjesë e bashkëpronësisë gjatë martesës.*

*17. Sqarim i plotë i dhënë në pikën 14.*

*18. Sqarim i plotë i dhënë në pikën 14.*

*19. Burimi financiar i shumës 33.500 euro nuk është aspak i paqartë, sepse vjen nga një llogari bankare ku janë kredituar vlera të ardhura nga investimet, nga fitimet e shoqërisë dhe nga të ardhurat nga kontratat e qirave, për të cilat janë paguar gjatë gjithë kohës tatimet në burim. Vetëm të ardhura nga UAECC në periudhën 2000-2010 {...} ka përfituar në shumën 37.442.000 lekë, për të cilat janë paguar në mënyrë të rregullt të gjitha detyrimet tatimore, siç provohet edhe nga DRT Tiranë. Pavarësisht konstatimeve të ILDKPKI-së, ato janë të ardhura të ligjshme nga një aktivitet i ligjshëm, të ardhura nga të cilat një pjesë janë investuar në krijimin e pasurive që ne kemi aktualisht, si dhe në blerjen e tokës në Mullet.*

*20. Lidhur me investimin në Golem, Kavajë, për këtë objekt është dorëzuar kontrata e investimit, lidhur në 2003, e cila është lidhur me vërtetim nënshkrimi, pra është e regjistruar tek noteri që ka bërë vërtetimin e nënshkrimeve. Në këtë kontratë del qartë se {...} është njëri nga investitorët e objektit në fjalë. Në kontratë është shprehur qartë se të gjitha detyrimet tatimore për investitorët do të përmbusheshin nga Ndërtuesi ("2T" shpk). Gjithashtu, është dorëzuar edhe marrëveshja me Ndërtuesin "2T" shpk, ku ndërtuesi pranon projektin dhe konsulencën në ndjekjen e këtij projekti, si kontribut në investim. Në relacionin shpjegues është sqaruar se në këtë investim ne nuk synonim të përfitonim njësi në objekt, por donim vetëm të përfitonim të ardhurat nga shitja e këtyre njësive. Për shkak se ky investim nuk rezultoi një investim fitimprurës, investitorët bënë edhe një ndarje të njësive takuese për secilin (marrëveshje e datës 16.01.2008), me qëllim që secili investitor të interesohej për shitjen e njësive të tij takuese dhe të përfitonte drejtëpërdrejtë nga shitja e tyre. Mqs edhe pas 5 vitesh që objekti ishte regjistruar në emër të Ndërtuesit, ende nuk ishin shitur pjesa më e madhe e këtyre njësive dhe ndërtuesi ngarkohej me detyrime për to (fatura uji e energjie, taksa prone e taksa të tjera vendore) u bë kalimi i pronësisë në favorin tonë, pas zgjidhjes përfundimtare të marrëdhënies me Ndërtuesin me marrëveshjen e datës 25.01.2012. Pas kësaj kontrate, forma që u gjet më e përshtatshme për kalimin e pronësisë ishte kontrata e shitjes me çmim reference, sepse ishin paguar të gjitha detyrimet tatimore për këto njësi, të cilat ishin përballuar nga investitorët dhe, në thelb, ne si investitorë kishim paguar për këto pasuri. Në marrëveshjen e datës 23.01.2012 me "2T" shpk është parashikuar edhe pagesa e shumës prej 41 euro në favor të {...}t, si e ardhur nga shitja e njësive takuese. Shuma 30.000 euro i është paguar {...}t nga "2T" shpk dhe provohet nga dy mandatpagesat e paraqitura nga ne (paguar në vitin 2013). Vlera e mbetur prej 11.000 euro nuk ishte paguar deri në 06.09.2019, kur u dorëzua deklarimi në ILDKPKI, por është përmbushur nga "2T" shpk në muajin shtator në llogarinë e {...}t në bankën ISP Bank. (Bashkëlidhur mandatpagesa). Përsa më sipër, provohet qartësisht origjina e shumës 30.000 euro dhe provohet gjithashtu se këto të ardhura janë tërësisht të ligjshme dhe të justifikuar. (Nisur nga fakti që situata e këtij investimi është ndoshta më e komplikuar se*

investimet e tjera, po bashkëlidh të plotë kontratën e investimit dhe të gjitha marrëveshjet për këtë objekt, si dhe mandatpagesën e muajit shtator ku provohet edhe pagesa e fundit e bërë nga “2T” shpk që mbyll marrëdhënien tonë me këtë subjekt).

21. Patjetër që gjithë vendimet e asamblesë së ortakëve janë të regjistruara në librin e vendimeve të asamblesë të shoqërisë “UAECC” shpk dhe, kur shoqëria ka kaluar me statusin e Biznesit të Madh, vendimet e asamblesë për miratimin e bilancit vjetor janë depozituar rregullisht edhe në DRT Tiranë. (Bashkënlidhur kopje e regjistrimit të vendimeve të asamblesë së ortakëve)

22. Pretendimi se shoqëria “UAECC” shpk për të dokumentuar fitimin e ortakut {...}, ka prodhuar 3 dokumente me përmbajtje të ndryshme nga njëri-tjetri, nuk është plotësisht i saktë. Në vërtetimin e datës 19.04.2019 dhe në vërtetimin e datës 18.10.2019 (kur është kërkuar korrigjimi i një gabimi material) shifrat e fitimit të ortakut përputhen me njëri-tjetrin dhe në të dyja rastet të ardhurat e përfituara nga ortaku në periudhën 2000-2010 janë në vlerën 37.442.000 lekë. Këto shifra përputhen me vlerat e deklaruara në shkresat e zyrave të tatimeve. I vetmi ndryshim qëndron në vërtetimin e “UAECC” shpk të datës 04.09.2019, vërtetim që përmban një gabim material, që është konstatuar nga vetë shoqëria “UAECC” shpk, e cila ka kërkuar më pas korrigjimin e gabimit. Siç është sqaruar në kërkesën për korrigjimin e një gabimi material, drejtuar ILDKPKI-së nga {...} dhe administruar nga ILDKPKI në datën 28.10.2019, në file-in ku regjistroheshin fitimet e shoqërisë, është bërë një gabim me regjistrimin e fitimit të shoqërisë. Deri në vitin 2007 nuk paguhej tatim mbi fitimin, por tatim mbi xhiron. Kjo bënte që fitimi i shoqërisë bruto dhe neto të ishte i njëjtë dhe ishte ai që shpërndahej si dividend. Duke filluar nga 2008 e në vazhdim, shoqëritë tregtare deklarorin bilanc vjetor dhe paguanin tatim për fitimin e deklaruar të shoqërisë. Si rrjedhojë e kësaj, shuma që shpërndahej si dividend ishte fitimi i shoqërisë pas zbritjes së tatim fitimit, ose fitimi neto. Në file që regjistrohej çdo vit fitimi i shoqërisë, nga financieri ishte regjistruar si fitim i shoqërisë fitimi neto dhe jo ai bruto. Mqs ishte një praktikë e re, ortaku, mbështetur në këtë regjistrim në file-in përkatës, hartonte vendimet e asamblesë dhe shpërndante dividendin. Duke menduar se në file ishte regjistruar fitimi bruto, vendimet e asamblesë, duke nisur që nga viti 2008, janë hartuar duke i zbritur sërish fitimit neto 10% të vlerës së tij si tatim fitimi. Pra, për vitet 2008, 2009 dhe 2010 ka një gabim të tillë në vendimet e asamblesë së ortakëve (ortak i vetëm), ku fitimit bruto i është zbritur në mënyrë të dyfishtë tatim fitimi. Kjo ka sjellë që ndërmjet gjendjes faktike dhe asaj që rezulton nga vendimet e asamblesë për këto vite, të ketë një diferencë prej 879 200 lekë në total, e cila shtrihet në 3 vite. Vërtetimi i “UAECC” shpk i datës 04.09.2019, i hartuar mbi bazën e vendimeve të asamblesë dhe i shoqëruar nga këto vendime asambleje, ka vlerën 36.562.800 lekë si përfitim i {...}t për periudhën 2000-2010, vlerë e cila ndryshon nga vërtetimet e tjera. Kjo vlerë është kërkuar të korrigjohet, si gabim material, i cili është konstatuar nga vetë shoqëria.

Lidhur me tërheqjen e fitimit, është sqaruar hollësisht në pikën 14.

23. Së pari, unë jam tërhequr nga kandidimi për anëtar të Gjykatës Kushtetuese dhe mangësitë që mund të ketë ajo deklaratë nuk përbëjnë provë kundër meje, sepse heqja dorë nga kandidimi lë pa vlerë juridike të gjitha procedurat e zhvilluara deri në momentin e heqjes dorë, e cila ndërpret këto procedura. Lidhur me investimin në objektin në rrugën “Reshit Petrela” (sot Asim Vokshi), nga ne është konsideruar investim që në momentin që kemi vendosur të blejmë truallin, i cili është blerë me qëllimin për të ndërtuar mbi të. Për ne trualli dhe ndërtimi janë pjesë e të njëjtit investim. Në fakt, këto pasuri të paluajtshme kryesisht rrjedhin si pasojë e të qenit pronar trualli, por duke qenë se pronarët e truallit

kanë qenë edhe investitorë të objektit, ky është konsideruar nga ne si një investim unik. Besoj se kështu do ta konsideronte kushdo. ILDKPKI në deklarinë në prill 2019 më sugjeroi se duhet t'i kisha ndarë në dy deklarime të veçanta të ardhurat si pronar trualli dhe të ardhurat si investitor nisur nga fakti se pjesa takuese në të dy rastet është e ndryshme, gjë që e bëra në deklarinë e muajit shtator.

24. Lidhur me përfitimin e vlerës 110.000 USD nga "EDICOM" shpk, kemi dorëzuar një kontratë (investimi) të gushtit 1998 ndërmjet "EDICOM" shpk, "Mix Tecnic" shpk, si përfaqësues i Ilir Manushit dhe {...}, për investimin në një objekt në rrugën "Ferit Xhajko". Kështu filloi ky investim i përbashkët. {...} që në fillim investoi vlerën e projektit 39.000 USD, duke mos e tërhequr atë, por duke e përfshirë si investim në shërbime. Kostaqi dhe Ilir Manushi duhet të investonim 1/2 e objektit dhe sipas kontratës duhet të investonim 300.000 USD. Asnjëri prej tyre nuk kishte mundësi të investonte këtë vlerë, ndaj ranë dakord verbalisht me firmën e ndërtimit "EDICOM" shpk që të investonim sa të mundnim, si dhe të gjenin blerës për të mbuluar sa më shumë pjesën e të investimit, dhe se rakordimet do të bëheshin në fund.

Edhe në këtë objekt shitjet janë bërë gjatë kohës që ndërtohej objekti dhe pjesa më e madhe e pagesave ishin bërë deri në vitin 2003. {...} nga ky investim nuk mori asnjëherë asnjë përfitim, madje as vlerën e projektit, sepse objekti nuk u regjistrua në ZRPP (ishte ndërtuar një kat më pak parkime se sa leja e ndërtimit) dhe të mbyllej si marrëdhënia me blerësit, ashtu edhe ajo ndërmjet investitorëve. Ilir Manushi ndërkohë përfitoi një apartament 3+1, garazhe, si dhe vlera të konsiderueshme monetare. Në fillim të marsit 2015 {...} mori dëgjimin rastësisht se për këtë godinë, ku ai ishte investitor, kishin filluar procedurat e legalizimit dhe në aplikimin për legalizim ishte ndryshuar lista e investitorëve, duke u përfshirë në të blerës të njëjtit të ndryshme në objekt dhe duke u hequr emri i {...}t nga lista e investitorëve. Për këtë arsye, në datë 05.03.2015 {...} ka bërë kallzim penal në Prokurorinë e Tiranës ndaj "EDICOM" shpk dhe Ilir Manushit, pasi i kishin hequr emrin si investitor i objektit. Pas diskutimesh e bisedimesh të gjata, më në fund "EDICOM" shpk dhe Ilir Manushi ranë dakord që {...}t t'i paguhej nga "EDICOM" shpk shuma 110.000 USD si përfitim për investimin e bërë, pagesë që është bërë në datën 06.11.2015 në Union Bank nga "EDICOM" shpk. Pra, pas më shumë se 17 vjet ne mezi arritëm të marrim përfitime nga investimi i bërë në këtë objekt. Si rrjedhim, {...} nuk i ka dhënë asnjëherë borxh shoqërisë "EDICOM" shpk, por me shumë përpjekje dhe pas më shumë se 17 vitesh ka arritur të përfitojë nga investimi i bërë bashkë me këtë shoqëri dhe Ilir Manushin. Ky është burimi i shumës 110.000 USD, e cila nuk ka shërbyer si burim për blerjen e asnjë pasurie.

**Lidhur me disa konstatime që bën ILDKPKI gjatë raportit të saj, por që nuk janë përfshirë në përfundime, dua të theksoj sa më poshtë:**

- Është pretenduar se nga Dhoma e Avokatisë nuk është përfituar shuma 222.000 lekë, por 120.000 lekë. Në fakt është i saktë deklarimi im. Bashkëlidhur vërtetimi i Dhomës së Avokatisë. Të dyja pagesat janë bërë në llogari bankare.

- Është pretenduar se nga Fakulteti i Ekonomisë kam përfituar vetëm vlerën 164.700 lekë dhe jo vlerën 240.930 të deklaruar nga unë. Në fakt është i saktë deklarimi im për vlerën 240.930 lekë, diferenca prej 76.230 lekë është një shumë që më është paguar në vitin 2012 në NBG Bank. Bashkëlidhur vërtetimi i Fakultetit të Ekonomisë.

- Lidhur me pagesat e bëra nga Universiteti Kristal dhe Universiteti Vitrinat, unë në deklarinë kam evidentuar faktin se vetëm një pagesë prej 218.000 lekë kam me bankë, ndërsa shumat e tjera janë paguar në dorë, por unë nuk mund të marr vërtetim, sepse



këto universitete janë mbyllur me VKMnë 2014. Për të gjitha shumat e përfituara nga mësimdhënia më është mbajtur tatimi në burim.

- Të ardhurat nga QPZ në vitin 2012 janë në vlerën 23.500 lekë dhe janë deklaruar në deklaratën e 2012. Këtë të ardhur e kam nxjerrë pikërisht nga ai deklaram, sepse e kisha harruar.

- Lidhur me të ardhurat e përfituara nga AKEP, janë në shumën 42.500 lekë dhe jo 25.500 sa konstaton ILDKPKI. Në vërtetimin e AKEP, lëshuar në 10.04.2019 janë shumat e përfituara deri në datën e lëshimit të vërtetimit, diferenca provohet nga statement i llogarisë time bankare në BKT për vitin 2019, të cilin e kam dorëzuar në ILDKPKI.

- Shumat e paguara për Kerol Kaskaviqin në periudhën 2015 për UËC USA, nuk kanë lidhje me deklarin e Kerol Kaskaviqit. Siç ka evidentuar vetë ILDKPKI në faqen 67, Kerol Kaskaviqi aktualisht është studente e vitit të fundit (të katërt) në "University of Florida" dhe periudha e studimit në këtë universitet për të cilën ajo ka deklaruar përfitim e bursës, siç konstaton ILDKPKI është gusht 2016-gusht 2020. Keroli ka deklaruar dhe e ka provuar me dokumentin zyrtar I-20 të lëshuar nga shteti amerikan, se ajo kostot vjetore të studimit dhe jetesës i ka 47.285 USD, të cilat po nga i njëjti dokument provohet se i përfiton tërësisht si bursë. Shumat e transferuara nga unë si pagesë për shkollën e Kerol Kaskaviqit në 2015 janë pagesa që janë bërë për ciklin parauniversitar (gjimnaz) të studimeve të saj, IB në UËC USA (gusht 2014-maj 2016), në të cilin ne paguanim për Kerolin 18.000 USD për shkollimin dhe 400 USD për sigurimin shëndetësor. Keroli nuk kishte se si t'i deklaronte këto shuma, sepse po bënte deklarin për studimet aktuale në universitet dhe bursën që përfitonte dhe nuk i kërkohej në asnjë rubrikë deklarimi i shpenzimeve. Për më tepër, detyrimi prej 18.400 USD nuk ka qenë asnjëherë detyrim i saj, por i ne prindërve, sipas kontratës që kemi nënshkruar me kolegjin. Për vlerën 4.000 USD që unë i kam dërguar Kerolit në 15.04.2016, sërish është para nisjes së studimeve universitare dhe është bërë për pagesat që duhet të bënte për regjistrimin në universitet dhe një parapagim prej 1.000 USD për shkollën, shumë e cila i është kthyer më pas nga pagesa e bursës. Mbetjen e ka shfrytëzuar për shpenzime personale. Këtë shpenzim nuk kam pasur detyrim ta deklaroj.

- Edhe për Sindi Kaskaviqin janë evidentuar (faqe 69) nga ILDKPKI se nga dokumenti zyrtar i shtetit amerikan I-20 del se Sindi Kaskaviqi është studente në Bryn Maër College dhe periudha e studimit është 28.08.2017-15.05.2021. Pra, Sindi i ka filluar studimet universitare në SHBA në gusht 2017, ndërkohë që ILDKPKI konstaton pagesa në favor të UËC Changchu China në 2015 dhe 2016 në total 2.972 USD, duke i quajtur si pasaktësi deklarimi. Por siç shihet qartë nga vetë konstatimet e ILDKPKI-së, shumat nuk janë paguar për Bryn Maër College, USA ku Sindi aktualisht studion, por për studimet parauniversitare (gjimnaz) të Sindit në IB, UËC Changchu China, në periudhën shtator 2015-qershor 2017. Jo vetëm ndyshon periudha, por ndryshon edhe shteti ku janë kryer pagesat. Pagesat janë bërë për sigurimet shëndetësore, që për Sindin kanë qenë 750 USD/vit, dhe pjesa tjetër për shpenzime personale dhe pagesën e provimeve të SAT që ajo ka dhënë në Kinë.

- Pra, ILDKPKI ka evidentuar shpenzime të miat për vajzat, ndërkohë që unë nuk kam pasur detyrim për deklarin të shpenzimeve, përveç detyrimeve ekzistente në momentin e deklarinimit. Gjithashtu, mendoj se ILDKPKI është e paqartë për situatën e studimeve të vajzave, sepse ka ngatërruar me njëri-tjetrin studimet universitare me ato parauniversitare (gjimnaz) që kanë bërë vajzat e mia, duke konstatuar problematika të cilat nuk ekzistojnë, por janë rrjedhim i perceptimit të gabuar nga ana e tyre. Për sqarim:

- Vajza Kerol Kaskaviqi në gusht 2014-maj 2016 ka ndjekur studimet parauniversitare (gjimnaz) në UËC, USA. Nga gushti 2016 e aktualisht ndjek studimet universitare bachelor në University of Florida, USA. I-20 përkon me këto studime aktuale, për të cilat ajo merr bursë të plotë.

- Vajza Sindi Kaskaviqi në shtator 2015-maj 2017 ka ndjekur studimet parauniversitare (gjimnaz) në UËC, Changchu China. Nga gushti 2017 e aktualisht ndjek studimet universitare në Bryn Maër College, USA. I-20 përkon me këto studime aktuale, për të cilat ajo merr bursë të pjesshme dhe ne kemi detyrimin të paguajmë 3.846 USD/vit, detyrim të cilin unë e kam deklaruar (totali i mbetur 7.692 USD).

- Është e kuptueshme që unë i jap vajzave para për shpenzime personale, siç do t'i jepja edhe po të ishin në Shqipëri dhe siç bën çdo prind.

### Konkluzion

**Deklarimet e bëra nga unë dhe personat e lidhur me mua ({...}, Kerol Kaskaviqi dhe Sindi Kaskaviqi), mendoj se janë të plota dhe të sakta.**

Në këtë proces verifikimi, faktet duhet të analizohen në përputhje me rrethanat dhe momentin e krijimit të këtyre të ardhurave, si të ardhura që janë krijuar nga subjekti deklarues dhe personi i lidhur përpara fillimit të detyrës, pra kur unë si candidate ende nuk i përkas asnjë hallke të sistemit të drejtësisë. Pra, unë jam subjekt vlerësimi fillestar dhe jo subjekt i rivlerësimit kalimtar. Në të njëjtin kontekst, vë në dukje qëndrimin se pasuritë e vëna nga subjekti, aq më tepër prej personave të lidhur, para fillimit të detyrës, mund të plotësojnë e kënaqin nivelin diskrecionar për "justifikimin bindshëm të ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurive" **edhe për një nivel më të ulët të provave se sa do të duhej për të kënaqur këtë nivel, për pasuritë e vëna gjatë periudhës së rivlerësimit.** Kjo mënyrë e të arsyetuarit lidhet natyrshëm me logjikën se këto pasuri presupozohen që janë vënë së paku duke mos përfitur e abuzuar me detyrën, për pasojë duke shmangur për këto pasuri mosbesimin e publikut drejt ligjshmërisë së tyre.

Unë, si subjekt deklarues, në rastin konkret për të gjitha pasuritë kam provuar burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive dhe për më tepër, provueshmëria e deklaramit dhe e pagimit të detyrimeve tatimore për të ardhurat të cilat kanë shërbyer si burim krijimi i këtyre pasurive është e bazuar në dokumentacionin respektiv dhe i bën këto burime tërësisht të vërtetuara dhe të besueshme.

Të gjitha përfundimet e ILDKPKI-së lidhen kryesisht me investimet e bëra nga bashkëshorti im, person i lidhur me mua si subjekt vlerësimi, investime që janë bërë në periudhën 1998-2005, periudhë tepër e largët nga momenti i deklaramit (1.5-2 dekada më parë). Pikërisht koha e largët në të cilën janë krijuar këto të ardhura nga investimet, e bën të vështirë edhe vetë ruajtjen e dokumentacionit që mund të sillte edhe më tepër informacion në këtë drejtim, edhe për shkak të një logjike normale ligjore që duket se nuk merr përsipër të ruajë apo arkivojë dokumente të kësaj natyre për një periudhë kaq të gjatë kohe, madje as nga vetë institucionet shtetërore (dokumentet ruhen si rregull 5-10 vjet, me përjashtimet që parashikon ligji për afate më të gjata). Në këtë kontekst, mendoj se duhet të analizohet edhe rrethanat, të cilat lidhen me momentin e krijimit të këtyre të ardhurave.

Në vitet kur bashkëshorti im ka kryer investimet e tij, ai ishte një person, i cili nuk kryente asnjë funksion publik. Edhe unë gjithashtu. Për shkak të kësaj situatë, ai nuk kishte ndonjë detyrim ligjor të tregohej i kujdesshëm deri në nivelin e ruajtjes së dokumentacionit që provon ligjshmërinë e të ardhurave të tij në atë kohë përveç se, për sa ai ka çmuar të nevojshme sipas kujdesit të një qytetari normal e të paangazhuar në ndonjë detyrë publike dhe nevojës për shpjegime në lidhje me këto të ardhura.

Fakti që për shkak të një realiteti historik të zhvillimit të shoqërisë shqiptare në vitet e tranzicionit, shqetësimi parësor i qytetarëve të ndershëm e nevojtarë të vendit tonë në ato vite, nuk ishte ruajtja e kurimi i anës dokumentare të çdo lloj aktiviteti që u prodhonte të ardhura, sesa nevoja reale e nxjerrjes dhe realizimit të këtyre të ardhurave në funksion të qëllimit për të siguruar jetesën dhe përmirësimin e kushteve ekonomike të tyre e të familjarëve të tyre, në situatën e një krize të mirëfilltë ekonomike, besimi e sigurie që kishte mbërthyer shtetin shqiptar pas vitit 1997.

Nëse ka ndonjë mangësi në dokumentacion, këto mangësi duhet të vlerësohen pikërisht në këtë kontekst të realitetit shqiptar dhe të pozitës së qytetarëve të thjeshtë, pa asnjë funksion publik, që ne kishim në periudhën 1998-2005.

Gjithashtu, fakti që nga verifikimet që bëhen në zyrat e tatimeve qendrore apo rajonale, provohet se ne kemi qenë subjekte tepër korrekte në marrëdhënie me shtetin dhe detyrimet ligjore ndaj tij, duke parashikuar që në fundin e viteve 90 pagesën e tatimit në burim për kontrata të lidhura me subjekte të ndryshme, ndërkohë që në Shqipëri subjektet tregtare as nuk regjistroheshin në zyrat e tatimeve, kur informaliteti ishte normalitet në realitetin shqiptar, tregon për korrektësi konstante nga ana jonë si individë.

**Mendoj, se gjithë dokumentat e dorëzuara nga ne provojnë pa asnjë mëdyshje burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive dhe të ardhurave tona, qëllim për të cilin bëhet ky vlerësim i pasurive.**

5. Marrë shkas nga shpjegimet e kandidatës dhe dokumenteve mbështetës të paraqitur prej saj, me shkresën nr. 4171/16 prot., datë 12.11.2019, ILDKPKI-së iu kërkua informacion shtesë, duke i përcjellë në këtë rast edhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga kandidata zn.Kastro.

6. Me shkresën nr. 3832/15 prot., datë 02.12.2019 ILDKPKI-ja, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, ka përcjellë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor Raportin Shtesë nr. 109/25 datë 2.12.2019, sipas të cilit për kandidatin znj. {...} rezultonte:

*“- Deklarimet e bëra nga bashkëshorti, {...}, në deklaratën e interesave private të kandidatit për anëtar të Gjykatës së Lartë, në relacionin shpjegues shtesë dhe prapësimet e dhëna, janë dhe mbeten shpjegime në nivel deklarativ dhe të paprovuara ligjërisht, pasi mungon dokumentacion i justifikues ligjor për të provuar vërtetësinë e deklarimeve të kryera prej tij, si dhe për të provuar dhe vërtetuar veprimet (financiare ose jo) mes tij dhe shoqërive tregtare “Alb-Building”, “Mix Teknik”, “2T” dhe “Edicion”, me të cilat ka bashkëpunuar në ndërtimin e objekteve në rrugën “Reshit Petrela”, “Ferit Xhajko”, Tiranë, Rrashbull Durrës dhe Golem-Kavajë.*

*- Mungon dokumentacioni i justifikues ligjor si: pasyrat financiare dhe librat\regjistrat e shoqërive të ndërtimit ku të jenë të pasqyruara në shifra dhe në mënyrë analitike marrëdhëniet (financiare ose jo) të {...}t me firmat ndërtuese, vlerat e investimeve, kontributeve në para apo në natyrë, detyrimet e firmave ndërtuese ndaj tij apo edhe anasjelltas, kthimet nga investimet. Gjithashtu mungojnë preventive dhe situacione për punimet e kryera në objektet e ndërtuara, mandat-pagesa dhe mandat arkëtime mbi pagesat për investimet e kryera apo për shumat e përfituara nga investimet, kontrata porosie apo kontrata sipërmarrje për shitjen e apartamenteve për të cilat {...} deklaroi se ka përfutuar të ardhura, të cilat më pas i ka riinvestuar në ndërtim, mandat-pagesa për pjesën takuese të kësteve të kredisë (450.000USD) për të cilën deklaroi se e kanë përdorur investitorët për ndërtimin e objektit, si dhe dokumentacioni ligjor i vijueshmërisë së kallëzimit penal ndaj shoqërisë “EDICOM” shpk.*

*- Është e paqartë se përse mandat-arkëtimet për shitjen e pasurive të paluajtshme në rrugën “Reshit Petrela”, Tiranë janë arkëtuar nga shoqëria “Mix Tecnic”, ndërkohë që kontratat e shit-blerjeve përfundimtare janë lidhur nga investitorët në mënyrë individuale dhe jo nga shoqëria “Mix Tecnic”.*

*- Mbeten të paqarta dhe të paprovuara me dokumentacion i justifikues ligjor vlerat dhe periudhat e investimeve (pjesa takuese) në ndërtimet e objekteve në rrugën “Reshit*

*Petrela”, “Ferit Xhajko”, Tiranë, Rrashbull-Durrës, Golem-Kavajë, dhe rrjedhimisht për këtë arsye mbeten të paqarta dhe të pajustificuara me dokumentacion ligjor edhe burimet financiare që kanë shërbyer për ndërtimin e tyre.*

*- Nuk ka të dhëna nëse në pasurinë e paluajtshme në pronësi/bashkëpronësi të bashkëshortit {...}, janë kryer investime dhe nëse këto pasuri shfrytëzohen ose jo për ndonjë formë aktiviteti ose banimi (përveç atyre të deklaruara me qira dhe në përdorim).*

*- Lidhur me objektin 4 kate në Rashbull-Durrës, sipas relacionit shpjegues dhe prapësimeve, në këtë objekt janë shitur 3 apartamente dhe janë përfituar gjithësej nga bashkëpronarët 37.288 euro dhe 4.300.000 lekë, të cilat nuk janë arkëtuar, por kanë shkuar në investimin e objektit, por nga dokumentacioni i administruar rezulton se shitjet e këtyre 3 (tre) apartamenteve janë kryer mbasi pasuritë e paluajtshme ishin regjistruar e rrjedhimisht, mbasi ishte përfunduar investimi dhe logjikisht të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamenteve nuk mund të jenë përdorur si burim financiar për ndërtimin e këtij objekti. Nuk ka asnjë dokumentacion justifikues ligjor që të provojë se shumat 37.288 euro dhe 4.300.000 lekë janë arkëtuar përpara se të përfundojë ndërtimi i objektit dhe më pas të jenë investuar në ndërtim.*

*- Rezulton se bashkëshorti i kandidatit, nuk ka deklaruar të ardhura të përfituara nga shitja e 3 apartamenteve në Komunën Rrashbull, Durrës, ku referuar kontratave të shitjes, për pjesën takuese prej 1/6, ka përfituar 20.483 euro dhe 717.000 lekë.*

*- Rezulton se çmimi i shitjes së apartamentit me sip. 93 m<sup>2</sup> dhe verandë me sip 26.84 m<sup>2</sup>, në Komunën Rashbull, Durrës, në kontratën e shitjes me kusht nr. 5803 rep, nr. 615 kol, dt. 30.12.2005, dorëzuar në ASHK, është 122.900 euro. Të dyja këto kontrata rezulton se janë nënshkruar edhe nga bashkëshorti i kandidatit, {...}.*

*- Konstatohet se bashkëshorti i kandidatit ka deklaruar lokal shërbimi me sip. 267.28 m<sup>2</sup> (në proces të regjistrimit të legalizimit të shtesës), të regjistruara 164.16 m<sup>2</sup>, në Rashbull, Durrës, ndërsa ASHK Durrës e konfirmon me sip. 292 m<sup>2</sup>. Rezulton se nuk ka deklaruar faktin se për këtë lokal ai dhe bashkëpronarët e tjerë, janë pajisur me Leje Legalizimi nr. 0085239, dt. 2.5.2016. Gjithashtu, mbetet e paqartë vlera e investuar dhe burimi financiar që ka shërbyer për ndërtimin e shtesës si dhe nuk ka të dhëna nëse janë kryer investime e nëse ky lokal shfrytëzohet ose jo për ndonjë formë aktiviteti.*

*- Në dt. 29.7.2010, shoqëria “Hera” shpk ka kredituar në llogari shumë 3.000 euro me përshkrimin “pag projekti arkitekturë...”. Për këto të ardhura kandidati nuk ka dhënë sqarime dhe nuk ka paraqitur dokumente justifikuese ligjore.*

*- Gjatë periudhës 2013 dhe 2014, bashkëshorti i kandidatit ka përfituar të ardhura nga qiraja me shoqërinë “Invest Real Estate” shpk, në shumë 3.827 euro, të cilat nuk i ka deklaruar si të ardhura në asnjë nga deklaratat e interesave private të dorëzuara në ILDKPKI.*

*- Gjatë periudhës 2006 dhe 2007, bashkëshorti i kandidatit ka përftuar të ardhura nga qiraja me shoqërinë “The point” shpk, në shumë 16.200 euro, të cilat nuk i ka deklaruar si të ardhura në asnjë nga deklaratat e interesave private të dorëzuara në ILDKPKI.*

*- Është e paqartë se përse bashkëshorti i kandidatit, në datë 22.10.2008, ka transferuar nga llogaria e tij në ISP Bank, në llogarinë e {...}, shumë 10.000 euro, me përshkrimin “pagesë për shërbime juridike”.*

*- Në deklaratën e interesave private të kandidatit për anëtar të Gjykatës Kushtetuese, ka deklaruar; “Të ardhura nga investimi i bërë në Golem, Kavajë. Marrë në 2013 me 2 mandate arkëtimi (20.000 euro + 10.000 euro). Përdorur për të blerë tokën në Mullet,*

Tiranë. Shuma 30.000 euro”. Në deklaratën e interesave private të kandidatit për anëtar të Gjykatës së Lartë ka deklaruar “Të ardhura nga investimi i bërë në Golem, Kavajë. Sipas vlerave të shitjes për dy kontrata duhet të arkëtojë 71.000 euro, por për shkak se i detyroheshka ndërtuesit vlera reduktohej në 41.000 euro, nga të cilat kam marrë realisht vetëm 30.000 euro.”

- Lidhur me shumën 30.000 euro, që ka shërbyer për blerjen e tokës në Mullet, deklaruar me burim nga arkëtimi i të ardhurave nga investimi në Golem, Kavajë, nisur nga fakti se rezultoi që nga ndërtimi i objektit në Golem Kavajë, {...} ka përfituar me kontratë shitje vetëm 3 apartamente dhe 3 garazhe, nga të cilat 2 apartamente dhe 3 garazhe i ka ende në pronësi dhe vetëm një apartament rezultoi i shitur, por dhe ky rezultoi i shitur në vitin 2015 me cmimin 10.970, rrjedhimisht edhe në këtë rast burimi financiar i shumës 30.000 euro mbetet i paqartë.

- Rezultoi se në deklaratën e interesave private për kandidat për anëtar në Gjykatën Kushtetuese, kandidati nuk ka deklaruar të ardhura nga shoqëria “Marko” shpk, në shumën 47.000 USD. Gjithashtu, konstatohet mospërputhje me shumën e deklaruar nga kandidati në deklaratën e interesave private për kandidat për anëtar në Gjykatën e Lartë (40.000 USD), me shumën e përcaktuara në kontratat përkatëse të lidhura prej tij me shoqërinë “Marko” shpk (47.200 USD), të cilat e kalojnë vlerën e përafërt deklaruar nga kandidati “rreth 40.000 USD”.

- Konstatohet paqartësi lidhur me përshkrimin e mandat-arkëtimin dt. 13.10.1998, të kryer nga shoqëria “Marko” shpk, për pagesën e tatimit në burim për llogarit të {...}t, pasi përshkrimi në mandat-pagesë i referohet vitit 1995, ndërkohë që deri në dt. 31.12.1995, {...} ka deklaruar të ardhura dhe ka qënë i punësuar në Bashkinë e Tiranës, ndërsa të ardhurat nga shoqëria “Marko” shpk referuar kontratave dhe deklarimeve, rezultojnë se janë krijuar në periudhën 1996-1998. Pra mbetet e paqartë nëse {...} ka përfituar të ardhura të tjera nga shoqëria “Marko” shpk, përveç atyre të deklaruara gjatë kohës që ka qënë i punësuar në Drejtorinë e Urbanistikës, në Bashkinë e Tiranës, dhe nëse për të gjitha këto të ardhura janë shlyer ose jo detyrimet tatimore (rezultoi i paguar tatim në burim vetëm shuma 360.000 lekë).

- Lidhur me deklarin e bashkëshortit të kandidatit për të ardhurat e përfituara si pronar truall nga objekti shumëkatësh në rrugën “Reshit Petrela”, Tiranë, konstatohet se ky deklarim nuk rezultoi të jetë deklaruar më parë në deklaratën e interesave private të kandidatit për anëtar të Gjykatës Kushtetuese. Referuar dokumentacionit të administruar nga ASHK Tirana Veri, rezultoi nga shitja e pasurive të paluajtshme të përfituara nga investimi në ndërtimin e objektit 13- kate në rrugën “Asim Vokshi”, Tiranë, bashkëshorti i kandidatit, për pjesën e vetë takuese, ka përfituar të ardhura në një shumë totale prej 251.098 euro dhe 197.667 USD.

- Për sa i përket shumës 110.000 USD të kredituar nga shoqëria “Edicom” shpk, në llogarinë e bashkëshortit të kandidatit, konstatohet se përveç përshkrimit të transaksionit bankar “kthim detyrimi sipas rakordimit”, nuk ka asnjë të dhënë tjetër apo dokumentacion justifikues ligjor që të qartësojë dhe të provojë arsyet e këtij kreditimi.

6.1 Sipas Raportit Shtesë të ILDKPKI-së, “Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 9049, datë. 10.04.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nënpunësve publikë”, i ndryshuar, ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve

publike” i ndryshuar, si dhe ligjin nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konstatohet se për kandidaten {...}:

- a) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të justifikuar pasurinë;
- c) ka mosdeklarim të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- e) kandidati nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

7. Më datë 4.12.2019, pasi dëgjoji relatorin e çështjes dhe u njoh me materialet në lidhje me verifikimin e kriterit të pasurisë së kandidates znj.{...}, duke vlerësuar se nga kontrolli i pasurisë dhe interesave privatë ishin evidentuar fakte të rëndësishme për procedurën e verifikimit, të tilla që në potencë kishin aftësinë për të pasjell/prodhuar një pasojë/efekt të caktuar në këtë procedure, konkretisht skualifikimin dhe përjashimin e kandidates nga procedurat e emërimit ku ajo ka kandiduar, referuar për këtë përcaktimeve të nenit 32 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe atyre të Seksionit A, Kreu IX, të Vendimit nr. 75 datë 23.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor vendosi që: “Kandidatja znj.{...} të ftohet për të paraqitur shpjegime lidhur me gjetjen e procedurës së verifikimit, si edhe të çdo dokumentacioni mbështetës të nevojshëm sipas vlerësimit të saj”.

8. Më datë 13.12.2019, pasi u njoh rregullisht me gjetjet e procedurës së verifikimit në lidhje me kriterin e pasurisë përmes njoftimit të Raportit Shtesë të ILDKPKI-së, si dhe pas shtyrjes së afatit mbi kërkesën e saj, kandidatja nj.{...} depozitoi pretendimet e veta për gjetjet e procedurës së verifikimit, duke i shoqëruar me disa dokumente sipas vlerësimit të saj.

8.1 Në pretendimet e saj, kandidatja znj.{...} ka parashtruar si më poshtë:

*“Preambul:*

*Në këtë proces verifikimi, faktet duhet të analizohen në përputhje me rrethanat dhe momentin e krijimit të këtyre të ardhurave, si të ardhura që janë krijuar nga subjekti deklarues dhe personi i lidhur përpara fillimit të detyrës, pra kur unë si candidate ende nuk i përkas anjë hallke të sistemit të drejtësisë. Pra, unë jam subjekt vlerësimi fillestar dhe jo subjekt i rivlerësimit kalimtar. Në të njëjtin kontekst, vë në dukje qëndrimin se pasuritë e vëna nga subjekti, aq më tepër prej personave të lidhur, para fillimit të detyrës, mund të plotësojnë e kënaqin nivelin diskrecionar për “justifikimin bindshëm të ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurive” edhe për një nivel më të ulët të provave se sa do të duhej për të kënaqur këtë nivel, për pasuritë e vëna gjatë periudhës së rivlerësimit. Kjo mënyrë e të arsyetuarit lidhet natyrshëm me logjikën se këto pasuri presupozohen që janë vënë së paku duke mos përfutuar e abuzuar me detyrën, për pasojë duke shmangur për këto pasuri mosbesimin e publikut drejt ligjshmërisë së tyre.*

*Unë, si subjekt deklarurues, në rastin konkret për të gjitha pasuritë kam provuar burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive dhe për më tepër, provueshmëria e deklarimit dhe e pagimit të detyrimeve tatimore për të ardhurat të cilat kanë shërbyer si burim krijimi i këtyre pasurive është e bazuar në dokumentacionin respektiv dhe i bën këto burime tërësisht të vërtetuara dhe të besueshme.*

*Të gjitha përfundimet e ILDKPKI-së lidhen kryesisht me investimet e bëra nga bashkëshorti im, person i lidhur me mua si subjekt vlerësimi, investime që janë bërë në periudhën 1998-2005, periudhë tepër e largët nga momenti i deklarimit (1.5-2 dekada më parë). Pikërisht koha e largët në të cilën janë krijuar këto të ardhura nga investimet, e bën të vështirë edhe vetë ruajtjen e dokumentacionit që mund të sillte edhe më tepër informacion në këtë drejtim, edhe për shkak të një logjike normale ligjore që duket se nuk merr përsipër të ruajë apo arkivojë dokumente të kësaj natyre për një periudhë kaq të gjatë kohe, madje as nga vetë institucionet shtetërore (dokumentet ruhen si rregull 5-10 vjet, me përjashtimet që parashikon ligji për afate më të gjata). Në këtë kontekst, mendoj se duhet të analizohet edhe rrethanat, të cilat lidhen me momentin e krijimit të këtyre të ardhurave.*

*Në vitet kur bashkëshorti im ka kryer investimet e tij, ai ishte një person, i cili nuk kryente asnjë funksion publik. Edhe unë gjithashtu. Për shkak të kësaj situate, ai nuk kishte ndonjë detyrim ligjor të tregojë i kujdesshëm deri në nivelin e ruajtjes së dokumentacionit që provon ligjshmërinë e të ardhurave të tij në atë kohë përveç se, për sa ai ka çmuar të nevojshme sipas kujdesit të një qytetari normal e të paangazhuar në ndonjë detyrë publike dhe nevojës për shpjegime në lidhje me këto të ardhura.*

*Fakti që për shkak të një realiteti historik të zhvillimit të shoqërisë shqiptare në vitet e tranzicionit, shqetësimi parësor i qytetarëve të ndershëm e nevojtarë të vendit tonë në ato vite, nuk ishte ruajtja e kurimi i anës dokumentare të çdo lloj aktiviteti që u prodhonte të ardhura, sesa nevoja reale e nxjerrjes dhe realizimit të këtyre të ardhurave në funksion të qëllimit për të siguruar jetesën dhe përmirësimin e kushteve ekonomike të tyre e të familjarëve të tyre, në situatën e një krize të mirëfilltë ekonomike, besimi e sigurie që kishte mbërthyer shtetin shqiptar pas vitit 1997.*

*Nëse ka ndonjë mangësi në dokumentacion, këto mangësi duhet të vlerësohen pikërisht në këtë kontekst të realitetit shqiptar dhe të pozitës së qytetarëve të thjeshtë, pa asnjë funksion publik, që ne kishim në periudhën 1998-2005.*

*Gjithashtu, fakti që nga verifikimet që bëhen në zyrat e tatimeve qendrore apo rajonale, provohet se ne kemi qenë subjekte tepër korrekte në marrëdhënie me shtetin dhe detyrimet ligjore ndaj tij, duke parashikuar që në fundin e viteve 90 pagesën e tatimit në burim për kontrata të lidhura me subjekte të ndryshme, ndërkohë që në Shqipëri subjektet tregtare as nuk regjistroheshin në zyrat e tatimeve, kur informaliteti ishte normalitet në realitetin shqiptar, tregon për korrektësi konstante nga ana jonë si individë.*

*U njoha me raportin e ILDKPKI-së dhe më vjen keq që konstatoj se ato që unë mendoja se ishin thjesht gabime në perceptim apo keqkuptime, në të vërtetë tregojnë për një qëndrim të njëanshëm të ILDKPKI-së dhe paragjykim të saj, e cila kur paraqes kontrata më kërkon mandate dhe pasqyra financiare, ndërsa kur paraqes mandate më kërkon kontrata apo kërkon e bën pyetje se pse janë arkëtuar nga një subjekt dhe jo nga një tjetër. Në këtë rast mund të përdoret shprehja popullore “nuk di si t’ia jap ujin gomarit”, sepse çfarëdo dokumenti që unë dorëzoj, është lehtësisht e lexueshme që ILDKPKI nuk do të japë një raport pozitiv për mua. Madje, më kërkohet të jap llogari për gabimet në përmbushjen e një deklarimi pasurie të një procedure ku unë jam tërhequr, duke mos bërë fare vlerësimin e deklarimit të rregullt që kam bërë në këtë deklaratë. Më janë kërkuar dokumenta shtesë*

për të justifikuar gjetje të ILDKPKI-së në raportin e datës 28 tetor, por për dy të ardhurat që vijnë nga kontratat e qirasë, edhe pse dorëzohen kontratat e madje edhe provohet pagesa e tatimit në burim, nuk njihen sërish nga ILDKPKI. Mua që nuk jam subjekt i rivlerësimit kalimtar po më bëhet veting më i fortë se subjektet e rivlerësimit kalimtar. Kjo për faktin se KPK-të kanë pranuar edhe raste të harresave në deklarime, ndërsa mua ILDKPKI nuk mi toleron këto harresa dhe vazhdon t'i ketë gjetje edhe në këtë raport të dytë, pavarësisht provave shtesë të dorëzuara. Kam marrë dijeni se shumë subjekte të tjerë të vlerësimit fillestar janë thërritur nga ILDKPKI dhe u janë kërkuar shpjegime dhe ju janë pranuar dokumenta shtesë gjatë vlerësimit. Kjo nuk është bërë me mua. Nuk di në është ndjekur i njëjti standard edhe në vlerësimin e kandidatëve të tjerë? A i janë kërkuar edhe kandidatëve të tjerë librat e vendimeve të asamblesë për t'iu njohur fitimet e vërtetuara edhe nga tatimet? A i është kërkuar ndonjë nga kandidatëve të tjerë apo ndonjë subjekti rivlerësimi të sqarojë se për çfarë i përdor pasuritë që ka apo të justifikojë transfertat bankare me bashkëshortin? Është për të ardhur keq që shumë nga këto “gjetje” të ILDKPKI-së përsëriten, madje edhe më shumë se një here, që tregojnë se ato nuk janë më gjetje, por stisje. Kështu, gjetja 1, 2 dhe 4 e ILDKPKI-së në fakt janë e njëjta gjë: marrëdhëniet e {...}t me shoqëritë ndërtuese “Alb-Building”, “2T” dhe “Edicom, si dhe me shoqërinë “Mix Teknik” që në të gjitha investimet del si manaxhuese e investimit (përfaqësuese e investitorëve), si dhe marrëdhënia investitore në objektet e ndërtuara nga këto shoqëri ndërtimi. Po kështu gjetjet 6 dhe 7 janë po e njëjta gjë: shitja e tre apartamenteve në Rrashbull Durrës. Edhe gjetjet 14 dhe 15 janë po e njëjta gjë: investimi në Golem Kavajë dhe përfitimi i shumës 30.000 paguar nga “2T” si e ardhur nga ky investim. Po kështu, gjetjet 16 dhe 17 janë të njëjta: i referohen të ardhurave të arkëtuara nga shoqëria “Marko”. Doja të dija se cili është qëllimi që përsëriten kaq shumë këto “gjetje”. ILDKPKI ka detyrë parësore të bëjë një analizë financiare, e cila mungon tërësisht në raport. Madje, nuk është treguar absolutisht se sa janë të ardhurat në total për ne, të cilat provohen në mënyrë të pakontestueshme dhe pranohen edhe nga ILDKPKI. Ndoshta kjo nuk është bërë, sepse do të provonte pa asnjë mëdyshje mbulimin e të gjitha pasurive me të ardhurat e pranuar nga ILDKPKI.

#### **Gjetja 1 e ILDKPKI-së:**

- “Deklarimet e bëra nga bashkëshorti, {...}, në deklaratën e interesave private të kandidatit për anëtar të Gjykatës së Lartë, në relacionin shpjegues shtesë dhe prapësimet e dhëna, janë dhe mbeten shpjegime në nivel deklarativ dhe të paprovuara ligjërisht, pasi mungon dokumentacion i justifikues ligjor për të provuar vërtetësinë e deklarimeve të kryera prej tij, si dhe për të provuar dhe vërtetuar veprimet (financiare ose jo) mes tij dhe shoqërive tregtare ‘Alb-Building’, ‘Mix Teknik’, ‘2T’ dhe ‘Edicion’, me të cilat ka bashkëpunuar në ndërtimin e objekteve në rrugën ‘Reshit Petrela’, ‘Ferit Xhajko’, Tiranë, Rrashbull Durrës dhe Golem Kavajë”.

#### **Për të provuar marrëdhënien me shoqërinë ndërtuese “Alb-Building” dhe investimin në rrugën “Reshit Petrela” janë dorëzuar:**

- Kontrata e shitjes datë 07.12.2001, Rep.nr. 3231, Kol.nr. 536, ndërmjet familjes Boja dhe blerësve {...}, Ilir Manushi, Odhise Bresha, Pëllumb Beta e Artan Sako (kontrata me të cilën blihet toka trualli në rrugën “Reshit Petrela”);
- Marrëveshja e datës 12.02.2002 ndërmjet shoqërisë “Alb-Building” dhe {...}t, ku pranohet projekti dhe konsulenca në zbatimin e tij si investim në shërbime në objektin në rrugën “Reshit Petrela”;



- Kontrata e kredisë së marrë nga “Alb-Building”, Rep.nr. 376, Kol.nr. 89, datë 24.01.2003, shoqëruar nga kontrata e hipotekës;
- Kontratë hipotekimi Rep.nr. 383, Kol.nr. 93, datë 24.01.2003, ku një nga subjektet hipotekëdhënës është {...}, kolateral për kredinë është vendosur trualli në rrugën “Reshit Petrela” mbi të cilën po bëhej investimi, një nga bashkëpronarët është {...};
- Kontratë shkëmbimi datë 16.06.2005, Rep.nr. 2081, Kol.nr. 142, ndërmjet pronarëve të truallit dhe investitorëve, ku {...} është një nga personat që bën pjesë si në palën e pronarëve të truallit, ashtu edhe në atë investiture;
- Kontratë pjestimi vullnetar datë 30.05.2017, Rep.nr. 1544, Kol.nr. 937, nëpërmjet së cilës palët kanë pjestuar njësitë lokale (dyqane) që kanë pasur në bashkëpronësi dhe i kanë përfutuar si pronarë trualli. Para kësaj kontrate, ish-pronarët e truallit kanë lidhur një kontratë tjetër, ku kanë ribashkuar lokalet. Për këtë arsye sipërfaqja e lokalit të pëfutuar nga {...} (njësia 5) nga 45 m<sup>2</sup> që është cilësuar në kontratën e shkëmbimit, në kontratën e pjestimit është 35 m<sup>2</sup>. Kontratën e ribashkimit nuk arrita ta gjej në ZRPP (aktualisht ASHP);
- Janë dorëzuar edhe një deklaratë e shoqërisë “Alb-Building” e shtatorit 2019, si dhe një vërtetim i datës 08.11.2019, i cili shoqërohet edhe nga 120 mandatpagesa të blerësve të objektit në rrugën “Reshit Petrela”.

Pra, marrëdhënia e {...}t me shoqërinë “Alb-Building” nuk mund të cilësohet se mbetet vetëm në nivel deklarativ, kur ka 5 kontrata, një marrëveshje dhe dy deklarata të kësaj shoqërie që e provojnë.

**Për të provuar marrëdhënien me shoqërinë ndërtuese “2T” dhe investimin në Rrashbull Durrës janë dorëzuar:**

- Kontratë (investimi) datë 10.09.2003, lidhur me vërtetim nënshkrimi Rep. nr. 3911, datë 17.09.2003;
- Kontrata me pronarët e truallit datë 07.02.2002, Rep.nr. 348, Kol.nr. 37, ndërmjet “Mix Tecnic” (përfaqësuese e investitorëve) dhe pronarët e truallit, familjen Keja;
- Marrëveshja datë 05.09.2003, ku shoqëria “2T” njeh projektin dhe konsulencën në zbatimin e tij si kontribut në shërbime në investim;
- Kontrata e shkëmbimit datë 14.10.2005, Rep.nr. 4213, Kol.nr. 470;
- Kontratë pjestimi vullnetar datë 15.12.2005, Rep.nr. 5035, Kol.nr. 585;
- Vërtetimi i shoqërisë “2T” datë 07.11.2019.

Pra, marrëdhënia e {...}t me shoqërinë “2T” nuk mund të cilësohet se mbetet vetëm në nivel deklarativ, kur ka 4 kontrata, një marrëveshje dhe një vërtetim të kësaj shoqërie që e provojnë.

**Për të provuar marrëdhënien me shoqërinë ndërtuese “2T” dhe investimin në Golem Kavajë janë dorëzuar:**

- Kontratë (investimi) datë 25.03.2003, lidhur me vërtetim nënshkrimi Rep. nr. 3402;
- Marrëveshja datë 15.01.2004, ku shoqëria “2T” njeh projektin dhe konsulencën në zbatimin e tij si kontribut në shërbime në investim;
- Marrëveshja datë 16.01.2008, ndërmjet investitorëve dhe shoqërisë “2T” ku investitorët përcaktojnë pjesët takuese të secilit prej tyre;

- Marrëveshja datë 23.01.2012 ndërmjet shoqërisë “2T” dhe {...}t, në të cilën rregullohen të drejtat dhe detyrimet e {...}t si investitor me shoqërinë “2T” si ndërtuese;
- Kontratë shitblerje datë 09.02.2012, Rep.nr. 519, Kol.nr. 283, nëpërmjet së cilës {...} fiton pronësinë e disa njësive në Golem Kavajë;
- Dy mandatpagesa të vitit 2013 nga “2T” (nr. 97 datë 09.07.2013 me vlerë 20.000 euro dhe nr.183 datë 31.10.2013 me vlerë 10.000 euro) në favor të {...}t, në total 30.000 euro;
- Transfertë bankare në shumën 11.000 euro bërë nga “2T” në shtator 2019 në favor të {...}t.

Pra, marrëdhënia e {...}t me shoqërinë “2T” për investimin në Golem Kavajë nuk mund të cilësohet se mbetet vetëm në nivel deklarativ, kur ka 2 kontrata, 3 marrëveshje dhe 3 mandatpagesa të kësaj shoqërie që e provojnë.

***Për të provuar marrëdhënien me shoqërinë ndërtuese “Edicom” dhe investimin në rrugën “Ferit Xhajko” Tiranë janë dorëzuar:***

- Kontrata e investimit datë gusht 1998, me palë “Edicom” dhe Ilir Manushi e {...}, të përfaqësuar nga “Mix Tecnic”;
- Kallëzimi penal regjistruar me nr. 3203, datë 09.03.2015, bërë nga {...} kundër Ilir Manushit dhe Luigj Aleksit (administrator i “Edicom”);
- Transferta bankare e shumës 110.000 USD nga “Edicom” në favor të {...}t, bërë me datë 06.11.2015.

Pra, marrëdhënia e {...}t me shoqërinë “Edicom” nuk mund të cilësohet se mbetet vetëm në nivel deklarativ, kur ka 1 kontratë, një kallëzim penal dhe një transfertë bankare të kësaj shoqërie që e provojnë.

**Si përfundim, janë 25 dokumenta që provojnë marrëdhëniet e {...}t me 3 shoqëri ndërtimi për 4 investime, gjë që bën që deklaratimet e {...}t të mos mbeten thjesht në nivel deklarativ, por të jenë të provuara nga dokumentat përkatëse. Si rrjedhim, kjo gjetje e ILDKPKI-së nuk qëndron.**

**Gjetja 2 e ILDKPKI-së:**

- “Mungon dokumentacioni justifikues ligjor si: pasyrat financiare dhe librat\regjistrat e shoqërive të ndërtimit ku të jenë të pasqyruara në shifra dhe në mënyrë analitike marrëdhëniet (financiare ose jo) të {...}t me firmat ndërtuese, vlerat e investimeve, kontributeve në para apo në natyrë, detyrimet e firmave ndërtuese ndaj tij apo edhe anasjelltas, kthimet nga investimet; gjithashtu, mungojnë preventive dhe situacione për punimet e kryera në objektet e ndërtuara, mandat-pagesa dhe mandat arkëtime mbi pagesat për investimet e kryera apo për shumat e përfituara nga investimet, kontrata porositë apo kontrata sipërmarrje për shitjen e apartamenteve për të cilat {...} deklaror se ka përfituar të ardhura, të cilat më pas i ka riinvestuar në ndërtim, mandat-pagesa për pjesën takuese të kësteve të kredisë (450.000USD) për të cilën deklaror se e kanë përdorur investitorët për ndërtimin e objektit, si dhe dokumentacioni ligjor i vijueshmërisë së kallëzimit penal ndaj shoqërisë “EDICOM” shpk.”

Kjo gjetje është po e njëjtë me gjetjen 1, por këtu specifikohen dokumentat financiarë që kërkohen. Të vetmet dokumenta që provojnë marrëdhëniet investitore të {...}t janë ato 25

dokumenta të cilësuar në pikën 1. Për investime që kanë mbi 10 vite që janë mbyllur është e pamundur të gjenden pasqyrat financiare që pretendon ILDKPKI.

Për më tepër, neni 32 pika 2 i ligjit 84/2016 përcakton shprehimisht se “Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër.”. Për këtë arsye kam marrë nga shoqëritë “Alb-Building” dhe “2T” dokumentacionin përkatës që provon se këto shoqëri nuk kanë më asnjë dokument financiar për këto objekte, për shkak se ligji i detyron t’i ruajnë vetëm 10 vjet dokumentet financiare për efekt kontabiliteti. (Bashkëlidhur deklarata datë 10.12.2019 nga “Alb-Building” dhe vërtetimi datë 11.12.2019 nga “2T”).

Gjithashtu, kam nxjerrë nga QKB ekstraktin për shoqërinë “Mix Tecnic” ku del qartë që kjo shoqëri ka pezulluar aktivitetin e saj që në mars 2012 dhe aktualisht është me status inaktiv. Për më tepër, shoqëria “Alb-Building” në vërtetimin e datës 08.11.2019 ka deklaruar se “Kur shoqëria “Mix Tecnic” mbylli aktivitetin, nxorri për të hedhur gjithë arkivin e saj”. Pra, shoqëria që ka qenë manaxhuese e gjithë investimeve tona jo vetëm që ka pezulluar prej më shumë se 7 vitesh aktivitetin e saj, por edhe ka hedhur gjithë arkivin, pa respektuar as detyrimin ligjor për ruajtjen 10 vjet të dokumentacionit financiar.

Pra, unë jam në pamundësi objektive për të disponuar atë lloj dokumentacioni që kërkon ILDKPKI, por mendoj se dokumentacioni i përmendur në pikën 1 është i mjaftueshëm për të provuar qënien si investitor të {...}t në objektet që ka deklaruar, nisur edhe nga fakti që unë nuk jam subjekt i vlerësimit kalimtar (sepse nuk kam qenë kurrë pjesë e pushtetit gjyqësor), por jam duke kaluar në vlerësim fillestar të pasurisë. Kjo bën që kërkesa ndaj meje të jetë e një niveli më soft se sa subjektet e vlerësimit kalimtar, për të cilët u krijua edhe procesi i vetingut, por janë edhe subjekte që kanë deklaruar që në vitin 2004.

Lidhur me kredinë, shoqëria kredimarrëse “Alb-Building” ka deklaruar si në deklaratën e shtatorit 2019, ashtu edhe në deklaratën e datës 10.12.2019 që kredia është marrë për llogari të gjithë investitorëve dhe kostoja e saj është përballuar nga të gjithë investitorët. Pra, nuk jemi vetëm ne që kemi bërë një shpjegim të tillë, por është edhe vetë kredimarrësi që ka deklaruar në dy dokumenta të ndryshëm të njëjtin fakt, duke provuar kështu atë gfarë ne kemi deklaruar.

### **Gjetja 3 e ILDKPKI-së:**

➤ “Është e paqartë se përse mandat-arkëtimet për shitjen e pasurive të paluajshme në rrugën ‘Reshit Petrela’, Tiranë janë arkëtuar nga shoqëria ‘Mix Tecnic’, ndërkohë që kontrata e shit-blerjes përfundimtare janë lidhur nga investitorët në mënyrë individuale dhe jo nga shoqëria “Mix Tecnic”.

Është shpjeguar në relacionin shpjegues dhe provohet nga të gjitha kontratat e investimit se shoqëria “Mix Tecnic” ka qenë manaxhuese e të gjitha investimeve të bëra nga grupi ynë i investitorëve, si përfaqësuese e investitorëve. Gjithashtu, ky fakt del edhe nga deklaratat apo vërtetimet e shoqërive “Alb-Building” dhe “2T”. Edhe kontratat me firmat e ndërtimit nuk janë lidhur nga investitorët, por nga shoqëria “Mix tecnic”, gjë që e evidenton vetë ILDKPKI në raportin e saj. Shoqëria “Mix Tecnic” nuk ka qenë vetëm manaxhuese e investimit të seksionit 2 në rrugën Reshit Petrela, por edhe e investimit të seksionit 1 (me investitorë Ardian Resulin dhe Koco Alinikaj). Edhe për këtë seksion ajo ka lidhur kontratat, ka arkëtuar pagesat dhe ka përgatitur kontratat përfundimtare. Ky fakt

vërtetohet edhe nga deklarata e Z.Adrian Resulaj e datës 12.12.2019, që po dorëzoj bashkë me këto prapësime.

Është pikërisht “Mix Tecnic” dhe ortakut i saj i vetëm Ilir Manushi që kanë zvarritur mbylljen e kësaj marrëdhënie investitore në seksionin 2 në rrugën Reshit Petrela.

#### **Gjetja 4 e ILDKPKI-së:**

- “Mbeten të paqarta dhe të paprovuara me dokumentacion justifikues ligjor vlerat dhe periudhat e investimeve (pjesa takuese) në ndërtimet e objekteve në rrugën ‘Reshit Petrela’, ‘Ferit Xhajko’, Tiranë, Rrashbull Durrës, Golem Kavajë, dhe rrjedhimisht për këtë arsye mbeten të paqarta dhe të pajustificuara me dokumentacion ligjor edhe burimet financiare që kanë shërbyer për ndërtimin e tyre.”

Kjo gjetje shpjegim të plotë gjen në pikat 1 dhe 2. Investimet janë sqaruar në deklaratë dhe në relacion si janë bërë dhe se kur janë kryer. Investime në para ka vetëm dy: në Rrashbull Durrës rreth 4.500.000 ALL dhe në Golem Kavajë rreth 4.200.000 ALL. Këto investime kanë filluar në fund të vitit 2003, fillim të vitit 2004. Edhe sikur këto shuma të konsiderohen se janë paguar që në fillim të investimit, {...} ka pasur fonde të mjaftueshme për pagesën e këtyre vlerave. Vetëm fitimet e shoqërisë UAECC shpk për vitet 2000-2003 janë në vlerën 8.346.000 ALL. **Pra, pothuaj i tërë investimi në të holla i bërë në këto dy objekte mbulohet nga të ardhurat që ka pasur {...} nga fitimet e shoqërisë UAECC që në fillimet e investimeve.** Po të përfshihet edhe fitimi i vitit 2004 (sepse investimet janë shtrirë edhe gjatë vitit 2005), të ardhurat e {...}t vetëm nga fitimet e shoqërisë janë 11.756.000 ALL. Gjithashtu, {...} ka pasur të ardhura edhe si profesionist i lirë në vitet 1996-1999. Pra, nuk qëndron pretendimi ILDKPKI-së se nuk bën dot analizë për këto periudha.

#### **Gjetja 5 e ILDKPKI-së:**

- “Nuk ka të dhëna nëse në pasurinë e paluajtshme në pronësi\bashkëpronësi të bashkëshortit {...}, janë kryer investime dhe nëse këto pasuri shfrytëzohen ose jo për ndonjë formë aktiviteti ose banimi (përveç atyre të deklaruara me qira dhe në përdorim).”

Në formularin e deklarimit të pasurisë nuk ka asnjë rubrikë ku kërkohet të deklarohet se për çfarë përdoret pasuria. Siç duket kjo gjetje është nga ato gjetje të veçanta që ILDKPKI më ka rezervuar mua në raport. Ky sqarim është dhënë i plotë në prapësimet e dorëzuara në datë 11.11.2019. Meqë nuk është kuptuar nga ILDKPKI, po e përsëris më të detajuar.

- Apartamenti në Rrugën Budi Tiranë është banesa e familjes tone;
- Apartamenti në Rrashbull Durrës përdoret nga familja jonë;
- Zyra dhe shtesa e legalizuar e kësaj zyre në rrugën “Reshit Petrela” (sot Asim Vokshi) përdoren nga “UAECC” shpk si seli e aktivitetit të kësaj shoqërie. Ky fakt del edhe nga ekstrakti i QKB për shoqërinë UAECC dorëzuar në ILDKPKI bashkë me deklaratën e pasurive;
- Dyqani në rrugën “Reshit Petrela” (sot Asim Vokshi) është dhënë me qira. Është dorëzuar kontrata e qirasë;
- Zyra në rrugën “Abdi Toptani” është dhënë me qira. Është dorëzuar kontrata e qirasë;
- Lokali në Rrashbull Durrës është përdorur prej shumë vitesh pa shpërblim nga njëri nga bashkëpronarët, Dritan Troksi, dhe familjarët e tij. Aktualisht nuk përdoret fare, por në fund të pranverës besoj duhet të rihapet sërish. (provohet nga deklarata e Dritan Troksit);

- Garazhet takuese në rrugën “Reshit Petrela” përdoren nga UA ECC për mjetet e saj dhe të punonjësve;
- Garazhet në Rrashbull Durrës përdoren nga të gjithë bashkëpronarët;
- Apartamentet dhe garazhet në Golem Kavajë nuk përdoren fare. Janë pezulluar kontratat e furnizimit me energji elektrike për apartamentet.

#### **Gjetja 6 e ILDKPKI-së:**

- “Lidhur me objektin 4 kate në Rashbull Durrës, sipas relacionit shpjegues dhe prapësimeve, në këtë objekt janë shitur 3 apartamente dhe janë përfituruar gjithsej nga bashkëpronarët 37.288 euro dhe 4.300.000 lekë, të cilat nuk janë arkëtuar, por kanë shkuar në investimin e objektit, por nga dokumentacioni i administruar rezulton se shitjet e këtyre 3 (tre) apartamenteve janë kryer mbasi pasuritë e paluajtshme ishin regjistruar e rrjedhimisht, mbasi ishte përfunduar investimi dhe logjikisht të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamenteve nuk mund të jenë përdorur si burim financiar për ndërtimin e këtij objekti. Nuk ka asnjë dokumentacion justifikues ligjor që të provojë se shumtat 37.288 euro dhe 4.300.000 lekë janë arkëtuar përpara se të përfundojë ndërtimi i objektit dhe më pas të jenë investuar në ndërtim.”

Është e pamundur që të gjenden dokumente për pagesat e këtyre vlerave gjatë ndërtimit të objektit, sepse janë veprime të kryera mbi 15 vite më parë. Për më tepër, siç kam sqaruar në pikën 3, ishte shoqëria “Mix Tecnic” që lidhte kontratat e porosisë dhe arkëtonte shumtat që paguanin klientët, si manaxhuere e investimit (përfaqësuese e investitorëve). Në pikën 2 të kontratës (investimit) të datës 10.09.2003, lidhur me vërtetim nënshkrimi Rep.nr.3911, datë 17.09.2003 është përcaktuar shprehimisht manaxhimi i objektit nga “Mix Tecnic” si dhe lidhja e kontratave dhe arkëtimi i pagesave nga kjo shoqëri.

Në pikën (gjetjen) 2 kam sqaruar se shoqëria “Mix Tecnic” ka pezulluar aktivitetin e saj prej më shumë se 7 vitesh dhe ka hedhur gjithë arkivën e saj.

Për këtë arsye u detyrova të kontaktoj dy nga blerësit (Adrian Resulaj dhe Fisnik e Lindita Kadiun), të cilët bënë deklaratat se pagesat i kanë bërë gjatë kohës që ndërtohej objekti. Pra, vetë blerësit provojnë deklarinimin që kemi bërë ne, se pagesat janë bërë kryesisht gjatë ndërtimit të objektit dhe janë përdorur si pjesë e investimit.

Bashkëlidhur deklarata e Fisnik Kadiu e Lindita Topçiu Kadiu, datë 10.12.2019 dhe deklarata e Adrian Resulaj, datë 12.12.2019.

#### **Gjetja 7 e ILDKPKI-së:**

- “Rezulton se bashkëshorti i kandidatit, nuk ka deklaruar të ardhura të përfituara nga shitja e 3 apartamenteve në Komunën Rrashbull, Durrës, ku referuar kontratave të shitjes, për pjesën takuese prej 1/6, ka përfituruar 20.483 euro dhe 717.000 lekë.”

Kjo gjetje është e njëjtë me pikën 6.

Edhe në prapësimet e bëra në 11.11.2019 është pranuar nga ne që nuk kemi deklaruar shumtat e arkëtuar nga 3 kontratat e shitjes, por është sqaruar se nuk i kemi deklaruar, sepse vlerat kanë qenë modeste dhe janë përdorur në investimin e objektit. Kjo ka qenë thjesht një pasaktësi nga ana jonë. Por, **nuk kemi fshehur faktin e shitjes të 3 apartamenteve, sepse e kemi cilësuar shprehimisht këtë fakt në relacionin shpjegues (faqe 2, paragrafi i dytë).** Pra, ky mosdeklarim është thjesht një gabim perceptimi nga ana jonë, sepse duke mos i arkëtuar këto shuma, menduam se nuk duhet t'i deklaranim. Kërkojmë ndjesë për këtë gabim të paqëllimtë perceptimi. Gjithësesi, shumtat në këtë rast

kanë qenë 37.288 euro dhe 4.300.000 lekë në total, dmth pjesa takuese (1/6) 6.215 euro dhe 717.000 ALL.

#### **Gjetja 8 e ILDKPKI-së:**

- “Rezulton se çmimi shitjes së apartamentit me sip. 93 m<sup>2</sup> dhe verandë me sip 26.84 m<sup>2</sup>, në Komunën Rashbull, Durrës, në kontratën e shitjes me kusht, nr. 5803 rep, nr. 615 kol, dt. 30.12.2005, dorëzuar në ASHK, është 122.900 euro. Të dyja këto kontrata rezulton se janë nënshkrur edhe nga bashkëshorti, {...}”.

Edhe në prapësimet e 11.11.2019 kemi deklaruar se nuk dimë ta sqarojmë këtë situatë. E vetmja vlerë kontrate që njohim është ajo 37.288 Euro. Për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, kjo është një situatë që nuk mund të sqarohet, sepse është përmbushur çdo afat i mundshëm parashkrimi. Gjithashtu, për shkak se i kemi ndërprerë tërësisht marrëdhëniet me Ilir Manushin që kur kemi bërë kallëzimin penal në 2015, nuk mund të kërkojmë sqarim as nga ai si ortak dhe administrator i shoqërisë “Mix Tecnic” që manaxhonte investimin e këtij objekti dhe hartonte kontratat. Manaxhimi i investimit nga “Mix Tecnic” provohet nga pika 2 e kontratës (investimit) të datës 10.09.2003, lidhur me vërtetim nënshkrimi Rep.nr.3911, datë 17.09.2003, ku është përcaktuar shprehimisht manaxhimi i objektit nga “Mix Tecnic” si dhe lidhja e kontratave dhe arkëtimi i pagesave nga kjo shoqëri.

#### **Gjetja 9 e ILDKPKI-së:**

- Konstatohet se bashkëshorti i kandidatit ka deklaruar lokal shërbimi me sip. 267.28 m<sup>2</sup> (në proces të regjistrimit të legalizimit të shtesës), të regjistruara 164.16 m<sup>2</sup>, në Rashbull, Durrës, ndërsa ASHK Durrës e konfirmon me sip. 292 m<sup>2</sup>. Rezulton se nuk ka deklaruar faktin se për këtë lokal ai dhe bashkëpronarët e tjerë, janë pajisur me Leje Legalizimi nr. 0085239, dt. 2.5.2016. Gjithashtu, mbetet e paqartë vlera e investuar dhe burimi financiar që ka shërbyer për ndërtimin e shtesës si dhe nuk ka të dhëna nëse janë kryer investime e nëse ky lokal shfrytëzohet ose jo për ndonjë formë aktiviteti.

Në fakt kur kemi deklaruar “në proces të regjistrimit të legalizimit të shtesës” kemi deklaruar se shtesa është legalizuar dhe është në proces regjistrimi i kësaj shtese. Me ndjekjen e procedurave të legalizimit dhe të regjistrimit është marrë bashkëpronari Dritan Troksi, familjarët e të cilit edhe përdorin këtë lokal. Kur bëmë deklarin e pasurive pyetëm Dritan Troksin se cila ishte situata me shtesën dhe ai na tha se ishte bërë legalizimi dhe ai, pasi kishte bërë pagesat në Bashkinë Durrës për infrastrukturën, kishte aplikuar për regjistrim në ZRPP Durrës dhe i kishte dorëzuar të gjitha dokumentat atje. Pas interesimit në ASHK Durrës, punonjësit e ASHK-së nuk arritën të gjenim dosjen e legalizimit, por me shumë vështirësi arritën të gjenin vetëm numrin e Lejes së Legalizimit dhe datën (Leje Legalizimi nr. 0085239, dt. 2.5.2016). Për këtë arsye nuk është paraqitur kjo leje legalizimi dhe ne nuk dimë sipërfaqen përfundimtare me të cilën është miratuar kjo leje. Ndërkohë që lokali është ndërtuar që në fillim me sipërfaqe 267.28 m<sup>2</sup>, gjë që del nga nga akti i kolaudimit, por është regjistruar me sipërfaqe 164 m<sup>2</sup>. Këtë fakt unë e kam deklaruar që në tetor 2011 në deklaratën e pasurisë para fillimit të funksionit si anëtare e bordit të AMF-së. Ne nuk kemi investuar në këtë lokal, përveç sa është investuar në fillim kur është ndërtuar ky lokal, si pjesë e godinës në Rrashbull, Durrës. Këtë fakt e provon edhe deklarata e Z.Dritan Troksi, datë 12.12.2019.

#### **Gjetja 10 e ILDKPKI-së:**

- “Në dt. 29.7.2010, shoqëria ‘Hera’ shpk, ka kreditur në llogari shumë 3.000 euro me përshkrimin ‘pag projekti arkitekturë...’. Për këto të ardhura kandidati nuk ka dhënë sqarime dhe nuk ka paraqitur dokumente justifikuese ligjore.”

Kjo shumë është paguar nga “Hera” shpk për shkak të një kontrate shërbimi me këtë shoqëri për përshtatjen e një projekti. {...} nuk e ka deklaruar dhe nuk ka dhënë shpjegime, sepse nuk kujtohej se cila ishte firma “Hera” dhe cila ishte arsyeja e bërjes së kësaj pagese. Ka qenë një shërbim i vetëm dhe i shkurtër, bërë para 10 vitesh. Bashkëshorti nuk e kishte kontratën, por kontaktoi me administratoren e shoqërisë “Hera”, që i dha një kopje të kontratës.

Bashkëlidhur kjo kontratë që po dorëzohet për herë të parë.

#### **Gjetja 11 e ILDKPKI-së:**

- “Gjatë periudhës 2013 dhe 2014, bashkëshorti ka përfituar të ardhura nga qiraja me shoqërinë ‘Invest Real Estate’ shpk, në shumën 3.827 euro, të cilat nuk i ka deklaruar si të ardhura në asnjë nga deklaratat e interesave private të dorëzuara në ILDKPKI.”

Edhe në prapësimet e 11.11.2019 kemi sqaruar që ka qenë thjesht një harresë nga ana jonë, por nuk është e vërtetë që këto të ardhura nuk janë deklaruar asnjëherë nga ne. **Në deklaratat e bëra në ILDKPKI për vitet 2013 dhe 2014 janë deklaruar këto shuma:** 746 euro në 2013 dhe 3.084 euro në 2014. Për më tepër, bashkë me kontratën e qirasë, në 11.11.2019 si dokumenta plotësues, kemi dorëzuar edhe formularët e pagesës së tatimit në burim për këtë kontratë. Pra, ka qenë thjesht një harresë.

**Pas dokumentave të paraqitura nga ne, kjo gjetje nuk duhet të ishte më në këtë raport, sepse janë deklaruar që në vitet 2013 dhe 2014 dhe fakti që janë dorëzuar edhe mandatpagesat e tatimit në burim, provon se nuk kemi pasur arsye për të mosdeklaruar të ardhurat e përfituara prej tyre, por edhe që të ardhurat janë të ligjshme dhe mosdeklarimi është harresë.**

Për më tepër, ka pasur subjekte të rivlerësimit kalimtar që kanë harruar llogari bankare në shuma tepër të mëdha apo shtëpi të harruara për tu deklaruar dhe përsëri kanë kaluar me sukses vetingun, duke u konfirmuar në detyrë.

#### **Gjetja 12 e ILDKPKI-së:**

- “Gjatë periudhës 2006 dhe 2007, bashkëshorti ka përftuar të ardhura nga qiraja me shoqërinë ‘The point’ shpk, në shumën 16.200 euro, të cilat nuk i ka deklaruar si të ardhura në asnjë nga deklaratat e interesave private të dorëzuara në ILDKPKI.”

Edhe kjo gjetje është sqaruar që në prapësimet e bëra në 11.11.2019. Janë dorëzuar si dokumenta plotësuese dy kontrata qiraje me shoqërinë ‘The point’ shpk. Edhe kjo ka qenë një harresë. Për shkak të kohës së gjatë që ka kalur e kishim harruar këtë marrëdhënie qiraje. Nuk kishim arsye për të mos i deklaruar këto dy kontrata, sepse në nenin 20 të kontratave të gjitha detyrimet financiare (përfshirë edhe taksat) i ngarkoheshin qiramarrësit. Arsyetimi i ILDKPKI-së se kemi deklaruar kontratat me shoqërinë “Marko” që në 1996 dhe nuk kemi deklaruar këto në 2006, nuk qëndron. Vlera e dy kontratave me shoqërinë “Marko” është rreth 40.000 USD në një kohë që pagat mujore ishin më pak se 10.000 lekë, ndërsa vlera e këtyre kontratave qiraje ishte 600 euro në muaj, dmth rriste të ardhurat mujore, ndërkohë që edhe pagat ishin 5-7 fishuar krahasuar me 1996. Pra, ajo që përfaqësonte e ardhura nga kontratat me shoqërinë “Marko” ishte fare ndryshe krahasuar me atë që përfaqësonte e ardhura nga dy kontratat e qirasë.

Pra, thjesht për arsye harrese këto të ardhura nga kontratat e qirasë me shoqërinë “The point” shpk nuk janë deklaruar. Kërkojmë ndjesë për këtë harresë.

**Pas dokumentave të paraqitura nga ne, kjo gjetje nuk duhet të ishte më në këtë raport, sepse fakti që ne kemi shënuar në çdo kontratë qiraje që kemi lidhur detyrimin e**

**qiramarrësit për pagesën e tatimit në burim, provon se nuk kemi pasur arsye për të mosdeklaruar të ardhurat e përfituara prej tyre, por edhe që të ardhurat janë të ligjshme dhe mosdeklarimi është harresë.**

Për më tepër, ka pasur subjekte të rivlerësimit kalimtar që kanë harruar llogari bankare në shuma tepër të mëdha apo shtëpi të harruara për tu deklaruar dhe përsëri kanë kaluar me sukses vetingun, duke u konfirmuar në detyrë.

#### **Gjetja 13 e ILDKPKI-së:**

- “Është e paqartë se përse bashkëshorti, në datë 22.10.2008, ka transferuar nga llogaria e tij në ISP Bank, në llogarinë e {...}, shumën e 10.000 euro, me përshkrimin ‘pagesë për shërbime juridike’”

Është e turpshme që kjo vazhdon të konsiderohet si gjetje nga ILDKPKI. Edhe një herë sqarohet se bazuar në Kodin e Familjes çdo pasuri e krijuar gjatë martesës është në bashkëpronësi të dy bashkëshortëve. Për rrjedhojë, edhe paratë i nënshtrohen të njëjtit regjim. **Bashkëshorti më ka paguar për të gjitha shërbimet juridike dhe të tjera (të çdo lloji që kanë qenë) që kam bërë për familjen dhe për bashkëshortin, nga llogaria e tij bankare që i nënshtrohet regjimit të bashkëpronësisë bashkëshortore. Dmth më ka paguar me paratë që ishin edhe të miat.**

#### **Gjetja 14 e ILDKPKI-së:**

- “Në deklaratën e interesave private të kandidatit për anëtar të Gjykatës Kushtetuese, ka deklaruar; ‘Të ardhura nga investimi i bërë në Golem, Kavajë. Marrë në 2013 me 2 mandate arkëtimi (20.000 euro + 10.000 euro). Përdorur për të blerë tokën në Mullet, Tiranë. Shuma 30.000 euro’. Në deklaratën e interesave private të kandidatit për anëtar të Gjykatës së Lartë ka deklaruar “Të ardhura nga investimi i bërë në Golem, Kavajë. Sipas vlerave të shitjes për dy kontrata duhet të arkëtojnë 71.000 euro, por për shkak se i detyroheshin ndërtuesit vlera reduktohej në 41.000 euro, nga të cilat kam marrë realisht vetëm 30.000 euro.”

Kjo gjetje më duket absolutisht e tepërt dhe pa vend. Nuk kuptoj cili është thelbi i kësaj gjetje. **Nuk ka mospërputhje, se në të dyja rastet kemi deklaruar të ardhura 30.000 euro,** vetëm se në deklaratën e shtatorit, duke ndjekur këshillën e ILDKPKI-së, bëra një përshkrim më të plotë se nga buronte e ardhura dhe pse ishte në atë vlerë. Madje, deklarin e shtatorit ka dokumenta që e provojnë, përveç dy mandatpagesave.

#### **Gjetja 15 e ILDKPKI-së:**

- “Lidhur me shumën 30.000 euro, që ka shërbyer për blerjen e tokës në Mullet, deklaruar me burim nga arkëtimi i të ardhurave nga investimi në Golem, Kavajë, nisur nga fakti se rezultojnë që nga ndërtimi i objektit në Golem Kavajë, {...} ka përfituar me kontratë shitje vetëm 3 apartamente dhe 3 garazhe, nga të cilat 2 apartamente dhe 3 garazhe i ka ende në pronësi dhe vetëm një apartament rezultojnë i shitur, por dhe ky rezultojnë i shitur në vitin 2015 me cmimin 10.970, rrjedhimisht edhe në këtë rast burimi financiar i shumës 30.000 euro mbetet i paqartë.”

Në prapësimet e datës 11.11.2019 kam dhënë sqarim të plotë për këtë pikë, por siç duket ILDKPKI, pavarësisht se sa dokumenta mund të dorëzoj unë, është e vendosur që të mos i pranojë ato.

Investimi në Golem Kavajë është deklaruar që në tetor 2011 në deklaratën para fillimit të detyrës si anëtare e bordit të AMF-së. Kalimi i pronësisë së apartamenteve dhe garazheve është deklaruar në deklaratën e 2012. Shuma 30.000 euro e përfituar nëpërmjet 2



mandateve është deklaruar në 2013, si dhe përdorimi i saj për blerjen e tokës në Mullet. Në të treja këto deklarata nuk janë konstatuar asnjëherë parregullsi, ndërsa tani ato kthehen në themrën e Akilit, pikërisht sepse janë përdorur për blerjen e tokës në Mullet. Po të pranohet kjo e ardhur justifikohet edhe blerja e tokës. Pra, duket se ILDKPKI ka paracaktuar që vlerësimi im nuk duhet të jetë pozitiv.

Dua të theksoj, se {...} nuk kishte nevojë patjetër për këtë shumë për blerjen e tokës në Mullet, sepse para kësaj blerje {...} kishte në llogarinë e tij bankare rreth 80.000 euro dhe unë kisha në llogaritë e mia rreth 20.000 euro. Pra, kishim tërësisht shumën që na nevojitej për blerjen e kësaj prone. Nisur nga fakti që i arkëtoi këto shuma, ai i përdori për blerjen e tokës.

Po përsëris sërish sqarimin e dhënë në 11.11.2019 për këtë investim në Golem, Kavajë. Për këtë objekt është dorëzuar kontrata e investimit, lidhur në 2003, e cila është lidhur me vërtetim nënshkrimi, pra është e regjistruar tek noteri që ka bërë vërtetimin e nënshkrimeve. Në këtë kontratë del qartë se {...} është njëri nga investitorët e objektit në fjalë. Në kontratë është shprehur qartë se të gjitha detyrimet tatimore për investitorët do të përmbusheshin nga Ndërtuesi ("2T" shpk). Gjithashtu, është dorëzuar edhe marrëveshja me Ndërtuesin "2T" shpk, ku ndërtuesi pranon projektin dhe konsulencën në ndjekjen e këtij projekti, si kontribut në investim. Në relacionin shpjegues është sqaruar se në këtë investim ne nuk synonim të përfitonim njësi në objekt, por donim vetëm të përfitonim të ardhurat nga shitja e këtyre njësive. Për shkak se ky investim nuk rezultoi një investim fitimprurës, investitorët bënë edhe një ndarje të njësive takuese për secilin (marrëveshje e datës 16.01.2008), me qëllim që secili investitor të interesohet për shitjen e njësive të tij takuese dhe të përfitonte drejtëpërdrejtë nga shitja e tyre. Mqs edhe pas 5 vitesh që objekti ishte regjistruar në emër të Ndërtuesit, ende nuk ishin shitur pjesa më e madhe e këtyre njësive dhe ndërtuesi ngarkohej me detyrime për to (fatura uji e energjie, taksa prone e taksa të tjera vendore) u bë kalimi i pronësisë në favorin tonë, pas zgjidhjes përfundimtare të marrëdhënies me Ndërtuesin me marrëveshjen e datës 25.01.2012. Pas kësaj kontrate, forma që u gjet më e përshtatshme për kalimin e pronësisë ishte kontrata e shitjes me çmim reference, sepse ishin paguar të gjitha detyrimet tatimore për këto njësi, të cilat ishin përballuar nga investitorët dhe, në thelb, ne si investitorë kishim paguar për këto pasuri. Në marrëveshjen e datës 23.01.2012 me "2T" shpk është parashikuar edhe pagesa e shumës prej 41.000 euro në favor të {...}t, si e ardhur nga shitja e njësive takuese. Shuma 30.000 euro i është paguar {...}t nga "2T" shpk dhe provohet nga dy mandatpagesat e paraqitura nga ne (paguar në vitin 2013). Vlera e mbetur prej 11.000 euro nuk ishte paguar deri në 06.09.2019, kur u dorëzua deklarimi në ILDKPKI, por është përmbushur nga "2T" shpk në muajin shtator në llogarinë e {...}t në bankën ISP Bank (në 11.11.2019 kemi dorëzuar kopje të transferts bankare për shumën 11.000 euro).

Përsa më sipër, provohet qartësisht origjina e shumës 30.000 euro dhe provohet gjithashtu se këto të ardhura janë tërësisht të ligjshme dhe të justifikuara. Ka dy kontrata, 3 marrëveshje dhe tre mandatpagesa që e provojnë këtë marrëdhënie.

#### **Gjetja 16 e ILDKPKI-së:**

- "Rezulton se në deklaratën e interesave private për kandidat për Anëtar në Gjykatën Kushtetuese, kandidati nuk ka deklaruar të ardhura nga shoqëria 'Marko' shpk, në shumën 47.000 USD. Gjithashtu, konstatohet mospërputhje me shumën e deklaruar nga kandidati në deklaratën e interesave private për kandidat për Anëtar në Gjykatën e Lartë (40.000 USD), me shumën e përcaktuara në kontratat përkatëse të lidhura prej tij me shoqërinë 'Marko' shpk (47.200 USD), të cilat e kalojnë vlerën e përafërt deklaruar nga kandidati 'rreth 40.000 USD'."

*Siç del qartë nga dy kontratat me shoqërinë “Marko”, për secilën nga kontratat shoqëria “Marko” ka mbajtur tatimin në burim, dmth, nga 47.200 USD janë zbritur 4.720 USD. Pra shuma neto duhet të ishte 42.500 USD. Ne kemi deklaruar rreth 40.000 USD, sepse është mbajtur nga shoqëria “Marko” një shumë si garanci deri në përfundim të ndërtimeve. Nuk kujtohem se sa ka qenë ekzaktesisht kjo shumë, por duhet të ketë qenë rreth 2.000-3.000 USD. Kjo shumë nuk na është paguar asnjëherë. Për këtë arsye kemi shënuar rreth 40.000 USD. Por, edhe vlera 42.500 USD mund të konsiderohet rreth 40.000 USD.*

#### **Gjetja 17 e ILDKPKI-së:**

➤ *Konstatohet paqartësi lidhur me përshkrimin lidhur me mandat-arkëtimin dt. 13.10.1998, të kryer nga shoqëria ‘Marko’ shpk, për pagesën e tatimit në burim për llogari të {...}t, pasi përshkrimi në mandate-pagesë i referohet vitit 1995, ndërkohë që deri në dt. 31.12.1995, {...} ka deklaruar të ardhura dhe ka qënë punësuar në Bashkinë e Tiranës, ndërsa të ardhurat nga shoqëria ‘Marko’ shpk referuar kontratave dhe deklarimeve, rezultojnë se janë krijuar në periudhën 1996-1998. Pra mbetet e paqartë nëse {...} ka përfutur të ardhura të tjera nga shoqëria ‘Marko’ shpk, përveç atyre të deklaruar gjatë kohës që ka qënë punësuar në Drejtorinë e Urbanistikës, në Bashkinë e Tiranës, dhe nëse për të gjitha këto të ardhura janë shlyer ose jo detyrimet tatimore (rezulton i paguar tatim në burim vetëm shuma 360.000 lekë).*

*Është vërtetë i çuditshëm fakti që ILDKPKI ka kontestuar pothuaj të gjithë dokumentat e dorëzuara nga ne dhe të lëshuara nga DRT Tiranë, si dhe të ardhurat që provohen prej tyre.*

*Marrëdhënia e {...}t me shoqërinë “Marko” ka filluar në vitin 1996, me lidhjen e kontratës së parë me këtë shoqëri. Në vitet 1991-1995 {...} ka qenë i punësuar në shtet (Instituti i Urbanistikës dhe Bashkia e Tiranës) dhe nuk ka pasur marrëdhënie me subjekte private, pra, nuk ka përfutur asnjë të ardhur tjetër përveç pagës.*

*Nuk ka qenë kurrë detyrimi ynë të paguanim tatimin në burim. Vlera e tatimit në burim është mbajtur nga shoqëria “Marko” nga vlera e plotë e kontratës dhe duhet të ishte paguar nga kjo shoqëri, siç është përcaktuar në kontratat me këtë shoqëri. Pra, ne e kemi paguar këtë detyrim tek kjo shoqëri, të cilën e detyronte ligji për ta mbajtur tatimin në burim e më pas t’ia paguante drejtorisë së tatim-taksave. Pra, ne si subjekt kemi zbatuar detyrimin tonë ligjor.*

*Gjithashtu, edhe nëse nuk do të kishte fare pagesë të tatimit në burim, shuma rreth 40.000 USD që është deklaruar si të ardhura nga kontratat me “Marko” shpk, nuk i bën të paligjshme këto të ardhura, sepse, sipas komentarit për "Reformën kushtetuese në sistemin e drejtësisë", 2016 (fq.531-532) **“koncepti i pasurisë së ligjshme lidhet me burimin e krijimit të këtyre pasurive apo të ardhurave dhe jo me pagimin e detyrimeve tatimore të tyre. Një e ardhur nuk klasifikohet në sistemin financiar si e paligjshme nëse për të nuk janë paguar tatimet dhe taksat”.***

*Unë u interesova në DRT Tiranë, por për shkak të dëmtimit të zyrave nga tërmeti, punonjësit ishin shpërndarë nëpër godina të tjera. Në pamundësi për të komunikuar me ta, i jam drejtuar katër herë me email punonjësës së DRT Tiranë që ka ndjekur këtë praktikë, znj. Loreta Kallo.*

*Në tre nga këto emaile kam vënë CC edhe adresën e KLGJ me të cilën më bëhen komunikimet.*

*Më së fundi, në datë 13.12.2019 nëpërmjet email të orës 10.39 mora përgjigje nga punonjësja e tatimeve. Marrës i këtij email është edhe KLGJ. Në këtë email punonjësja e*

tatimeve është shprehur se “nga verifikimet e bëra konstatohet se mandati i pagesës i datës 13.10.1998 është në vlerën 360.000 lekë, paguar nga shoqëria “Marko” shpk me përshkrim Tatim në burim K.Kaskaviqi 1998.”. Bashkëlidhur email është kopje e këtij mandati.

Pra, edhe në këtë rast është provuar deklarimi ynë.

#### **Gjetja 18 e ILDKPKI-së:**

➤ “Lidhur me deklarimin e bashkëshortit të kandidatit për të ardhurat e përfituara si pronar trualli nga objekti shumëkatësh në rrugën ‘Reshit Petrela’, Tiranë, konstatohet se ky deklarim nuk rezulton të jetë deklaruar më parë në deklaratën e interesave private të kandidatit për anëtar të Gjykatës Kushtetuese. Referuar dokumentacionit të administruar nga ASHK Tirana Veri, rezulton nga shitja e pasurive të paluajtshme të përfituara nga investimi në ndërtimin e objektit 13- kate në rrugën ‘Asim Vokshi’, Tiranë, bashkëshorti i kandidatit, për pjesën e vetë takuese ka përfutuar të ardhura në një shumë totale prej 251.098 euro dhe 197.667 USD.”

Nuk kuptoj se si kjo qëndron ende si gjetje në këtë raport. Unë kam plotësuar me disa gabime deklaratën e prillit 2019, por kjo nuk mund të përdoret si argument kundër meje. ILDKPKI më këshilloi të ndaja në dy pjesë të ardhurat për këtë objekt, sepse si pronar trualli pjesa jonë takuese ishte 1/5, ndërsa si investitor pjesa takuese ishte 1/6. Ndërsa aktualisht, kur unë i ndaj të ardhurat në dy seksione, duke korrigjuar gabimin e bërë në deklarimin e prillit 2019, ILDKPKI ma quan sërish gabim korrigjimin e gabimit.

Edhe një herë, unë jam tërhequr nga konkurrimi për Gjykatën Kushtetuese. Arsyeja ka qenë pikërisht se kisha pasaktësi dhe gabime në deklarim. Këto gabime nuk mund të më ndjekin në çdo deklarim që do të bëj, sepse ky do të ishte persekutim ndaj meje në kundërshtim me ligjin, që e detyron ILDKPKI-në të bëjë vlerësim të deklaratës time të pasurisë sa herë unë plotësoj deklaratën, në rast se raporti i mëparshëm ka qenë negativ. Vetëm në rast të një vlerësimi pozitiv për 6 muaj nuk bëhet më vlerësim. Pra, ILDKPKI është e detyruar ligjërisht të vlerësojë deklaratën time aktuale të pronësisë dhe jo atë të mëparshmen, aq më tepër kur unë jam tërhequr nga kandidimi për Gjykatën Kushtetuese.

**Gjithësesi, në 06.09.2019 kam deklaruar të ardhura si pronar trualli rreth 82.000 euro + rreth 28.500 USD dhe të ardhura si investitor rreth 177.000 euro + rreth 169.000 USD. Pra, në total të ardhurat e deklaruara për objektin në rrugën “Reshit Petrela” rreth 259.000 euro + rreth 187.500 USD. Siç mund të konstatohet vlera në totalin e saj është e pothuaj e njëjtë me vlerën totale të deklaruar nga ASHK (251.098 euro + 197.667 USD).**

**Pra, edhe në këtë rast deklarimet tona janë të sakta dhe të konfirmuara nga ASHK, për këtë arsye kjo gjetje nuk qëndron.**

#### **Gjetja 19 e ILDKPKI-së:**

➤ “Për sa i përket shumës 110.000 USD të kredituar nga shoqëria ‘Edicom’, shpk, në llogarinë e bashkëshortit të kandidatit, konstatohet se përveç përshkrimit të transaksionit bankar ‘kthim detyrimi sipas rakordimit’, nuk ka asnjë të dhënë tjetër apo dokumentacion justifikues ligjor që të qartësojë dhe të provojë arsyet e këtij kreditimi.”

Në këtë marrëdhënie investimi, siç kemi sqaruar në mënyrë të përsëritur, ne kemi qenë pala e mashtruar nga dy investitorët e tjerë, derisa jemi detyruar të bëjmë kallëzim penal. Është e pakuptueshme se çfarë kërkon nga ne ILDKPKI, sepse kur dy investitorët e tjerë kanë dashur të na përjashtojnë tërësisht nga përfitimi i të ardhurave nga ky investim, si mund të marrim prej tyre në çfarëdo lloj dokumenti, edhe sikur ato të ekzistojnë ende. Të vetmet dokumenta që provojnë këtë marrëdhënie investimi në godinën në rrugën “Ferit Xhajko” janë:

- Kontrata e investimit datë gusht 1998, me palë “Edicom” dhe Ilir Manushi e {...}, të përfaqësuar nga “Mix Tecnic”;
- Kallëzimi penal regjistruar me nr. 3203, datë 09.03.2015, bërë nga {...} kundër Ilir Manushit dhe Luigj Aleksit (administrator i “Edicom”);
- Transferta bankare e shumës 110.000 USD nga “Edicom” në favor të {...}t, bërë me datë 06.11.2015.

{...} që në fillim investoi vlerën e projektit 39.000 USD, duke mos e tërhequr atë, por duke e përfshirë si investim në shërbime.

Edhe në këtë objekt shitjet janë bërë gjatë kohës që ndërtohej objekti dhe pjesa më e madhe e pagesave ishin bërë deri në vitin 2003.

{...} nga ky investim nuk mori asnjëherë asnjë përfitim, madje as vlerën e projektit, sepse objekti nuk u regjistrua në ZRPP (ishte ndërtuar një kat më pak parkime se sa leja e ndërtimit) dhe të mbyllej si marrëdhënia me blerësit, ashtu edhe ajo ndërmjet investitorëve. Ilir Manushi ndërkohë përfitoi një apartament 3+1, garazhe, si dhe vlera të konsiderueshme monetare. Në fillim të marsit 2015 {...} mori dijeni rastësisht se për këtë godinë, ku ai ishte investitor, kishin filluar procedurat e legalizimit dhe në aplikimin për legalizim ishte ndryshuar lista e investitorëve, duke u përfshirë në të blerës të njëjstëve të ndryshme në objekt dhe duke u hequr emri i {...}t nga lista e investitorëve. Për këtë arsye, në datë 05.03.2015 {...} ka bërë kallzim penal në Prokurorinë e Tiranës ndaj “EDICOM” shpk dhe Ilir Manushit, pasi i kishin hequr emrin si investitor i objektit.

Pas diskutimesh e bisedimesh të gjata, më në fund “EDICOM” shpk dhe Ilir Manushi ranë dakord që {...}t t’i paguhej nga “EDICOM” shpk shuma 110.000 USD si përfitim për investimin e bërë, pagesë që është bërë në datën 06.11.2015 në Union Bank nga “EDICOM” shpk. Pra, pas më shumë se 17 vjet ne mezi arritëm të merrnim përfitime nga investimi i bërë në këtë objekt.

Pra, për shkak të natyrës konfliktuale të zgjidhjes së kësaj marrëdhënie, ne nuk mund të sjellim dokumente të tjera shtesë, për më tepër, për një marrëdhënie mbi 20 vjeçare.

Ne jemi persekutuar e mashtruar në këtë marrëdhënie nga bashkëinvestitorët e si rrjedhim duhet të ndëshkohemi edhe nga ILDKPKI, sepse jemi në pamundësi për gjetjen e dokumentave të tjera. Aq më shumë që kjo vlerë nuk ka shërbyer për tu investuar në asnjë pronë.

Analizë me konstatimet financiare të ILDKPKI-së

1. Nga ILDKPKI janë njohur dhe pranuar si të provuara të ardhurat e mëposhtme:

- Të ardhurat nga pagat familjare, mësimdhënie, interesa bankare etj, për periudhën deri në 6.0.2019 rreth 48.550.000 lekë;
- Të ardhura nga qiratë 1.075.000 lekë + 14.248 euro;
- Të ardhura nga shitja e autoveturës 2.200 euro;
- Të ardhura nga Kristi shpk 4.950.000 lekë;
- Të ardhura nga shërbime dieta spitali amerikan Prishtinë 3.224 euro;
- Të ardhura nga fitimet e UAECC 37.442.000 lekë;
- Të ardhura nga shitja e apartamentit në Golem Kavajë 10.970 euro.

Në total, vetëm këto të ardhura për të cilat nuk ka asnjë kontestim, janë 92.017.000 lekë dhe 30.642 euro.

2. Nga ILDKPKI janë përlogaritur vlerat e të gjithë pasurive 43.386.000 lekë.
3. Nga ILDKPKI janë përlogaritur vlerat e shpenzuara për konsum familjar rreth 15.000.000.

**Pra, të ardhurat e pakontestuara nga ILDKPKI janë rreth 92.017.000+30.642 euro, ndërsa shpenzimet për pasuritë dhe jetesën rreth 58.386.000 lekë. Kështu rezulton një diferencë tepricë prej 33.631.000 lekë + 30.642 euro.**

Kjo provon se edhe po të llogariten vetëm të ardhurat e njohura nga ILDKPKI dhe të zbriten vlerat e pasurisë duke marrë të mirëqena përlogaritjet e pasurive siç i ka bërë ILDKPKI, si dhe duke zbritur shpenzimet për jetesë, përsëri kam një diferenca plus 33.631.000 lekë + 30.642 euro.

**Si rrjedhim, të ardhurat tona të pakontestuara nga ILDKPKI mbulojnë bindshëm gjithë pasuritë dhe shpenzimet tona.**

Gjithashtu, ILDKPKI nuk ka mundësi të kundërshtojë të ardhurat e fituara si pronar trualli në godinën në rrugën “Reshit Petrela”, të cilat janë rreth 82.000 euro + 28.500 USD, sepse nuk ka bërë asnjë kundërshtim lidhur me burimin e krijimit të këtyre të ardhurave.

Gjithashtu, është provuar nga tatimet e ardhura prej 3.240.000 lekë (paguar tatim në burim në vlerën 360.000 lekë).

Po kështu, janë provuar si të ardhura të ligjshme shumat e përfituara nga qiratë: 16.200 euro + 3.828 euro. Pra, mbi vlerat e pakontestuara nga ILDKPKI shtohen si të provuara dhe të ligjshme e që nuk duhet të ishin kontestuar në raportin e datës 2 dhjetor 2019, rreth 102.000 euro + 28.500 USD + 3.240.000 lekë, që në total të tyre janë afërsisht (po të konvertohen) 19.000.000 lekë të tjera, apo rreth 45 % të vlerës totale që ILDKPKI ka llogaritur pasuritë tona.

***Si përfundim, mendoj se ne provojmë bindshëm se kemi pasur burime të ligjshme të të ardhurave, si dhe që pasuritë tona mbuloohen po bindshëm nga të ardhurat tona, madje edhe sikur analiza financiare të bëhet vit pas viti.***

***Për sa më sipër i kërkoj KLGJ që në zbatim të ligjit të bëjë ajo vetë vlerësimin e deklatës time të pasurive.***

9. Për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidaten {...} u kërkuar informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

9.1 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informacioni u dërgua me Shkresën nr. 15071/1 prot., datë 13.08.2019, ku për kandidaten {...}, referohen të dhëna në lidhje me punësimin të parashtruara më lart.

9.2 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave informacioni u dërgua me Shkresën nr. 20339/1 prot., datë 26.08.2019, ku për kandidaten {...} nuk jepet ndonjë e dhënë me karakter pasuror.

10. Të dhënat e dërguara përmes informacioneve respektive nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave u ballafaquan me të dhënat sipas Raportit të ILDKPKI-së, duke u vlerësuar se nuk kishte vend për t'ju kërkuar ILDKPKI-së bërja e një kontrolli shtesë. Të dhënat e referuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve rezultojnë të jenë deklaruar nga ana e kandidates, si dhe të kenë qenë pjesë e kontrollit të plotë, nga ILDKPKI-ja, të pasurisë, aseteve dhe interesave të deklaruara nga kandidatja.

11. Nga verifikimi i kriterit të pasurisë për kandidaten {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet për ekzistencën e shkaqeve të kualifikimit ose skualifikimit të saj. Konkretisht, të dhëna në lidhje me:

- a) plotësimin, depozitimin ose jo nga kandidatja, të formularit të deklaratës së pasurisë;
- b) plotësimin, depozitimin ose jo nga kandidatja, të nënshkruara, të autorizimeve të kërkuara për verifikimin e pasurisë;
- c) burimet financiare të kandidates dhe justifikimin ose jo të pasurisë së saj;
  - ç) plotësinë, vërtetësinë dhe saktësinë ose jo, të deklaratimit të pasurisë, aseteve ose të interesave private, të detyrueshme për t'u deklaruar.

### **C. Për kriterin e figurës sipas nenit 49, pika 5, të Ligjit të Statusit**

1. Për kandidaten {...} u verifikua kriteri i figurës, përcaktuar në pikën 5, të nenit 49 në lidhje me pikat 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit të Statusit.

2. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidaten {...}, u kërkuar raportim nga institucionet ligjzbatuese të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit të Statusit, me përjashtim të Byrosë Kombëtare të Hetimit, e cila nuk është ngritur ende.

3. Nga raportimet e shërbimeve shtetërore informative nuk u identifikua dhe verifikua ndonjë e dhënë për lidhje ose kontakte të papërshtatshme të kandidates {...} me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e tij në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitete të kundërligjshme.

4. Po ashtu, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidaten {...}, asaj iu kërkuar dhe ajo plotësoi e depozitoi rregullisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 30.07.2019, formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione

publike”, si dhe autorizimin për Këshillin që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, të të dhënave të saj në lidhje me figurën dhe integritetin.

5. Në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Prokuroria e Përgjithshme ka kryer verifikimin përkatës, duke përcjellë në Këshill, me Shkresën nr. 2153/141 prot., datë 03.12.2019, Vendimin “Për miratimin e rezultateve të verifikimit për subjektin Sotir{...}”, sipas të cilit është vlerësuar se “*Subjekti deklarues Sotir{...}, kandidatë për gjyqtarë në Gjykatën e Lartë, nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2, të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.*

6. Nga formulari i vetëdeklarimit të kandidates sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ashtu edhe nga Vendimi i Prokurorisë së Përgjithshme “Për rezultatet e verifikimit për subjektin {...}”, nuk del që kandidatja: të ketë qenë ndonjëherë e dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj; të jetë dënuar me burgim me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj, për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë; të ketë qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj, për kryerjen e një vepre penale; të ketë qenë ndonjëherë e ndaluar apo e arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale; të ketë qenë ndonjëherë nën ndonjë masë shtrënguese sigurimi personal; të ketë qenë ndonjëherë në kërkim në bazë të ndonjë urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale; të jetë dëbuar nga një shtet i huaj.

7. Po në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, me Shkresën nr. 6585/1 prot., datë 22.08.2019, ka dërguar në Këshill një informacion me të dhënat për përbërësit e gjendjes civile edhe për kandidaten {...}, pas verifikimeve të bëra në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010 dhe në zyrat përkatëse të gjendjes civile. Sipas informacionit të dërguar, kandidatja nuk ka kryer ndryshime të përbërësve të gjendjes civile. (Sipas aktit të lindjes nr. 335, datë 30.03.1972 emri dhe mbiemri rezultojnë ‘a Katra’).

8. Bazuar në informacionin e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, nëpunësi përgjegjës i strukturës së posaçme pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi kreu verifikimet e rastit, nuk konstatoi mangësi në të dhënat e deklaruara nga kandidatja {...} në formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Për pasojë, u vlerësua që nuk kishte vend për verifikim shtesë nga Prokuroria e Përgjithshme.

9. Nga verifikimi i kriterit të figurës për kandidaten {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet për ekzistencën e shkaqeve të kualifikimit ose skualifikimit të tij. Konkretisht, të dhëna në lidhje me:

- a) plotësimin, depozitimin ose jo nga kandidatja, të formularit të vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015;
- b) plotësimin, depozitimin ose jo nga kandidatja, të nënshkuara, të autorizimit për Këshillin e Lartë Gjyqësor që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e saj;
- c) ekzistencën ose jo të lidhjeve ose kontakte të papërshtatshme të kandidates me persona të përfshirë në krimin e organizuar;
- ç) qënien ose jo të kandidates, anëtare, bashkëpunëtore ose e favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara datës 2 korrik 1991, në kuptimin e Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- d) qënien ose jo të kandidates, bashkëpunëtore, informatore ose agjente e shërbimeve të inteligjencës;
- dh) ekzistencën ose jo të të dhënave të tjera në lidhje me figurën dhe integritetin e kandidates,
- mbi të cilat mund të gjykohej për pranueshmërinë ose jo të saj për emërimin si gjyqtare në Gjykatën e Lartë.

#### IV. SHQYRTIMI NGA KËSHILLI I REZULTATEVE TË VERIFIKIMIT

Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi u njoh me relacionin përkatës si dhe materialet e grumbulluara gjatë verifikimit, duke e konsideruar të plotë procesin e verifikimit, marrë shkas nga gjetjet e konstatuara nga relatori i çështjes në lidhje me një nga kriteret e kandidimit të znj. {...}, dhe konkretisht me kriterin e pasurisë, vlerëson se :

1. Bashkëshorti i kandidatit, z. {...} deklaron se ka përfituar pasuri të paluajtshme nga ndërtimi i **4** objekteve, përkatësisht:

- 1 objekt në rrugën Ferit Xhajko në Tiranë, nisur në vitin 1998.
- 1 objekt në rrugën Reshit Petrela Tiranë, nisur në vitin 2002.
- 1 objekt në Rrashbull Durrës nisur në mars 2003
- 1 objekt në Golem Kavajë, nisur në dhjetor 2003.

**1.1 Lidhur me objektin në rrugën Ferit Xhajko në Tiranë**, z. {...} deklaron se ka investuar 39.000 USD vlerë projekti, dhe nga ky investim ka marrë 110.000 USD. Të vetmet dokumente justifikuese ligjore që rezultojnë të administruara janë:



- *Kontratë, gusht 1998, me vërtetim nënshkrimi nr. 1189 Rep, dt. 11.9.2014, me palë: {...} e Ilir Manushi, përfaqësuar nga shoqëria “MIX TECNINC” sh.p.k ku sipas kësaj kontrate, palët duhet të investonin nga 300.000 USD secila. MIC TECNIC dhe EDICOM, bien dakord që të ndërtojnë një godinë të përbërë nga: një kat vendparkime nën tokë, një deri në dy katet e para dyqane ose lokale shërbimesh dhe apartamente, sipas studimit urbanistik të miratuar nga KRT e Bashkisë Tiranë, me vendimin nr. 22, dt. 18.8.1996.*
- *Transfertë bankare në Union Bank, ku evidentohet se në dt. 6.11.2015, “EDICOM” sh.p.k., ka transferuar në llogarinë e {...}t, shumën 110.000 USD me përshkrimin “kthim detyrimi sipas rakordimit”.*
- *Kallëzim penal, dt. 5.3.2015, me kallëzues: {...}, kundër, shoqëria “Edicom” sh.p.k., dhe Ilir Manushi, për veprën penale: Falsifikimi në bashkëpunim.*

Kandidati ka pretenduar se në ndërtimin e mësipërmka investuar vetëm vlerën 39.000 USD edhe kjo, jo e investuar drejtëpërdrejtë në formën e likuiditeteve por si vlerë projekti. Por i vetmi dokumentacion ku evidentohen vlera lidhur me investimin është kontrata e gusht 1998, ku sipas kësaj kontrate palët investitore, do të investonin 300.000 USD secila (pra bashkëshorti i kandidatit i bie të investonte shumën prej 150.000 USD). Gjithashtu në këtë ndërtim z.{...} përfaqësohet nga shoqëria “Mix teknik”, dhe kjo e fundit rezultoi si bashkëinvestitore e objektit dhe jo {...} si individ.

Lidhur me kthimin e shumës së kredituar nga EDICOM me vlerë 110.000 USD, kallëzimi penal që {...} i ka bërë shoqërisë EDICOM dhe shtetasit Ilir Manushi, nuk përmban të dhëna mbi rrethanat e ndodhura, apo ato që kanë ndodhur më pas, të cilat kanë bërë që shoqëria EDICOM të kreditojë në llogarinë e {...}t shumën 110.000 USD. Si i tillë ky kallëzim penal nuk përmban të dhëna të vlefshme për procesin e verifikimit të pasurisë.

**1.2 Lidhur me objektin në rrugën Reshit Petrela në Tiranë,** nga e cila {...} ka përfituar pasuri të paluajtshme, apartamente, njësi e garazhe, sipas deklaramentit ato janë përfituar një pjesë si pronar truall, dhe një pjesë si investitor. Dokumente justifikuese ligjore të paraqitura janë:

- *Kontratë shit - blerje nr. 3231 rep, nr. 536 kol, dt. 7.12.2001, ku nga pasuria e llojit truall me sip. 5.000m2 me nr. pasurie 7/121, pronarët e truallit (familja Boja) shesin një sipërfaqe 1.874m2. Blerës: {...}, Ilir Manushi, Pëllumb Beta, Odhise Bresho dhe Artan Saka. Çmimi: 13.000.000 lekë.*
- *Mandat arkëtime, të kryera nga shoqëria “Mix Teknik” (dhe mandat - arkëtime të tjera ku nuk evidentohet arkëtuesi, por vetëm financieri, ku në shumë raste emri i financierit ka qenë i njëjtë me emrin e financierit të shoqërisë “Mix Teknik”). Referuar mandat – arkëtimeve, rezultoi se në total janë arkëtuar: për vitin 2002 në shumën 325.842 USD dhe 2.000 euro; për vitin 2003 në shumën 3.700.000 lekë, 294.854 USD dhe 234.404 euro; për vitin 2004 në shumën 68.716 USD dhe 338.551 euro.*
- *Kontratë shkëmbimi nr. 2081 rep, nr. 142 kol, dt. 16.5.2005, për pasurinë e llojit truall me sip. 1.874m2, nr. pasurie 7/127, me palë: Pronarët e truallit: {...}, Ilir Manushi, Pëllumb Beta, Odhise Bresho dhe Artan Saka. Investitorët: {...}, Ilir Manushi, Pëllumb Beta, Odhise Bresho, Artan Saka dhe shoqëria “Alb Building” sh.p.k., ku palët pasurinë truall me sip. 1.874m2, me nr. pasurie 7/127, e shkëmbejnë pasurite.*
- *Kontratë pjesëtimi nr. 1544 rep, nr. 937 kol, dt. 30.5.2017.*

Veç sa sipër, bashkëshorti i kandidatit ka paraqitur dhe shkresa të thjeshta ku formalizohen marrëveshje të lidhur mes tij dhe shoqërisë ndërtuese Alb Building, lidhur me projektin dhe pjesëmarrjen në supervizim duke i njohur si vlerë në investim, **por këto marrëveshje nuk konfirmohen nga DRT Tatimore dhe nuk ka asnjë gjurmë të regjistrimit të tyre në librat e shoqërive apo regjistrat publikë.**

Edhe në këtë ndërtesë si palë investitore (dhe si supervizore) shfaqet shoqëria Mix Tecnic, dhe jo {...} si individ. **Pra lidhur me investimin e kryer, nuk ka asnjë dokument justifikues në kuptimin e ligjit, që të provojë se sa ka qenë vlera e investuar nga {...} dhe koha kur është investuar.**

Prapësimet e kandidatit se marrëdhëniet mes paleve ishin tërësisht private dhe se ato rregulloheshin si i mendonin më mirë palët, si dhe konteksti i zhvillimit të shoqërisë shqiptare ishte fare i ndryshëm nga tani, ku kryesisht marrëdhëniet e palëve ishin joformale, ose se pagesat kryheshin me para në dorë dhe jo në mënyrë bankare, nuk përbëjnë argument ligjor. Kjo sepse rezulton se bashkëshorti i kandidatit veprimet e tij financiare për ndërtimin e objekteve i ka kryer me shoqëri tregtare dhe si të tilla, ato detyroheshin t'i përmbaheshin ligjeve të kohës, si ligjit nr. 7638, dt.19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", ashtu edhe ligjit nr. 7661, dt.19.1.1993 "Per kontabilitetin" dhe në zbatim të tyre, te regjistrin veprimtaritë financiare në libra dhe regjistrat përkatës.

Fakti se që nga koha e këtyre veprimeve e deri me sot, ka kaluar një kohë e gjatë dhe sipas pretendimit të kandidatit nuk zotërohen dokumente e për këtë arsye nuk mund të paraqesë dokumentacionin justifikues ligjor, nuk mund të justifikojë ligjshmërinë e krijimit të aseteve të deklaruara prej tij, pasi mungesa e regjistrave, librave, pasqyrave financiare të shoqërive ku të jenë të evidentuara veprimet e kryera nga bashkëshorti me secilën prej shoqërive të ndërtimit, e mbajnë situatën e marrëdhënieve financiare të investimit dhe burimin e investimeve, të paqartë dhe të pavërtetuar në kuptim të ligjit. Investimeve të kryera nga bashkëshorti i kandidatit, duke mosdorëzuar dokumentet e nevojshme, nuk mund t'i kryhet as një analizë financiare për të arritur në përfundimin nëse ai ka pasur ose jo burime financiare të mjaftueshme/të ligjshme për të investuar në ndërtimin e objekteve.

**Dokumentet justifikuese ligjore të paraqitura prej kandidatit, që kanë të bëjnë me investimet, provojnë shprehjen e vullnetit për të ndërrmarë iniciativën e investimit, por nuk provojnë se si dhe sa kanë qenë shumat e investuara dhe periudhat e investimit në këtë ndërtim.**

Dokumentet e paraqitura nga kandidati që tregojnë vlera të investuara, janë shkresa të thjeshta, ku shoqëritë e ndërtimit njohin si kontribut të bashkëshortit në investim, projekte apo supervizimet në ndërtim, por sipas raportit të ILDKPI-së, për to nuk ka asnjë gjurmë që të jenë të regjistruara në librat e shoqërive përkatëse. Sipas të njëjtit raport, në lidhje me këtë pasuri, rezulton se supervizimet në ndërtim janë kryer nga shoqëria "Mix Tecnic" sh.p.k dhe jo nga {...} si individ.

Po keshthu, sipas raportit të ILDKPI-së, në dokumentet e administruara janë konstatuar projekte ku {...} shfaqet si projektues, por vula në këto projekte është e shoqërisë "UA ECC" sh.p.k. Në bazë të këtyre konstatimeve, krijohet dukja se të ardhurat nga projektet dhe nga supervizimi, nuk janë perfituar direkt nga {...} si individ, por janë përfituar nga shoqëritë "UA ECC" sh.p.k., dhe "Mix Tecnic" sh.p.k., dhe këto të ardhura normalisht duhet të përfitoheshin prej tij vetëm në formën e dividendit. Te gjitha këto konstatime, nuk krijohet një panoramë të qartë financiare të kandidatit për krijimin e pasurive me burime të ligjshme.

Kandidati ka pretenduar se për të siguruar një pjesë të investimit në pasurinë e mesipërme ka shërbyer kredia prej 450.000 USD, por nga raporti i ILDKPI-së konstatohet se kredia është marrë tërësisht nga shoqëria "Alb - Building" dhe nuk rezulton e provuar që kjo kredi është përdorur edhe për llogari të investitoreve të tjere (*fakti që si kolateral është lënë truall në bashkëpronësi, nuk provon që investitorët e tjerë të kenë qenë domosdoshmërisht edhe përfitues së kredise*). Edhe në rastin se investitorët kanë përdorur kredinë prej 450.000 USD për ndërtimin e objektit, atëherë logjikisht, ata duhet t'i përgjigjeshin edhe financiarisht, duke shlyer detyrimet ndaj bankes/ose shoqërisë Alb-Building, nëse këstet bankare janë paguar prej kësaj të fundit. Lidhur me shlyerjet e detyrimeve ndaj kësaj kredie, qofshin këto në vlera monetare nga të ardhurat e tyre personale/fitimet, ose zbritje nga kthimi i investimit, referuar raportit të ILDKPI-së, nuk ka asnjë dokumentacion justifikues ligjor për të provuar këto interesa private.

**1.3 Lidhur me objektin në rrugën në Rrashbull, Durrës** nga i cili {...} ka përfituar pasuri të paluajtshme, apartamente, lokal e garazhe, të cilat sipas deklaramentit janë përfituar si investitor. Dokumente justifikuese ligjore të paraqitura janë:

- *Kontratë nr. 348 rep, nr. 37 kol, dt. 7.2.2002, ku pronarët e truallit, Sabri dhe Selman Keja, kanë pranuar që pasuria e tyre e llojit truall me sip. 300m2, me nr. pasurie 59/71, t'i vihet në dispozicion sipërmarrësit, shoqërisë "MIX TECNIC" sh.p.k., për të ndërtuar apartamente, dyqane, zyra, vend parkime, etj. Në përfundim të ndërtimit pronarët do të kenë në pronësi 4 apartamente me sipërfaqe bruto 55-60 m2 secili dhe 2 lokale me sipërfaqe bruto 80-85m2 secili.*
- *Kontratë datë 10.9.2003, me porositës: {...}, Ilir Manushi, Pëllumb Beta, Odhise Bresho, Artan Saka dhe Dritan Troksi. Përfaqësues: shoqëria "MIX TECNIC" sh.p.k. Ndërtues: shoqëria "2T" sh.p.k, ku përfaqësuesi ka lidhur një kontratë me shoqërinë "2T" sh.p.k, për ndërtimin e një godine banimi 3 kate + papafingo + garazhe, me Leje ndërtimi nr. 5, dt. 4.7.2003, nga KRT e Bashkisë Durrës.*
- *Kontratë pjesëtimi vullnetar nr. 5035 rep, nr. 585 kol, dt. 15.12.2005, ku pronarët: {...}, Ilir Manushi, Pëllumb Beta, Odhise Bresho, Artan Saka dhe Dritan Troksi, pronarë të pasurive:*
  - *Pasurinë nr. 59/91+1-7, apartament me sip. 116.57m2.*
  - *Pasurinë nr. 59/91+2-7, apartament me sip. 116.57m2.*
  - *Pasurinë nr. 59/91+2-6, apartament me sip. 94.57m2.*
  - *Pasurinë nr. 59/91+2-4, apartament me sip. 94.57m2.*
  - *Pasurinë nr. 59/91+1-5, apartament me sip. 94.57m2.*

- Pasurinë nr. 59/91+1-3, apartament me sip. 94.57m2.
- Pasurinë nr. 59/91 - Garazh + Ambiente ndihmëse me sip. 600m2,
- Pasurinë nr. 59/91-N - Lokal me sip. 164.16m2,  
të objektit Rezidencë 4 kate + papfingo dhe një kat parkimi nën tokë, të cilat dëshirojnë të pjesëtojnë, ku {...} të marrë në pronësi:
- Pasurinë nr. 59/91+2-7, apartament me sip. 116.57m2 dhe një sipërfaqe verande prej 38.07m2, në katin papafingo të objektit.
- 25% të pasurisë nr. 59/91 - Garazh + Ambiente ndihmëse me sip. 600m2, në katin nëntokë.
- 25% të pasurisë nr. 59/91-N – Lokal me sip. 164.16m2, kati përdhe.

**Veç sa sipër, {...} ka paraqitur dhe shkresa të thjeshta ku formalizohen marrëveshje të lidhura mes tij dhe shoqërisë ndërtuese 2T, lidhur me projektin dhe pjesëmarrjen në supervizim duke i njohur si vlerë në investim, por këto marrëveshje nuk konfirmohen nga DRT Tatimore, dhe nuk ka asnjë gjurmë të regjistrimit të tyre në librat e shoqërive apo regjistrat publikë.**

Edhe në këtë ndërtesë si palë investitore (dhe si supervizore) shfaqet shoqëria Mix Tecnic, dhe jo {...} si individ. **Pra lidhur me investimin e kryer, nuk ka asnjë dokument justifikues në kuptimin e ligjit, që të provojë se sa ka qenë vlera e investuar nga {...} dhe koha kur është investuar.**

Lidhur me pasuritë e përfituara nga ky ndërtim, referuar raportit të ILDKPI-së, konstatohet se në raportin e kontrollit, përcjellë nga DTM, kryer në shoqërinë "2T" sh.p.k., sipas situacioneve progresive, vlera në momentin e kontrollit (objekt i perfunduar) rezulton 44.835.481 leke pa TVSH, nderkohe qe sipas Akt- kolaudimit tekniko-ekonomik vlera faktike e punimeve eshte 33.500.000 leke. Nga sa është sqaruar nga kandidati dhe nga shoqëria "2T" sh.p.k., rezulton se TVSH-ja është paguar sipas akt-kontrollit tatimor, për shumën 44.835.481 leke. Por, duke llogaritur vlerën e TVSH-se së paguar (8.967.096 leke) dhe duke ia shtuar këto vlera, vlerës përfundimtare të ndërtimit, 44.835.481 leke, gjithmonë referuar raportit të ILDKPI-së, vlera totale e paguar nga investitorët do të përlogaritej në shumën rreth 53.800.000 leke. **Bashkeshorti i kandidatit, në asetet në bashkepronësi në Rrashbull, Durrës, ka deklaruar se zoteron 25% të pjesëve, çka do të thote se normalisht, për pjesën e tij takuese, duhet të ketë kryer edhe 25% të investimit, pra rreth 13.450.000 leke, por kjo vlerë nuk përputhet me vlerën e deklaruar prej tij si të investuar, prej 4.500.000 leke.**

Nga raporti i ILDKPI-së konstatohet gjithashtu se kandidati **nuk ka deklaruar të ardhurat** e përfituara nga shitja e apartamentit me sip 93.22 m2 dhe verandë 26.84 m2 në ndërtimin e mesipërm, sepse referuar kontratës së shitjes me kusht Nr. 5803 Rep 615 Kol dt. 30.12.2005 dorëzuar në DTM vlera është 37 288 euro, ndërsa referuar së njëjtës kontratë me të njëjtat ekstremite, të njëjtin numër Rep e Kol të dorëzuar në ASHK, vlera është 122.000 euro. Lidhur me objektin në Rrashbull Durrës, nga ILDKPI, janë administruar:

- *Kontratë shit – blerje me kusht, nr. 5803 rep, nr. 615 kol, dt. 30.12.2005, për shitje apartamenti me sip. 93.22m2, dhe një verandë me sip. 26.84m2, nr. pasurie 59/91-1-1. Shitës: {...}, Ilir Manushi, Pëllumb Beta, Odhise Bresho, Artan Saka dhe Dritan Troksi. Blerës: Maria Marchall. Çmimi: 122.900 euro. Porositësi ka paguar 36.880 euro, pjesa tjetër e pagesës e cila do të kreditohet është 86.020 euro e cila do të bëhet në nr. e llogarisë në Bankën Amerikane + Kontratë shit – blerje, nr. 1267 rep, nr. 397 kol, dt. 7.3.2008, për*

shitje apartamenti me sip. 93.22m2 dhe veranda dhe një vend parkimi. Shitës: Marie Marchall Blerës: Remi Emini. Çmimi: 120.000 euro. (ASHK)

- Kontratë shit – blerje me kusht, nr. 5803 rep, nr. 615 kol, dt. 30.12.2005, për shitje apartamenti me sip. 93.22m2 dhe verandë me sip. 26.84m2, me nr. pasurie 59/91+2-2. Shitës: {...}, Ilir Manushi, pëllumb Beta, Odhise Bresho, Artan Saka dhe Dritan Troksi. Blerës: Marie Marchell. **Çmimi: 37.288 euro**, paguar 3.288 euro, pjesa tjetër e pagesës e cila do të kreditohet është 34.000 e cila do të bëhet në nr. e llogarisë në Bankën Amerikane. (DRT VIP)

Për sa i përket kontratës së shitjes me kusht, nr. 5803 rep, nr. 615 kol, dt. 30.12.2005, rezulton se në kontratën e dërguar nga ASHK, çmimi i shitjes është 122.900 euro, ndërsa në kontratën e dërguar nga DRT VIP, çmimi i shitjes është 37.288 euro. Për këto kontrata kandidati ka deklaruar se çmimi ka qenë 37.288 euro. Kandidati ka pretenduar gjithashtu se kontratat përgatiteshin nga "Mic Teknic" (Ilir Manushi) dhe duke qenë se kanë kaluar 14 vite nga lidhja e kësaj kontrate, është përmbushur afati i parashkrimit dhe nuk mund të ndërmerret asnjë iniciative ligjore. Por nga dokumentet e administruara, rezulton se ky apartament, në vitin 2008 (3 vite pas blerjes) është shitur nga shtetasja Marie Marchall me çmimin 120.000 euro. Gjithashtu rezulton e provuar se në të dyja këto kontrata (pavarësisht se mund të jenë hartuar nga shoqëria "Mic Teknic"), ka nënshkruar edhe Kostaq Kaskakviqi.

Lidhur me sa më sipër, Këshilli vlerëson se këto deklaratime të kandidatit nuk përbëjnë argument për të shmangur përgjegjësinë nga konstatimi, pasi ashtu siç rezulton e provuar, kontratat përkatëse pavarësisht se mund të jenë përgatitur nga shoqëria "Mix Tecnic", ato nënshkruheshin (firmoseshin) nga të gjithë investitorët, përfshirë edhe bashkëshortin e kandidatit, {...}, i cili ka firmosur në kontratë. Gjithashtu, fakti se nuk mund të ndërmerren iniciativa ligjore për këtë konstatim, nuk do të thotë që fakti në atë kohë nuk ka ekzistuar, pasi rezulton e provuar që nënshkrimi i bashkëshortit të kandidatit, {...}, gjendet në kontratat të cilat paraqesin dy çmime të ndryshme shitje, **që për efekt të kësaj procedure verifikimi nënkupton mosdeklarim të pasurisë, në kushtet kur vetë kandidati pretendon se nuk e ka arkëtuar shumën, prandaj nuk e ka deklaruar, por e ka përdorur si vlerë investimi.**

Veç mosdeklarimit si më sipër, kandidati për të njëjtin ndërtim, nuk ka deklaruar referuar raportit të ILDKPI-së, edhe shumat e përfituara me :

- Kontratën e shit – blerjes nr. 5804 rep, nr. 616 kol, dt. 30.12.2005, për shitje apartamenti me sip. 53.28m2, me nr. pasurie 59/91+1-6. Shitës: {...}, Ilir Manushi, Pëllumb Beta, Odhise Bresho, Artan Saka dhe Dritan Troksi. Blerës: Fisnik Kadiu. Çmimi: 1.900.000 lekë i paguar tërësisht.
- Kontratën e shit – blerje nr. 5805 rep, nr. 617 kol, dt. 30.12.2005, për shitje apartamenti me sip. 93.22m2, me nr. pasurie 59/91+2-2. Shitës: {...}, Ilir Manushi, Pëllumb Beta, Odhise Bresho, Artan Saka dhe Dritan Troksi. Blerës: Ardian Resuli. Çmimi: 2.400.000 lekë i paguar tërësisht.

Edhepër këto të ardhura kandidati deklaroi se ato nuk janë përfituar në mënyrë të drejtëpërdrejtë por janë përdorur për investim po në këtë objekt. Nga dokumentacioni i administruar nga ILDKPI, nuk ka asnjë dokumentacion që të provojë që këto të ardhura të jenë përfituar përpara ose gjatë ndërtimit të objektit. **Të vetmet dokumente justifikuese ligjore që provojnë transaksionin e shitjes, janë këto kontrata shit – blerje, të cilat janë kryer pasi ka përfunduar ndërtimi i objektit dhe regjistrimi i tyre në ZVRPP Durrës.**

**Sa më sipër, konkludohet se kandidati nuk ka deklaruar as si të ardhur dhe as si vlerë investimi, të ardhurat e siguruara nga shitja e 3/apartamenteve si më sipër, prej nga janë përfituar gjithsej nga bashkepronaret 37.288 euro (nëse ky do të ishte çmimi real) dhe 4.300.000 lekë, të cilat sipas tij nuk janë arkëtuar, por kanë shkuar në investimin e objektit. Por nga dokumentacioni i administruar rezulton se shitjet e këtyre 3 (tre) apartamenteve janë kryer pasi pasuritë e paluajtshme ishin regjistruar e rrjedhimisht, pasi ishte përfunduar investimi dhe logjikisht të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamenteve nuk mund të shërbenin si burim financiar për ndërtimin e këtij objekti. Nuk ka asnjë dokumentacion justifikues ligjor që të provojë se shumat 37.288 euro dhe 4.300.000 lekë janë arkëtuar përpara se të përfundonte ndërtimi i objektit dhe më pas të jenë investuar në ndërtim.**

**1.4 Lidhur me objektin në rrugën në Golem, Kavajë nga i cili {...} ka përfituar pasuri të paluajtshme, apartamente dhe garazhe, të cilat sipas deklarimit janë përfituar si investitor. Dokumente justifikuese ligjore të paraqitura janë:**

- *Kontratë datë 25.3.2003, lidhur mes palëve: Investitorë – {...}, Ilir Manushi, Odhise Bresho dhe Artan Saka. Përfaqësues – shoqëria “MIX TEKNIC” sh.p.k. Ndërtues – shoqëria “2T” sh.p.k, ku në truallin prej 4.720m<sup>2</sup>, shoqëria “2T” sh.p.k., ka marrë lejen e ndërtimit nr. 14, dt. 26.2.2003, për Rezidencë pushimi 4 kate + garazhe.*
  - *Kontratë shit – blerje me kusht nr. 390 rep, nr. 76 kol, dt. 4.2.2009, për apartament me nr. pasurie 137/53+2/20. Shitës: shoqëria “2T” sh.p.k., Blerës: Dritan Kuko. Çmimi: 36.900 euro, paguar 16.900 euro, shuma e mbetur prej 20.000 euro do të paguhet me kredi në Union Bank.*
  - *Kontratë shit – blerje me kusht nr. 656 rep, nr. 128 kol, dt. 3.3.2009, për apartament me nr. pasurie 137/53+2/10. Shitës: shoqëria “2T” sh.p.k., Blerës: Sokol Ngjelina. Çmimi: 34.450 euro, paguar 19.450 euro, shuma e mbetur prej 15.000 euro do të paguhet me kredi në Union Bank.*
  - *Kontratë shit – blerje nr. 519 rep, nr. 283 kol, dt. 9.2.2012, ku shitësi, shoqëria “2T” sh.p.k., i shet blerësit, {...}, pasuritë:*
    1. *Apartament me sip. 54.62m<sup>2</sup>, me nr. pasurie 137/53-2-22, në vlerën 2.239.583 lekë.*
    2. *Apartament me sip. 37.72m<sup>2</sup>, me nr. pasurie 137/53-2-18, në vlerën 1.546.634 lekë.*
    3. *Apartament me sip. 35.63m<sup>2</sup>, me nr. pasurie 137/53-2-21, në vlerën 1.460.937 lekë.*
    4. *Garazh me sip. 21.36m<sup>2</sup>, me nr. pasurie 137/53-G6, në vlerën 613.097 lekë.*
    5. *Garazh me sip. 26.07m<sup>2</sup>, me nr. pasurie 137/53-G16, në vlerën 748.288 lekë.*
    6. *Garazh me sip. 28.57m<sup>2</sup>, me nr. pasurie 137/53-G17, në vlerën 820.045 lekë.*
- Kjo vlerë është likuiduar plotësisht nga blerësi në favor të palës shitëse jashtë zyrës noteriale sipas pohimit dhe deklarimit që bënë të mësipërmit të paraqitur në prezencën e noterit.*
- *Mandat pagesë nr. 97, dt. 9.7.2013, për shumën 20.000 euro, për apartamentin që ka marrë ... Mali i Robit (i palxueshëm qartë shkrimi). Marrës: {...}.*
  - *Mandat pagesë nr. 183, dt. 31.10.2013, për shumën 10.000 euro, për kthim pagese apartamenti te Mali i Robit. Marrës: {...}.*
  - *Nxjerrje llogarie nga ISP bank dt. 13.9.2019, për transferimin e shumës 11.000 euro, nga shoqëria “2T” sh.p.k., për {...}n, me përshkrimin “Kthim pagese për shitje apartamentesh te Mali Robit, kësti i fundit.*
  - *Kontratë shit – blerje nr. 539 rep, nr. 295/1 kol, dt. 295, dt. 15.5.2015, ku {...} i ka shitur blerësit Ilir Qesja, pasurinë e llojit apartament me sip. 37.72m<sup>2</sup>, me nr. pasurie 137/53+2-18, kundrejt çmimit 10.970 euro, shumë e likuiduar nëpërmjet llogarisë bankare të noterit pranë NBG Bank më dt. 15.5.2015.*

**Veç sa më sipër, {...}** ka paraqitur dhe shkresa të thjeshta ku formalizohet marrëveshja e lidhur mes tij dhe shoqërisë ndërtuese 2T, lidhur me projektin dhe pjesëmarrjen në supervizim, duke i njohur si vlerë në investim, si dhe marrëveshje për ndarjen e pasurive të paluajjtshme të këtij objekti (ndryshe nga sa përcakton kontrata e shit – blerjes), por këto marrëveshje nuk konfirmohen nga DRT Tatimore dhe as nga ASHK Kavajë, dhe nuk ka asnjë gjurmë të regjistrimit të tyre në librat e shoqërive apo regjistrat publikë.

Edhe në këtë ndërtesë si palë investitore (dhe si supervizore) shfaqet shoqëria Mix Tecnic dhe jo {...} si individ. **Pra lidhur me investimin e kryer, nuk ka asnjë dokument justifikues në kuptimin e ligjit, që të provojë se sa ka qenë vlera e investuar nga {...} dhe koha kur është investuar.**

{...}, deklaroi se nga pasuritë e paluajjtshme të përfituara në Golem, Kavajë, ka përfutuar të ardhura (30.000 euro) të cilat më pas i ka përdorur si burim për blerjen e një toke në Mullet, Tiranë, por nga sa dokumentohet, i vetmi dokument ligjor që e ka bërë atë pronar të këtyre pasurive të paluajjtshme, është *kontrata e shit – blerjes nr. 519 rep, nr. 283 kol, dt. 9.2.2012*, dhe nga 6 pasuritë e paluajjtshme që ka përfutuar prej saj, 5 i ka ende në pronësi, ndërsa vetëm një ka shitur në vitin 2015 (**dhe kjo pas blerjes së tokës në Mullet e cila është blerë në vitin 2013**).

**1.5. Sa më sipër, në lidhje me pasuritë e përfitura nga 4/ndërtimet e lartpërmendura, arrihet në përfundimin se:**

- ⊗ *Deklarimet e bëra nga bashkëshorti i kandidatit, në deklaratën e interesave private të kandidatit për anëtar të Gjykatës së Lartë, në relacionin shpjegues shtesë dhe prapësimet e dhëna, janë dhe mbeten shpjegime në nivel deklarativ dhe të pa provuara ligjërisht, pasi mungon dokumentacion justifikues ligjor për të provuar vërtetësinë e deklarimeve të kryera prej tij, si dhe për të provuar dhe vërtetuar veprimet (financiare ose jo) mes tij dhe shoqërive tregtare “Alb-Building”, “Mix Teknik”, “2T” dhe “Edicom”, me të cilat ka bashkëpunuar në ndërtimin e objekteve në rrugën “Reshit Petrela”, “Ferrit Xhajko” Tiranë, Rrashbull Durrës dhe Golem Kavajë.*
- ⊗ *Mungon dokumentacioni justifikues ligjor si: pasqyrat financiare dhe librat/regjistrat e shoqërive të ndërtimit ku të jenë të pasqyruara në shifra dhe në mënyrë analitike marrëdhëniet (financiare ose jo) të z.{...}t me firmat ndërtuese, vlerat e investimeve, kontributeve në para apo në natyrë, detyrimet e firmave ndërtuese ndaj tij apo edhe anasjelltas, kthimet nga investimet; gjithashtu, mungojnë preventive dhe situacione për punimet e kryera në objektet e ndërtuara, mandat - pagesa dhe mandat arkëtime mbi pagesat për investimet e kryera apo për shumat e përfituara nga investimet, kontrata porosie apo kontrata sipërmarrje për shitjen e apartamenteve për të cilat {...} deklaroi se ka përfutuar të ardhura, të cilat më pas i ka riinvestuar në ndërtim, mandat pagesa për pjesën takuese të kësteve të kredisë (450.000 USD) për të cilën deklaroi se e kanë përdorur investitorët për ndërtimin e objektit, si dhe dokumentacioni ligjor i vijueshmërisë së kallëzimit penal ndaj shoqërisë “EDICOM” sh.p.k.*
- ⊗ *Mbeten të paqarta dhe të paprovuara me dokumentacion justifikues ligjor vlerat dhe periudhat e investimeve (pjesa takuese) në ndërtimet e objekteve në rrugën “Reshit*

*Petrela”, “Ferrit Xhajko” Tiranë, Rrashbull Durrës, Golem Kavajë, dhe rrjedhimisht për këtë arsye mbeten të paqarta dhe të pajustificuara me dokumentacion ligjor edhe burimet financiare që kanë shërbyer për ndërtimin e tyre.*

- ⊗ *Në deklaratën e interesave private të kandidatit për anëtar të Gjykatës Kushtetuese, ka deklaruar: “Të ardhura nga investimit i bërë në Golem, Kavajë. Marrë në 2013 me 2 mandate arkëtimi (20.000 euro + 10.000 euro). Përdorur për të blerë tokën në Mullet, Tiranë. Shuma 30.000 euro”. Në deklaratën e interesave private të kandidatit për anëtar të Gjykatës së Lartë ka deklaruar: “Të ardhura nga investimit i bërë në Golem, Kavajë. Sipas vlerave të shitjes për dy kontrata duhet të arkëtojë 71.000 euro, por për shkak se i detyroheshka ndërtuesit vlera reduktohej në 41.000 euro, nga të cilat kam marrë realisht vetëm 30.000 euro.”*
- ⊗ *Lidhur me shumën 30.000 euro, që ka shërbyer për blerjen e tokës në Mullet, deklaruar me burim nga arkëtimi i të ardhurave nga investimi në Golem, Kavajë, nisur nga fakti se rezultoi që nga ndërtimi i objektit në Golem Kavajë, {...} ka përfutur me kontratë shitje vetëm 3 apartamente dhe 3 garazhe, nga të cilat 2 apartamente dhe 3 garazhe i ka ende në pronësi dhe vetëm një apartament rezultoi i shitur, por edhe ky rezultoi i shitur në vitin 2015 me çmimin 10.970 euro, rrjedhimisht edhe në këtë rast burimi financiar i shumës 30.000 euro mbetet i paqartë.*
- ⊗ *Për sa i përket shumës 110.000 USD të kredituar nga shoqëria “EDICOM” sh.p.k., në llogarinë e bashkëshortit të kandidatit, konstatohet se përveç përshkrimit të transaksionit bankar “kthim detyrimi sipas rakordimit”, nuk ka asnjë të dhënë tjetër apo dokumentacion justifikues ligjor që të qartësojë dhe të provojë arsyet e këtij kreditimi.*
- ⊗ *Lidhur me objektin 4 kate në Rrashbull Durrës, sipas relacionit shpjegues dhe prapësimeve, në këtë objekt janë shitur 3 apartamente dhe janë përfutur gjithsej nga bashkëpronarët 37.288 euro dhe 4.300.000 lekë, të cilat nuk janë arkëtuar, por kanë shkuar në investimin e objektit, por nga dokumentacioni i administruar rezultoi se shitjet e këtyre 3 (tre) apartamenteve janë kryer mbasi pasuritë e paluajtshme ishin regjistruar e rrjedhimisht, mbasi ishte përfunduar investimi dhe logjikisht të ardhurat e përfuturara nga shitja e apartamenteve nuk mund të jenë përdorur si burim financiar për ndërtimin e këtij objekti. Nuk ka asnjë dokumentacion justifikues ligjor që të provojë se shumat 37.288 euro dhe 4.300.000 lekë, janë arkëtuar përpara se të përfundojë ndërtimi i objektit dhe më pas të jenë investuar në ndërtim.*
- ⊗ *Rezultoi se bashkëshorti i kandidatit, nuk ka deklaruar të ardhura të përfuturara nga shitja e 3 apartamenteve në Komunën Rrashbull, Durrës, ku referuar kontratatave të shitjes, për pjesën takuese prej 1/6, ka përfutur 20.483 euro dhe 717.000 lekë.*



- ⊗ *Rezultoni se çmimi i shitjes së apartamentit me sip. 93.22 m<sup>2</sup> dhe verandë me sip. 26.84m<sup>2</sup>, në Komunën Rrashbull, Durrës, në kontratën e shitjes me kusht, nr. 5803 rep, nr. 615 kol, dt. 30.12.2005, dorëzuar në DTM është 37.288 euro, ndërsa në atë të dorëzuar në ASHK, është 122.900 euro. Të dyja këto kontrata rezultoni se janë nënshkruar edhe nga bashkëshorti, {...}.*
- ⊗ *Pavarësisht se në raportin e saj ILDKPI i referohet pasurisë (tërësisë së drejtave dhe detyrimeve) të bashkëshortit të kandidatit, vlerësimin e “gjendjes juridike të kësaj pasurie” e bën Këshilli. Në kushtet kur e gjithë pasuria (referuar 4/ndërtimeve me lart) është fituar gjatë martesës duke filluar nga viti 1998 e në vijim, ajo është pasuri në bashkëpronësi të bashkëshortëve, regjim i cili zbatohet për pasuritë e fituara deri në dt. 20.12.2003, ditë kur ka hyrë në fuqi Kodi i ri i Familjes[5]. Për pasuritë e fituara pas kësaj date, ato janë në regjimin pasuror të bashkësisë ligjore, si regjim i prezumuar, për sa kohë nuk është pretenduar karakteri i tyre vetiak dhe as rezultoni qe bashkëshortet të kenë zgjedhur regjim tjetër. Për shkak të këtij arsytimi, gjendja e faktit si më sipër i është komunikuar si gjetje dhe është trajtuar si e tillë, referuar pasurisë së kandidatit.*

2. Për sa i përket paqartësisë për investimet e kryera në pasuritë e paluajtshme në objektet e mësipërme e jo vetëm dhe nëse këto pasuri shfrytëzohen ose jo për ndonjë formë aktiviteti ose banimi, etj, paqartësia qëndron në faktin se :

- kandidati në deklaratën e pasurisë, ka deklaruar 6 apartamente në qytetet Tiranë, Durrës, Korçë, e Kavajë, për të cilat nuk ka të dhëna nëse shfrytëzohen të gjitha nga kandidati dhe nëse në to janë kryer ose jo shpenzime arredimi (mobilimi);
- kandidati ka deklaruar garazhe në qytetet e Tiranës, Durrësit dhe Kavajës, por nga ana tjetër nuk ka deklaruar asnjë automjet në pronësi ose përdorim, dhe nuk ka të dhëna nëse garazhet shfrytëzohen ose jo nga kandidati, personat e lidhur me të, apo shtetas të tjerë;
- ka deklaruar 4 (katër) njësi/zyra në qytetin e Tiranë, me sip. 60.4m<sup>2</sup>, sip. 86.11m<sup>2</sup>, sip. 35.3m<sup>2</sup> dhe sip. 35.87m<sup>2</sup>. Nga këto njësi/zyra, subjekti deklaroi se ka dhënë me qira 2 (dy) zyra dhe 1 (një) në përdorim: dhënë me qira zyra me sip. 60.4m<sup>2</sup>, dhënë në përdorim njësi me sip. 35.3m<sup>2</sup>. Paqartësia qëndron në faktin se sipas kontratës së qirasë nr. 2112 rep, nr. 666/1 kol, dt. 3.10.2014 (shënuar me shkrim dore viti 2016), është dhënë me qira njësi shërbimi nr. 4, në katin përdhe të ndërtesës nr. 10, me sip. 45m<sup>2</sup>, sipërfaqe e cila nuk përputhet me sipërfaqet e njërive/zyrave në pronësi. Pra, mbetet e paqartë situata e shfrytëzimit për 2 (dy) njësitë e mbetura, atë me sip. 86m<sup>2</sup> dhe me sip. 35.87m<sup>2</sup>;
- ka deklaruar lokal shërbimi në Durrës, me sip. sip. 267.28m<sup>2</sup> në Durrës, në proces të regjistrimit të legalizimit të shtesës, sipërfaqe e regjistruar 164.16m<sup>2</sup>, por ASHK Durrës informon se është pajisur me Leje Legalizimi nr. 0085239, dt. 2.5.2016, në emër të {...}, Odise Bresho, Artan Sako, Ilir Manushi, Dritan Toski dhe Pëllumb Bleta, me sipërfaqe aktiviteti 292m<sup>2</sup>. Pra, mbetet e paqartë nëse në këtë lokal është investuar dhe nëse shfrytëzohet nga kandidati, personat e lidhur me të, apo shtetas të tjerë.

Nisur nga numri i lartë i pasurive të paluajtshme, është e natyrshme pyetja nëse kandidati ka ose jo interesa të tjerë privatë përveç atyre të deklaruar, pra nëse në këto pasuri janë kryer

investime dhe nëse këto pasuri shfrytëzohen nga kandidati ose persona të tjerë. Por sipas raportit të ILDKPI-së nuk ka të dhëna nëse në pasuritë e paluajtshme në pronësi/bashkëpronësi të bashkëshortit, {...}, janë kryer investime dhe nëse këto pasuri shfrytëzohen ose jo për ndonjë formë aktiviteti ose banimi (përveç atyre të deklaruara me qira dhe në përdorim).

Lidhur me lokalin në Rrashbull, Durrës, kandidati ka shpjeguar se ky lokal ka qenë që në fillim me sip. 267.28m<sup>2</sup> dhe se në të nuk janë kryer investime dhe për këtë ka paraqitur edhe akt – kolaudimin e ndërtesës, në të cilën sipërfaqja e lokalit është 267.28m<sup>2</sup>, por në praktikën e administruar nga ASHK Durrës, rezulton se akt-kolaudimi (në dukje i njëjtë me atë që ka depozituar kandidati), rezulton se lokali ka një sipërfaqe prej 164.16m<sup>2</sup>, pra duket se kemi të njëjtin akt-kolaudimi, por sipërfaqja e lokalit është e ndryshme. Vlen për t’u evidentuar se në praktikën e ASHK Durrës, ndodhet edhe planimetria e lokalit ku sipërfaqja e ambienteve të shërbimit është 267.28m<sup>2</sup>. Përveç kësaj, rezulton se ASHK Durrës, tashmë këtë lokal e ka konfirmuar me sipërfaqe prej 292m<sup>2</sup> (as 267.28m<sup>2</sup> dhe as 164.16m<sup>2</sup>), për të cilin bashkëshorti dhe bashkëpronarët e tjerë janë pajisur me leje legalizimi nr. 0085239, dt. 2.5.2016, **për shtesë anësore në objektin ekzistues, leje të cilën kandidati rezulton se nuk e ka deklaruar në deklaratën e interesave private.**

Për sa sipër, pretendimet e kandidatit se ky lokal ka qenë qysh prej fillimit me sipërfaqe 267.28m<sup>2</sup>, por ZVRPP Durrës e ka regjistruar 164m<sup>2</sup>, duken pretendime kontraditore me akt – kolaudimin e administruar në ZVRPP Durrës. Në kushte normale, ZVRPP Durrës nuk mund të ketë regjistruar një pasuri me sipërfaqe më pak nga ajo faktike. Edhe në rastin nëse ZVRPP Durrës do të kishte regjistruar gabim sipërfaqen e lokalit, pra, ta regjistronte me sip. 164.16m<sup>2</sup> dhe jo 267.28m<sup>2</sup>, atëherë investitorët/bashkëpronarët normalisht do të duhej që për korrigjimin e sipërfaqeve, t’i drejtoheshin përsëri ZVRPP Durrës për të bërë regjistrimet sipas lejes së ndërtimit, ndërkohë që rezulton se bashkëpronarët i janë drejtuar ALUIZNI-t, institucion ky që nuk ka për qëllim të korrigjojë gabimet e ZVRPP, por të legalizojë ndërtimet informale të ndërtuara pa leje ndërtimi, ose ndërtime të cilat kanë dalë jashtë kushteve të lejes së ndërtimit. Përveç sa trajtuar, rezulton e provuar se sipërfaqja faktike e lokalit tashmë rezulton të jetë 292m<sup>2</sup>, pra as 267.28m<sup>2</sup> dhe as 164.16m<sup>2</sup>, ku vërteton faktin se në këtë lokal janë kryer ndërtime duke e shtuar sipërfaqen e saj.

***Për sa më sipër arrihet në përfundimin se:***

⊗ ***Është deklaruar lokal shërbimi me sip. 267.28m<sup>2</sup> (në proces të regjistrimit të legalizimit të shtesës), të regjistruara 164.16m<sup>2</sup>, në Rrashbull, Durrës, ndërsa ASHK Durrës e konfirmon me sip. 292m<sup>2</sup>. Rezulton se nuk është deklaruar fakti se për këtë lokal bashkëshorti i kandidatit dhe bashkëpronarët e tjerë, janë pajisur me Leje Legalizimi nr. 0085239, dt. 2.5.2016. Gjithashtu, mbetet e paqartë vlera e investuar dhe burimi financiar që ka shërbyer për ndërtimin e shtesës si dhe nuk ka të dhëna nëse janë kryer investime e nëse ky lokal shfrytëzohet ose jo për ndonjë formë aktiviteti.***

3. **Intesa Sanpaolo Bank**, me shkresën nr. 19/43416/1 prot, dt. 17.9.2019, ka informuar se janë kryer transaksionet:

- Në dt. 29.7.2010, shoqëria “Hera” sh.p.k., i ka kredituar në llogari shumë 3.000 euro, me përshkrimin “pag projekti arkitekturë...”, për të cilën nuk ka informacion, pasi në akte është paraqitur një kontratë që mban datën 18.03.2009, e cila nuk rezulton të jetë administruar në ndonjë organ tatimor.

- Gjatë vitit 2013 dhe 2014, konstatohet se shoqëria “Invest Real Estate” sh.p.k., ka kryer likuidim faturash në shumën 3.827 euro, ka të dhëna se këto fatura janë paguar nga qeratat. Në mënyrë të përmbledhur kandidati ka deklaruar se mos deklarimi i të ardhurave nga qiraja me shoqërinë “Real Invest Estate”, ka qenë një harrëse.
- Në një llogari tjetër në EURO me nr. 40053535103, në periudhën 2006 – 2007, konstatohet se {...} i janë kredituar të ardhura nga qiraja në shumën 16.200 euro. Në mënyrë të përmbledhur kandidati ka deklaruar se mosdeklarimi i të ardhurave në shumën 16.200 euro, ka ardhur për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar dhe harrësës së kësaj marrëdhënie qiramarrje. Detyrimet për pagesën e tatimit në burim sipas kontratës i kanë takuar qiramarrësit. Për të vërtetuar të ardhurat nga qeratat, kandidatja ka paraqitur në KLGJ dokumentacionin e mëposhtëm:
  - o Kontratë qiraje dt. 26.11.2013, lidhur mes {...} dhe shoqërisë “Invest Real Estate” sh.p.k., për dhënie me qira të ambientit në rrugën “Abdi Toptani”, me sip. 60.4m<sup>2</sup>, me qira mujore 13.3 euro/m<sup>2</sup> pa TVSH dhe 53.33 euro/muaj për mobiljet.
  - o Faturë tatimore shitje nr. 386, dt. 5.12.2013, për pagesë qiraje ambienti nga “Invest Real Estate” sh.p.k., në shumën 109.304 lekë, paguar tatim në burim 10.930 lekë.
  - o Faturë tatimore shitje nr. 387, dt. 5.12.2013, për pagesë qiraje mobilje nga “Invest Real Estate” sh.p.k., në shumën 7.255 lekë, paguar tatim në burim 725,5 lekë.
  - o Faturë tatimore shitje nr. 417, dt. 3.1.2014, për pagesë qiraje ambienti nga “Invest Real Estate” sh.p.k., në shumën 113.268 lekë, paguar tatim në burim 11.327 lekë.
  - o Faturë tatimore shitje nr. 418, dt. 3.1.2014, për pagesë qiraje mobilje nga “Invest Real Estate” sh.p.k., në shumën 7.520 lekë, paguar tatim në burim 752 lekë.
  - o Faturë tatimore shitje nr. 516, dt. 1.4.2014, për pagesë qiraje ambienti nga “Invest Real Estate” sh.p.k., në shumën 112.706 lekë, paguar tatim në burim 11.270 lekë.
  - o Faturë tatimore shitje nr. 517, dt. 1.4.2014, për pagesë qiraje mobilje nga “Invest Real Estate” sh.p.k., në shumën 7.482 lekë, paguar tatim në burim 478 lekë.
  - o Kontratë qiraje nr. 1530 rep, nr. 226 kol, dt. 6.5.2005, lidhur mes {...} dhe shoqërisë “The Point” sh.p.k., për dhënie me qira të ambientit në rrugën “Abdi Toptani”, me qira mujore 600 euro/muaj. Detyrimet monetare që lindin nga kjo kontratë i takojnë palës qiramarrëse.
  - o Kontratë qiraje nr. 2385 rep, nr. 1680 kol, dt. 15.5.2007, lidhur mes {...} dhe shoqërisë “The Point” sh.p.k., për dhënie me qira të ambientit në rrugën “Abdi Toptani”, me qira mujore 600 euro/muaj. Detyrimet monetare që lindin nga kjo kontratë i takojnë palës qiramarrëse.
- Në një llogari tjetër në EURO me nr. 40053535103, {...} në datë 22.10.2008 ka transferuar në llogarinë e {...}, shumën 10.000 euro, me përshkrimin “pagesë për shërbime juridike”. Në mënyrë të përmbledhur kandidati ka deklaruar se transferta prej 10.000 euro nga llogaria e bashkëshortit në llogarinë e bashkëshortes, është një lëvizje e shumave midis dy llogarive të cilat janë në bashkëpronësi bashkëshortore dhe nuk është e nevojshme që të justifikohen lëvizjet e shumave mes tyre.

**Për sa i përket** transfertës së shumës 10.000 euro nga llogaria e bashkëshortit në llogarinë e kandidatit, argumentet e kandidatit se kjo ka qenë një transfertë midis dy llogarive dhe ka qenë pjesë e pasurisë bashkëshortore dhe nuk është e nevojshme të justifikohen lëvizjet e tyre, nuk përputhen me gjendjen e faktit, sepse bashkëshorti i kandidatit në përshkrimin e transfertës, ka deklaruar “pagesë për shërbime juridike” dhe në këtë mënyrë, duke qenë se referuar ligjit për “Pastrimin e parave...” dhe praktikave bankare, klientët janë të detyruar të deklarojnë burimin

e vërtetë në transaksionet që ata kryejnë, krijohet një gjendje paqartësie mbi arsyet se: nëse do të kishte qenë kjo një transfertë midis dy bashkëshortësh, përse bashkëshorti do të deklaronte si burim “pagesë për shërbime juridike”?!

*Për të gjitha këto, arrihet në përfundimin se:*

⊗ *Në dt. 29.7.2010, shoqëria “Hera” sh.p.k., ka kredituar në llogari shumën 3.000 euro, me përshkrimin “pag projekti arkitekturë...”. Për këto të ardhura kandidatja nuk ka paraqitur dokumente justifikuese ligjore.*

⊗ *Gjatë periudhës 2013 dhe 2014, bashkëshorti ka përfitur të ardhura nga qiraja me shoqërinë “Invest Real Estate” sh.p.k., në shumën 3.827 euro, të cilat nuk i ka deklaruar si të ardhura në asnjë nga deklaratat e interesave private të dorëzuara në ILDKPKI.*

⊗ *Gjatë periudhës 2006 dhe 2007, bashkëshorti ka përfitur të ardhura nga qiraja me shoqërinë “The Point sh.p.k., në shumën 16.200 euro, të cilat nuk i ka deklaruar si të ardhura në asnjë nga deklaratat e interesave private të dorëzuara në ILDKPKI.*

⊗ *Është e paqartë se përse bashkëshorti, në datë 22.10.2008, ka transferuar nga llogaria e tij në ISP Bank, në llogarinë e {...}, shumën 10.000 euro, me përshkrimin “pagesë për shërbime juridike”.*

4. Kandidatja ka deklaruar të ardhura nga puna si profesionist i lirë (arkitekt). Periudha 1996 – 1998. Projekte të kontraktuara nga shoqëria “Marko” sh.p.k. Shuma rreth 40.000 USD. Në mënyrë të përmbledhur, kandidatja ka deklaruar se këto të ardhura nuk i ka deklaruar më parë në deklaratën e interesave private për kandidat për Anëtar të Gjykatës Kushtetuese, sepse meqenëse nuk dinte NIPT-in, DRT Tiranë nuk mund t’i jepte një informacion dhe në deklaratë ka shënuar që ka bërë kërkesë në DRT Tiranë, por ende nuk kishte marrë përgjigje. Lidhur me mandat pagesën e shumës 360.000 lekë, kandidati shprehet se ajo korensponon për pagesën e tatimit në burim për shumën 3.600.000 lekë, ose rreth 24.000 USD.

Në KLGJ, kandidatja ka bashkëlidhur dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë dt. 20.6.1996 (e pa noterizuar), lidhur mes firmës ndërtuese “Marko” sh.p.k., dhe {...}t, si projektues, kundrejt vlerës totale në shumën 20.000 USD.
- Kontratë dt. 3.5.1997 (e pa noterizuar), lidhur mes firmës ndërtuese “Marko” sh.p.k., dhe {...}t, si projektues, kundrejt vlerës totale në shumën 27.200 USD.
- Kthim përgjigje nr. 42965/1 prot, dt. 11.9.2019, nga DRT Tiranë, e cila informon se nga verifikimi i dosjes fizike të shoqërisë “Marko” sh.p.k., me NIPT J61813043 U, për vitet 1996 – 2000, nga kjo shoqëri janë deklaruar objektet e ndërtuara prej saj.
- Mandat pagesë, që vërteton pagesën e tatimit në burim, paguar nga shoqëria “Marko”, për llogari të {...}, në vlerën 360.000 lekë, dt. 13.10.1998.

Sipas mandat pagesës nr. 87344, së datës 13.10.1998, të lëshuar nga Banka Kombëtare Tregtare, Dega Tiranë nr.2, vërtëtohet pagesa e shumës prej 360.000 lekë nga shoqëria “Marko” sh.p.k., në llogarinë e DRT Tiranë. Rezulton përshkrimi Tatim në burim –

K.Kaskaviqi 1998. Pra rezulton që shuma e paguar si “tatim në burim” është për shumën e përfituar nga shoqëria “Marko”, për llogari të {...} për punën e kryer nga ai.

***Lidhur me sa më sipër arrihet në përfundimin se: Deklarimi është i saktë dhe ka dokumentacion justifikues për të ardhurat nga puna si profesionist i lirë për pagesën e marrë nga shoqëria “Marko” sh.p.k., në shumën rreth 40.000 USD. Por lidhur me mosdeklarimin e të ardhurave të përfituara nga shoqëria “Marko” sh.p.k., në deklaratën e interesave private për kandidat për Anëtar në Gjykatën Kushtetuese, argumentet e dhëna nga kandidati, nuk mund të vlerësohen të mjaftueshme për të justifikuar mosdeklarimin e tyre.***

5. Lidhur me mospërputhjet e konstatuara në 2 (dy) deklaratat, atë të interesave private të kandidatit për anëtar të Gjykatës Kushtetuese dhe atë të kandidatit për anëtar të Gjykatës së Lartë, ndër të tjera kandidati ka deklaruar: *“Së pari, unë jam tërhequr nga kandidimi për anëtar të Gjykatës Kushtetuese dhe mangësitë që mund të ketë ajo deklaratë nuk përbëjnë provë kundër meje, sepse heqja dorë nga kandidimi lë pa vlerë juridike të gjitha procedurat e zhvilluara deri në momentin e heqjes dorë, e cila ndërpret këto procedura. Lidhur me investimin në objektin në rrugën “Reshit Petrela” (sot Asim Vokshi), nga ne është konsideruar investim që në momentin që kemi vendosur ta blejmë truallin, i cili është blerë me qëllimin për të ndërtuar mbi të. Për ne trualli dhe ndërtimi janë pjesë e të njëjtit investim. Në fakt këto pasuri të paluajtshme, kryesisht rrjedhin si pasojë e të qenit pronar trualli, por duke qenë se pronarët e truallit kanë qenë edhe investitorë të objektit, ky është konsideruar nga ne si investim unik.*

Për sa i përket prapësimeve të mësipërme të kandidatit lidhur me mospërputhjet e konstatuara në 2 (dy) deklaratat, atë të interesave private të kandidatit për anëtar të Gjykatës Kushtetuese dhe atë të kandidatit për anëtar të Gjykatës së Lartë, vlerësohet se, pavarësisht faktit se kandidati është tërhequr nga kandidimi për anëtar të Gjykatës Kushtetuese, nuk do të thotë që deklaratimet e tij të kryera për nevojat e atij procesi të mos të merren parasysh si provë, pasi, deklaratat e interesave private e dorëzuar nga kandidati për procesin e vlerësimit të pasurisë për kandidatit për anëtar të Gjykatës Kushtetuese, përbën dokument zyrtar në të cilën kandidati ka pasur detyrimin ligjor të deklarojë në mënyrë shteruese, të saktë dhe të plotë, të gjithë interesat private të kërkuara nga ligji, Nisur nga kjo, duhej që deklaratat e interesave private për kandidatit për anëtar të Gjykatës së Lartë të ndryshonte me deklaratën e interesave private për anëtar të Gjykatës Kushtetuese, vetëm për ato interesa private që mund të kishin ndryshuar gjatë periudhës, nga data 23.4.2019, kur kandidati ka dorëzuar deklaratën e interesave private për anëtar të Gjykatës Kushtetuese, deri në datën 6.9.2019, kur ka dorëzuar deklaratën e interesave private për anëtar të Gjykatës së Lartë.

Në zbatim të nenit 32 pika 4 të Ligjit 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në R.Shqipërisë”, për verifikimin e pasurisë Keshilli bazohet në raportin e ILDKPI-së. Ky i fundit vepron në zbatim të procedurave të përcaktuara në Ligjin Nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” të ndryshuar, duke përdorur çdo dokument zyrtar, përfshirë edhe deklaratat e interesave private të mëparshme të kandidatit.

Ligji nr. 9049/2003 dhe formulari i deklarimit të pasurisë përcaktojnë detyrimin e subjektit deklarues/kandidatit të deklarojë në formën të përcaktuar prej tyre, pa gabime, në mënyrë shteruese duke mos e ndërvarur atë nga institucioni për të cilën konkurron kandidati. Në këndvështrim të kuadrit

ligjor, subjekti/kandidat ka detyrë të deklarojë duke prezantuar një fotografi të saktë dhe shterruese të interesave të saj pasurorë e të drejtave mbi pasuritë e paluajtshme e të luajtshme në fund të çdo viti kalendarik, kur këto pasuri janë krijuar, kurse institucionet verifikuese dhe kontrolluese të këtyre deklaramëve do të duhet më pas të ndjekin konceptet e logjikës dhe matematikës, përfshi rregullat kontabël për të konkluduar nëse këto deklarime prodhojnë ndonjë situatë të shkeljes së ligjit prej subjektit deklarues.

Në këtë kuptim, Keshilli çmon se me mospërputhjet e konstatuara në 2 (dy) deklaratat, atë të interesave private të kandidatit për anëtar të Gjykatës Kushtetuese dhe atë të kandidatit për anëtar të Gjykatës së Lartë, nuk është një gabim në deklarime siç pretendon subjekti, por tregon një panoramë të situatës financiare të subjektit, e cila nënkupton ndër të tjera detyrimin e kandidatit për të identifikuar saktë investimin (në objektin në rrugën “Reshit Petrela”), burimin e krijimit të saj, shpenzimet e kryera dhe gjendjen reale të pasurisë së saj dhe me të drejtë ILDKPI e ka konsideruar si një situatë paligjshmërie deklarimi.

*Për sa me sipër, arrihet në përfundimin se:*

- ⊗ *Lidhur me deklarin e bashkëshortit të kandidati për të ardhurat e përfituara si pronar trualli nga objekti shumëkatësh në rrugën “Reshit Petrela”, Tiranë, konstatohet se ky deklarim nuk rezulton të jetë deklaruar më parë në deklaratën e interesave private të kandidatit për anëtar të Gjykatës Kushtetuese. Referuar dokumentacionit të administruar nga ASHK Tirana Veri, rezulton se nga shitja e pasurive të paluajtshme të përfituara nga investimi në ndërtimin e objektit 13 – kate në rrugën “Asim Vokshi”, Tiranë, bashkëshorti i kandidatit, për pjesën e vetë takuese ka përfiturar të ardhura në një shumë totale prej 251.098 euro dhe 197.667 USD.*

6. Lidhur me evidentimin e pasurive dhe të ardhurave të kandidatës për Gjyqtare në Gjykatën e Lartë, Sotir{...}, si dhe për argumentet mbi përfundimet e arritura për të nga kontrolli pasuror, nga ana e ILDKPI konfirmohet se vlera së pasurisë prej 43.386.000 lekë, përfaqëson shumatorën e vlerave të secilës prej pasurive që subjekti disponon në datën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, sipas vlerave të deklarura nga kandidati. Po ashtu kjo vlerë i referohet vetëm vlerave të pasurive të deklaruar nga kandidati/personat e lidhur dhe nuk përfaqëson shumën e shpenzuar/investuar prej tyre për krijimin e pasurive. Vlera reale e shpenzuar/investuar, sidomos në ndërtimin e objekteve në qytetet e Tiranës, Durrësit dhe Kavajës, është tërësisht e panjohur, pasi kandidati nuk ka arritur të provojë me dokumentacion justifikues ligjor, vlerat e investuara, burimet financiare dhe periudhat se kur janë kryer këto shpenzime/investime nga ana e tyre.

Referuar raportit të ILDKPI-së konstatohet se vlera e pasurisë se deklaruar nga kandidatja prej 43.386.000 lekë është me e vogël se vlera e të ardhurave nga pagat prej 48 550 000 lekë+ të ardhura të tjera të ligjshme që i janë njohur kandidatit dhe në një vlerësim total mund të arrihej në konkluzionin se tërësia e të ardhurave të ligjshme që ka siguruar në vite kandidati justifikon vlerën aktuale të pasurisë së tij madje duke zbritur edhe shpenzimet e nevojshme për jetesë. Por ky do të ishte një konkluzion i gabuar sepse :

- Kandidatja nuk justifikon burimin e ligjshëm të secilës pasuri si më sipër, në momentin e krijimit të saj. Për të konkluduar nëse kandidatja ka pasur ose jo burime të mjaftueshme financiare për të krijuar një pasuri të caktuar, analiza financiare kryhet vetëm duke iu referuar burimeve financiare të akumuluar deri në momentin e krijimit të pasurisë. Pjesa kryesore e

pasurisë se deklaruar, është krijuar nga investimet e kryera në objektet në Tiranë, Durrës dhe Kavajë, ndërtime të cilat kanë përfunduar deri në vitin 2005, pra edhe objektivisht për këto ndërtime ka qenë e pamundur të investohen të ardhura të fituara pas vitit 2005;

- Vetë kandidatja nuk ka pretenduar dhe as ka deklaruar që për krijimin e këtyre pasurive të ketë përdorur të ardhurat nga pagat, qiratë, dieta, intership..etj. Përkundrazi si “investim” edhe pse nuk është provuar vlera, është deklaruar kryesisht kontributi i bashkëshortit në realizimin e projekteve të ndërtimit dhe supervizimi i mëtejshëm i kryer prej tij për realizimin e tyre. Konkretisht për ndërtimin e realizuar në rrugën Reshit Petrela veç vlerës së pasurive të përfituara si pronar trualli, ka pasuri të fituara në cilësinë e investitorit, ku si burim i ligjshëm i investimit deklarohet: “kontributi si investitor, projekti i objektit dhe konsulencë, asistencë në zbatim”. Për ndërtimin e realizuar në Rrashbull Durrës si burim i ligjshëm i investimit deklarohet: “kontributi si investitor, projekti i objektit dhe konsulencë, asistencë në zbatim + investim në para 4 500 000 lekë”. Për ndërtimin e realizuar në Kavajë si burim i ligjshëm i investimit deklarohet: “kontributi si investitor, projekti i objektit dhe konsulencë, asistencë në zbatim + investim në para 4 200 000 lekë”, ndërsa për ndërtimin në rrugën Ferit Xhejo si burim i ligjshëm i investimit deklarohet “projekti i objektit”.
- **Kandidates nuk i është komunikuar si gjetje nga relatori gjatë procedurës së verifikimit, mosmbulimi i pasurisë në tërësi si vlerë, me të ardhura të ligjshme, por mungesa e burimit të ligjshëm financiar në momentin e krijimit të pasurive referuar 4/ndërtimeve të realizuara. Prandaj analiza ligjore mbi rrethana fakti që nuk i janë komunikuar si gjetje kandidates, nuk ka rëndësi për procesin e verifikimit në rastin konkret.**

7. Përfundimisht për kandidaten për Gjykatë të Lartë {...} konstatohet se kemi mosdeklarim të pasurive dhe mungesë të dokumentacionit ligjor për të justifikuar burimin e krijimit të pasurive, dhe deklarime të ndryshme në deklaratën e interesave private të kandidatit për anëtar të Gjykatës së Lartë, krahasuar me atë të kandidatit për anëtar të Gjykatës Kushtetuese, prandaj arrijmë në konkluzionin se deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin,

Është arritur në përfundimin se ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasurinë, sepse kandidatja nuk ka arritur të provojë me dokumentacion justifikues ligjor vlerat e investuara, burimet financiare dhe periudhat kur janë bërë këto investime, sepse ka rezultuar si vijon:

- *Deklarimet e bëra nga bashkëshorti, {...}, në deklaratën e interesave private të kandidatit për anëtar të Gjykatës së Lartë, në relacionin shpjegues shtesë dhe prapësimet e dhëna, janë dhe mbeten shpjegime në nivel deklarativ dhe të pa provuara ligjërisht, pasi mungon dokumentacioni justifikues ligjor për të provuar vërtetësinë e deklarimeve të kryera prej tij, si dhe për të provuar dhe vërtetuar veprimet (financiare ose jo) mes tij dhe shoqërive tregtare “Alb-Building”, “Mix Teknik”, “2T” dhe “Edicom”, me të cilat ka bashkëpunuar në ndërtimin e objekteve në rrugën “Reshit Petrela”, “Ferrit Xhajko” Tiranë, Rrashbull Durrës dhe Golem Kavajë.*
- *Mungon dokumentacioni justifikues ligjor si: pasqyrat financiare dhe librat/regjistrat e shoqërive të ndërtimit ku të jenë të pasqyruara në shifra dhe në mënyrë analitike marrëdhëniet (financiare ose jo) të {...}t me firmat ndërtuese, vlerat e investimeve,*

*kontributeve në para apo në natyrë, detyrimet e firmave ndërtuese ndaj tij apo edhe anasjelltas, kthimet nga investimet; gjithashtu, mungojnë preventive dhe situacione për punimet e kryera në objektet e ndërtuara, mandat - pagesa dhe mandat arkëtime mbi pagesat për investimet e kryera apo për shumat e përfituara nga investimet, kontrata porositë apo kontrata sipërmarrje për shitjen e apartamenteve për të cilat {...} deklaror se ka përfituar të ardhura, të cilat më pas i ka riinvestuar në ndërtim, mandat pagesa për pjesën takuese të kësteve të kredisë (450.000 USD) për të cilën deklaror se e kanë përdorur investitorët për ndërtimin e objektit, si dhe dokumentacioni ligjor i vijueshmërisë së kallëzimit penal ndaj shoqërisë “EDICOM” sh.p.k..*

- *Është e paqartë se përse mandat-arkëtimet për shitjen e pasurive të paluajtshme në rrugën “Reshit Petrela”, Tiranë janë arkëtuar nga shoqëria “Mix Tecnic”, ndërkohë që kontratat e shit – blerjes përfundimtare janë lidhur nga investitorët në mënyrë individuale dhe jo nga shoqëria “Mix Tecnic”.*
- *Mbeten të paqarta dhe të paprovuara me dokumentacion justifikues ligjor vlerat dhe periudhat e investimeve (pjesa takuese) në ndërtimet e objekteve në rrugën “Reshit Petrela”, “Ferrit Xhajko” Tiranë, Rrashbull Durrës, Golem Kavajë, dhe rrjedhimisht për këtë arsye mbeten të paqarta dhe të pajustificuara me dokumentacion ligjor edhe burimet financiare që kanë shërbyer për ndërtimin e tyre.*
- *Nuk ka të dhëna nëse në pasuritë e paluajtshme në pronësi/bashkëpronësi të bashkëshortit, {...}, janë kryer investime dhe nëse këto pasuri shfrytëzohen ose jo për ndonjë formë aktiviteti ose banimi (përveç atyre të deklaruara me qira dhe në përdorim).*
- *Lidhur me objektin 4 kate në Rrashbull Durrës, sipas relacionit shpjegues dhe prapësimeve, në këtë objekt janë shitur 3 apartamente dhe janë përfituar gjithsej nga bashkëpronarët 37.288 euro dhe 4.300.000 lekë, të cilat nuk janë arkëtuar, por kanë shkuar në investimin e objektit, por nga dokumentacioni i administruar rezulton se shitjet e këtyre 3 (tre) apartamenteve janë kryer mbasi pasuritë e paluajtshme ishin regjistruar e rrjedhimisht, mbasi ishte përfunduar investimi dhe logjikisht të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamenteve nuk mund të jenë përdorur si burim financiar për ndërtimin e këtij objekti. Nuk ka asnjë dokumentacion justifikues ligjor që të provojë se shumat 37.288 euro dhe 4.300.000 lekë janë arkëtuar përpara se të përfundojë ndërtimi i objektit dhe më pas të jenë investuar në ndërtim.*
- *Për sa i përket shumës 110.000 USD të kredituar nga shoqëria “EDICOM” sh.p.k., në llogarinë e bashkëshortit të kandidatit, konstatohet se përveç përshkrimit të transaksionit bankar “kthim detyrimi sipas rakordimit”, nuk ka asnjë të dhënë tjetër apo dokumentacion justifikues ligjor që të qartësojë dhe të provojë arsyet e këtij kreditimi.*

Arrihet në përfundimin se kandidati ka mosdeklarim të pasurisë, referuar si vijon:



- *Bashkëshorti i kandidatit, nuk ka deklaruar të ardhura të përfituara nga shitja e 3 apartamenteve në komunën Rrashbull, Durrës, ku referuar kontratave të shitjes, për pjesën takuese të tij prej 1/6, ai ka përfitur 20.483 euro dhe 717.000 lekë. Është mosdeklarim pasurie sepse vetë ka deklaruar që keto të ardhura nuk i arkëtuar por i ka përdorur si investim.*
- *Bashkëshorti i kandidatit ka deklaruar lokal shërbimi me sip. 267.28m<sup>2</sup> (në proces të regjistrimit të legalizimit të shtesës), të regjistruara 164.16m<sup>2</sup>, në Rrashbull, Durrës, ndërsa ASHK Durrës e konfirmon me sip. 292m<sup>2</sup>. Rezulton se nuk ka deklaruar faktin se për këtë lokal ai dhe bashkëpronarët e tjerë, janë pajisur me Leje Legalizimi nr. 0085239, dt. 2.5.2016 si dhe nuk ka deklaruar sipërfaqen prej 24.72m<sup>2</sup>. Gjithashtu, mbetet e paqartë vlera e investuar dhe burimi financiar që ka shërbyer për ndërtimin e shtesës si dhe nuk ka të dhëna nëse janë kryer investime e nëse ky lokal shfrytëzohet ose jo për ndonjë formë aktiviteti.*
- *Në dt. 29.7.2010, shoqëria “Hera” sh.p.k., ka kredituar në llogari shumë 3.000 euro, me përshkrimin “pag projekti arkitekturë...”, të ardhura të cilat nuk janë deklaruar nga kandidati dhe nuk ka paraqitur dokumente justifikuese ligjore (nuk është deklaruar e drejta e kreditimit si pjese e pasurisë).*
- *Është e paqartë se përse bashkëshorti, në datë 22.10.2008, ka transferuar nga llogaria e tij në ISP Bank, në llogarinë e {...}, shumë 10.000 euro, me përshkrimin “pagesë për shërbime juridike”.*
- *Të ardhurat e përfituara si pronar trualli nga objekti shumëkatësh në rrugën “Reshit Petrela”, Tiranë, nuk janë deklaruar në deklaratën e interesave private të kandidatit për anëtar të Gjykatës Kushtetuese. Referuar dokumentacionit të administruar nga ASHK Tirana Veri, rezulton se nga shitja e pasurive të paluajtshme të përfituara nga investimi, bashkëshorti i kandidatit, për pjesën e vetë takuese ka përfitur të ardhura në një shumë totale prej 251.098 euro dhe 197.667 usd.*
- *Pavarësisht se përdoret shprehja “bashkëshorti nuk ka deklaruar ,, apo “mosdeklarime nga bashkëshorti ,, për shkak të regjimit juridik të bashkëpronësisë dhe atij të bashkësisë ligjore të shpjeguar më lart, (referuar kohës së krijimit të pasurisë), pasojat juridike në procesin e verifikimit bien edhe mbi pasurinë e kandidatit, sipas kërkesave të nenit 32 pika 4 shkronja “a ,, të Ligjit 96/2016.*

8. *Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 9049, datë. 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nënpunësve publikë”, i ndryshuar, ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005,*

*“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe ligjin nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerësohet se për kandidaten {...}:*

- f) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- g) ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të justifikuar pasurinë;*
- h) ka mosdeklarim të pasurisë;*
- i) nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- j) kandidati nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

## KONKLUZIONE

1. Sa më lart, Këshilli i Lartë Gjyqësor arrin në konkluzionin se jemi para rastit të skualifikimit dhe përjashtimit të kandidates znj. {...} nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë, për shkak të moskalimit prej saj të procesit të verifikimit të pasurisë, sipas nenëve **49/5 në lidhje me nenin 32 pika 4 shkronja “a” të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”**.

## PËR KËTO ARSYE

**Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 136, pikat 3 e 4 dhe në nenin 147/a, pika 1, shkronjat “c” dhe “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 49, pikat, 1, 2 dhe 5 në lidhje me nenin 32, pika 4, shkronja “a”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 61, pika 2, shkronja “c”, në nenin 86, shkronjat “ç” dhe “ë”, dhe në nenin 97, pika 1, shkronja “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun VI, Seksioni Ç, pika 12, shkronja “e”, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatori z. Dritan Hallunaj,**

## VENDOSI:

1. Skualifikimin e kandidates jogjyqtare znj. {...} dhe përjashtimin e saj nga kandidimi për emërim si gjyqtare në Gjykatën e Lartë për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.108, datë 09.07.2019 dhe Vendimin nr.109, datë 09.07.2019, dhe nr.172, datë 11.09.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

3. Kandidatja ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

[1] Koha kur ka filluar zbatimi i Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” sipas të cilit, për përfitimin e mbrojtjes nga sigurimet shoqërore, organet e sigurimeve shoqërore grumbullonin dokumentacionin për veprimtaritë ekonomike të të punësuarve dhe mblidhnin kontributet e paguara të sigurimeve shoqërore.

[2] “5. Këshilli vlerëson përmbushjen e kritereve, sipas parashikimeve të pikës 2, të këtij neni, dhe verifikon kandidatët, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji. Kandidatët, të cilët nuk përmbushin kriteret ose nuk kalojnë procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, përjashtohen nga kandidimi”.

[3] “2. ..., për secilin kandidat ..., Këshillat kërkojnë raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës në lidhje me çdo shkak tjetër përjashtues, nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokuroria, organet e administratës tatimore dhe doganore, Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, si dhe çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës së kandidatit. Nëse është e nevojshme, Këshillat kërkojnë informacion shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë. 3. Çdo institucion publik, subjekt fizik ose juridik, duhet të përmbushë kërkesat e Këshillave për informacion, dokumentacion, ose materiale të tjera në lidhje me një hetim, me përjashtim të rasteve të kufizuara me ligj, brenda afatit ligjor të arsyeshëm të përcaktuar nga Këshillat në kërkesën e tyre. 4. Në çdo rast, kandidati nuk pranohet ... kur: a) raporti i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave tregon që burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asete ose ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve; b) raportet e Byrosë Kombëtare të Hetimit ose Shërbimit Informativ Shtetëror tregojnë se kandidati ka lidhje me krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”; c) ka ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit. 5. ..., Këshillat vendosin pranueshmërinë e kandidatëve, bazuar në informacionin që kanë marrë për rezultatet e verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre. ...”.

[4] Sipas komentarit në "Reformen kushtetuese në sistemin e drejtësisë" (2016) fq.531-532

[5] Miratuar me Ligjin Nr. 9062 dt. 08.05.2003, botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 49 dt. 20.06.2003, hyrë ne fuqi 6/muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.